

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË

DEPARTAMENT I SËMUNDJEVE TË BRENDËSHME

(SPECIALITETI PNEUMOLOGJI)

DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR”

KORELACIONE KLINIKE, RADIOLOGJIKE, SHINTIGRAFIKE DHE
LABORATORIKE TË TROMBOEMBOLISË PULMONARE

Udheheqes shkencor:

Prof. Dr. Jul Bushati

Kandidati:

Dr. Loreta Agolli (Karaulli)

Tiranë, 2021

REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKESISE

DISERTACION

I PARAQITUR NGA

Dr. Loreta Agolli (Karaulli)

UDHËHEQUR NGA

Prof. Dr. Jul BUSHATI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR”

SPECIALITETI: PNEUMOLOGJI

TEMA:

**KORELACIONE KLINIKE, RADIOLOGJIKE, SHINTIGRAFIKE DHE
LABORATORIKE TË TROMBOEMBOLISË PULMONARE**

MBROHET ME DATË 23/12/2021 PARA JURISË

- 1. Prof. Dr. Hasan Hafizi _____ KRYETAR**
- 2. Prof. Dr. Silvana Bala _____ OPONENT**
- 3. Prof. Dr. Aqif Gjokuta _____ OPONENT**
- 4. Prof. Dr. Margarita Gjata _____ ANËTAR**
- 5. Prof. Dr. As Sokol Xhepa _____ ANËTAR**

MIRËNJOHJE

Dëshiroj të falenderoj të gjithë ata që më mbështetën dhe që kontribuan për realizimin e këtij punimi.

Të gjithë stafin mjekësor për këshillat dhe ndihmën e ofruar për realizimin e këtij punimi.

Pacientët dhe miqtë e mi për frymëzimin dhe inkurajimin, si dhe bashkëpunimin. Statisticienët që më ndihmuan në perpunimin e të dhënave.

Familjen time për mbështetjen për të realizuar me sukses këtë proces studimor.

Faleminderit të gjithëve!

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	
Shkurtim fjalësh.....	
Lista e tabelave.....	
Lista e figurave.....	
Parathënie.....	
1.Hyrje.....	
2.Materiali dhe metodologjia.....	
2.1 Qëllimi.....	
2.2 Objektivat.....	
2.3 Materiali dhe metodika.....	
3. Rezultate.....	
4. Diskutim.....	
5. Përfundime.....	
6. Rekomandime.....	
7. Bibliografia.....	

PËRMBLEDHJE

Janë marrë në studim 121 të sëmurë me EP të shtruar në pavionet e patologjisë si dhe 18 raste te vdekjeve me EP. Rezulton se EP përbën 6.4% të rasteve të shtruar për sëmundje respiratore dhe ka rritje të prevalencës me rritjen e moshës. Në pacientët e shtruar me EP nuk rezultuan ndryshime sinjifikante në lidhje me gjininë. Në moshat më të reja vihet re shpeshtësi më e madhe në gjininë femër, gjë që barazohet në grup moshën 55-64 vjec dhe më pas vihet re numër më i madh i meshkujve. Pothuajse të gjithë pacientët janë hospitalizuar si urgjencë mjekësore. Pacientë me recidivë kanë qenë në 9.1% të rasteve, në të cilët nuk rezulton përparësi kohore e ndodhisë së parë.

Faktorët e fituar të riskut si të vetëm apo kombinimin e tyre kanë rezultuar në 90.9% të pacientëve me TEP. Si faktorë risku të fituar të veçantë rezultojnë më shpesh inflamacioni kronik - 25(20.6%), obeziteti - 24(19.8%), fibrilacioni atrial – 19 (15.7 %), trauma me dëmtim indor - 18(14.9%), imobilizimi -15(12.4%) dhe malinjiteti - 12(9.9 %). Udhëtimi i zgjatur rezultoi në 0.8% të pacienteve. Në lidhje me moshën vihet re se faktorët e riskut të fituar rriten me rritjen e moshës dhe respektivisht 1.7% në grupmoshën 25- 34 vjeç, 5.7 % në grupmoshën 35 - 44 vjeç, 8.2 % në grupmoshën 45 - 54 vjeç, 23.9 % në grupmoshën 55 – 64 vjeç dhe 53.7% në grupmoshën >64 vjeç.

Në paraqitjen e të sëmurëve në spital simptomi më i shpeshtë ka qenë dispnea në efort - 116(95.9%), pasuar nga dhimbja torakale -103(85.1%), dispnea në qetësi – 90 (74.4%), temperaturë - 23(19%), hemoptizi – 17(14%). Gjendje sinkopale ose presinkopale kanë patur 11(9.1%) pacientë. Hipoksemia është konstatuar në 55(45.5%) pacientë, aritmi kardiake – 23(19%), hipertension pulmonar – 16(13.2%) dhe insuficiencë të zemrës së djathtë -10(8.3%) pacientë. Frekuenca respiratore/minutë ka qenë ≥ 21 /minutë në 46.3 %, frekuenca kardiake ≥ 81 në 76.9% të pacientëve. TVTH ka qenë e pranishme në 24.0% të pacientë, por në rastet që është kryer ECHO Doppler ka rezultuar 87.1% positive, me predominim në v.poplitea. Vlerësimi i probabilitetit klinik të EP në shumicën e pacientëve ka qenë në probabilitet të moderuar.

Kuadri gazometrik ka rezultuar kryesisht me modelin e hipoksemisë, hipokarbisë dhe rritje të AaDO₂. Vlera të rritura të D-dimer kanë rezultuar në 98.3% të rasteve; të hematokritit në 12.4% të rasteve; të azotemisë në 20.7% të rasteve; të fibrinogjenit në 66.9 % pacientë, më frekuent në moshat më të reja.

Sipas ekzaminimeve kanë rezultuar pa ndryshime: EKG -58.7% të rasteve; ekografia e zemrës - 46.6 % (PSAP e rritur ka rezultuar në 29.5 %) pacientë; radiografia e toraksit në 13.2 %.

Lokalizimi angioskanerik i trombeve ka qenë në vazë primare në 19.5 % pacientë; vazë primare bilaterale në 12.7%; vazë lobare në 12.7 %; vazë lobare bilaterale në 3.4 %; vaza segmentare në 23.7%; vaza segmentare bilaterale në 5.1%; seksione vazale të ndryshme bilaterale në 22%; tromb me vendosje në formë shale në 0.8%. Lezionet trombotike në vazat primare janë më shpesh në moshën mbi 65 vjeç, si dhe një tromb në formë shale.

Vdekjet në spital si pasojë e sëmundjeve respiratore kanë ndodhur në 4.2% të shtrimeve, ndërsa vdekjet si pasojë e EP përbëjnë 10.2% e totalit të vdekjeve ose 6.7% pacientëve të shtruar me EP). Numri predominues i rasteve të vdekjeve ka qenë në moshën ≥ 65 vjeç dhe kryesisht meshkuj. Sëmundjet shoqëruese më të shpeshta kanë qenë ato kardiovaskulare, pasuar nga ato respiratore, neuropsiqike dhe neoplazike. Të gjithë pacientët kanë paraqitur dispne në qetësi dhe shumica predominuese në gjendje shoku (77.8%), si dhe takipne e takikardi. Në ekokardiografi ka rezultuar dilatacion i ventrikulit të djathtë dhe PSAP e rritur. Lokalizimi më i shpeshtë i trombeve ka qenë në vazat primare dhe lobare. Në shumicën predominuese të pacientëve që vdiqën, D-dimeri ka rezultuar >4000 ng/mL. Rezultatet e sPESI kanë qenë në të gjitha rastet me risk të lartë.

Rezulton se përgjithësisht mjekimi ka filluar me heparin dhe më pas është vazhduar me antivitaminikët K dhe në më pak raste (15%) me NOAC.

SHKURTIME FJALËSH

A-a PO₂ – Diferenca alveolo-arteriale e PO₂

ACCP- The American College of Chest Physicians

aPTT – Koha e tromboplastinës parciale të aktivizuar

EP - Embolizmi pulmonar

EPV- Emboli pulmonare venoze

HIV - Virusi i imunodeficiencës humane

HR - hazard ratio (raporti i rrezikut)

INR- Raporti internacional i normalizuar (i kohës së protrombinës)

LMWH – Heparin me peshë të vogël molekulare

MDCT - MultiDetector Computed Tomography

PaCO₂ – Presioni parcial i gazit karbonik arterial

PaO₂ - Presioni parcial i oksigjenit arterial

PESI - Indeksi i gravitetit të embolise pulmonare

SaO₂ – Saturimi me oksigjen i hemoglobinës

SLE- Lupus erythematosus sistemik

sPESI - Indeksi i thjeshtësuar gravitetit të embolisë pulmonare

SPOK - Sëmundje pulmonare obstruktive kronike

TEP - Tromboembolia pulmonare

TEV - Tromboembolia venoze

TT - Koha e trombinës

TVTH - Trombozë e venave të thella

UFH – Heparin e pafractionuar

VD - Ventrikuli i djathtë

LISTA E TABELAVE

Tabela 3.1.1 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grup moshës

Tabela 3.1.2 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas banimit

Tabela 3.1.3 Vdekjet nga EP në të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grup moshës dhe gjinisë

Tabela 3.2.1 Rastet me TEP sipas seksit dhe prejardhjes

Tabela 3.2.2 Rastet me TEP sipas seksit dhe grupmoshës

Tabela 3.2.3 Rastet me TEP sipas moshës dhe prejardhjes

Tabela 3.2.4 Rastet me TEP sipas seksit dhe profesionit

Tabela 3.2.5 Rastet me TEP sipas moshës dhe profesionit

Tabela 3.2.6 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit

Tabela 3.2.7 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit në cigare/ditë

Tabela 3.2.8 Rastet me TEP sipas seksit dhe vite përdorim të duhanit

Tabela 3.2.9 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit në paketa/vite

Tabela 3.2.10 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitet e ndërprerjes të duhanit

Tabela 3.2.11 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit

Tabela 3.2.12 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit cigare/ditë

Tabela 3.2.13 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të përdorimit të duhanit

Tabela 3.2.14 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit paketa/vite

Tabela 3.2.15 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të ndërprerjes të duhanit

Tabela 3.2.16 Rastet me TEP sipas seksit dhe mënyrës së shtrimit

Tabela 3.2.17 Rastet me TEP sipas seksit dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Tabela 3.2.18 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitit të shtrimit të parë

Tabela 3.2.19 Rastet me TEP sipas moshës dhe llojit të shtrimit

Tabela 3.2.20 Rastet me TEP sipas moshës dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Tabela 3.2.21 Rastet me TEP sipas moshës dhe vitit të shtrimit të parë

Tabela 3.3.1 Faktorët e fituar të riskut në pacientët me TEP sipas seksit

Tabela 3.3.2 Shpeshësia e faktorëve të fituar të riskut sipas seksit

Tabela 3.3.3 Faktorët e fituar të riskut në pacientët me TEP sipas moshës

Tabela 3.3.4 Shpeshësia e faktorëve të fituar të riskut sipas moshës

Tabela 3.4.1 Rastet me TEP sipas paraqitjeve klinike

Tabela 3.4.2 Rastet me TEP sipas seksit dhe paraqitjes klinike

Tabela 3.4.3 Rastet me TEP sipas moshës dhe paraqitjes klinike

Tabela 3.4.4 Rastet me TEP sipas seksit dhe frekuencës respiratore

Tabela 3.4.5 Rastet me TEP sipas seksit dhe frekuencës respiratore

Tabela 3.4.6 Rastet me TEP sipas seksit dhe frekuencës kardiake

Tabela 3.4.7 Rastet me TEP sipas moshës dhe frekuencës respiratore

Tabela 3.4.8 Rastet me TEP sipas moshës dhe frekuencës respiratore

Tabela 3.4.9 Rastet me TEP sipas moshës dhe frekuencës kardiake

Tabela 3.5.1 Rezultatet e probabilitetit klinik të TEP në lidhje me seksin

Tabela 3.5.2 Rezultatet e Geneva score në lidhje me seksin

Tabela 3.5.3 Rezultatet e Pesi në lidhje me seksin

Tabela 3.5.4 Rezultatet e sPesi në lidhje me seksin

Tabela 3.5.5 Rezultatet e probabilitetit klinik të TEP në lidhje me moshën

Tabela 3.5.6 Rezultatet e Geneva score në lidhje me moshën

Tabela 3.5.7 Rezultatet e Pesi në lidhje me moshën

Tabela 3.5.8 Rezultatet e sPesi në lidhje me moshën

Tabela 3.6.1 Prania e TVTH në lidhje me seksin

Tabela 3.6.2 Të dhëna të EchoDoppler në lidhje me seksin

Tabela 3.6.3 Prania e TVTH në lidhje me moshën

Tabela 3.6.4 Të dhëna të EchoDoppler në lidhje me moshën

Tabela 3.6.5 Lokalizimi i TVTH në lidhje me seksin

Tabela 3.6.6 Lokalizimi i TVTH në lidhje me moshën

Tabela 3.7.1 Të dhëna të rezultateve të pO₂ në lidhje me seksin

Tabela 3.7.2 Të dhëna të rezultateve të pO₂ në lidhje me moshën

Tabela 3.7.3 Të dhëna të rezultateve të pCO₂ në lidhje me seksin

Tabela 3.7.4 Të dhëna të rezultateve të pCO₂ në lidhje me moshën

Tabela 3.7.5 Të dhëna të rezultateve të pH në lidhje me seksin

Tabela 3.7.6 Të dhëna të rezultateve të pH në lidhje me moshën

Tabela 3.7.7 Të dhëna të rezultateve të HCO₃ në lidhje me seksin

Tabela 3.7.8 Të dhëna të rezultateve të HCO₃ në lidhje me moshën

Tabela 3.7.9 Të dhëna të rezultateve të SaO₂ në lidhje me seksin

Tabela 3.7.10 Të dhëna të rezultateve të SaO₂ në lidhje me moshën

Tabela 3.7.11 Të dhëna të rezultateve të AaDO₂ në lidhje me seksin

Tabela 3.7.12 Të dhëna të rezultateve të AaDO₂ në lidhje me moshën

Tabela 3.7.13 Të dhëna të rezultateve të pH normal në lidhje me HCO₃ dhe pCO₂

Tabela 3.7.14 Të dhëna të rezultateve të pH < 7.38 në lidhje me HCO₃ dhe pCO₂

Tabela 3.7.15 Të dhëna të rezultateve të pH > 7.42 në lidhje me HCO₃ dhe pCO₂

Tabela 3.8.1 Të dhëna të rezultateve të hematokritit në lidhje me seksin

Tabela 3.8.2 Të dhëna të rezultateve të azotemisë në lidhje me seksin

Tabela 3.8.3 Të dhëna të rezultateve të fibrinogjenit në lidhje me seksin

Tabela 3.8.4 Të dhëna të rezultateve të hematokritit në lidhje me moshën

Tabela 3.8.5 Të dhëna të rezultateve të azotemisë në lidhje me moshën

Tabela 3.8.6 Të dhëna të rezultateve të fibrinogjenit në lidhje me moshën

Tabela 3.8.7 Të dhëna të rezultateve të D-dimer në lidhje me seksin

Tabela 3.8.8 Të dhëna të rezultateve të D-dimer në lidhje me moshën

Tabela 3.9.1 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit EKG sipas seksit

Tabela 3.9.2 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit EKG sipas moshës

Tabela 3.9.3 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit Echografik

Tabela 3.9.4 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit Echografik sipas seksit

Tabela 3.9.5 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit Echografik sipas moshës

Tabela 3.9.6 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit radiografik të toraksit

Tabela 3.9.7 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit radiografik të toraksit sipas seksit

Tabela 3.9.8 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit radiografik të toraksit sipas moshës

Tabela 3.9.9 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit angioCT sipas seksit

Tabela 3.9.10 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit angioCT sipas moshës

Tabela 3.9.11 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit EchoDoppler sipas seksit

Tabela 3.9.12 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit shintigrafik

Tabela 3.10.1 Të dhëna të trajtimit të TEP në lidhje me seksin

Tabela 3.10.2 Të dhëna të trajtimit të TEP në lidhje me moshën

Tabela 3.11.1 Te dhena të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.2 Grupmosha e pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.3 Prejardhja e pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.4 Mënyra e shtrimit të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.5 Ngjarja e pare apo recidiva e pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.6 Profesionit i pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.7 Sëmundjet shoqëruese të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.8 Nozologjia e sëmundjeve shoqëruese të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.9 Simptomat dhe shenjat klinike të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.10 Faktorët e fituar të riskut të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.11 Frekuenca e faktorëve të fituar të riskut të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.12 Të dhëna të EKG të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.13 Frekuenca e ndryshimeve ekokardiografike të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.14 Të dhëna të radiografisë torakale të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.15 Të dhëna të angioCT të pacientëve me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.16 Frekuenca respiratore në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.17 Frekuenca kardiake në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.18 Rezultate të azotemisë në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.19 Rezultate të fibrinogjenit në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.20 Rezultate të pH në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.21 Rezultate të pO₂ në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.22 Rezultate të pCO₂ në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.23 Rezultate të SaO₂ në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.24 Rezultate të HCO₃ në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.25 Rezultate të BE ne pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.26 Rezultate të D-dimer në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.27 Probabiliteti klinik në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.28 Geneva score në pacientët me EP të vdekur në spital

Tabela 3.11.29 Rezultate PESI në pacientët me EP të vdekur në spital

LISTA E FIGURAVE

Figura 3.1.1 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grup moshës

Figura 3.1.2 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas banimit

Figura 3.1.3 Vdekjet nga EP në të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grup moshës dhe gjinisë

Figura 3.2.1 Rastet me TEP sipas seksit dhe prejardhjes

Figura 3.2.2 Rastet me TEP sipas seksit dhe prejardhjes

Figura 3.2.3 Rastet me TEP sipas seksit dhe grupmoshës

Figura 3.2.4 Rastet me TEP sipas moshës dhe prejardhjes

Figura 3.2.5 Rastet me TEP sipas seksit dhe profesionit

Figura 3.2.6 Rastet me TEP sipas moshës dhe profesionit

Figura 3.2.7 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit

Figura 3.2.8 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit cigare/ditë

Figura 3.2.9 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitet e përdorimit të duhanit

Figura 3.2.10 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitet e ndërprerjes duhanit

Figura 3.2.11 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit

Figura 3.2.12 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit cigare/ditë

Figura 3.2.13 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të përdorimit të duhanit

Figura 3.2.14 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të ndërprerjes të duhanit

Figura 3.2.15 Rastet me TEP sipas seksit dhe mënyrës së shtrimit

Figura 3.2.16 Rastet me TEP sipas seksit dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Figura 3.2.17 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitit të shtrimit të parë

Figura 3.2.18 Rastet me TEP sipas moshës dhe llojit të shtrimit

Figura 3.2.19 Rastet me TEP sipas moshës dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Figura 3.3.1 Shpeshhtësia e faktorëve të fituar të riskut në pacientët me TEP

Figura 3.4.1 Rastet me TEP sipas paraqitjes klinike

Figura 3.4.2 Rastet me TEP sipas seksit dhe paraqitjes klinike

Figura 3.4.3 Rastet me TEP sipas seksit dhe frekuencës respiratore

Figura 3.4.4 Rastet me TEP sipas seksit dhe frekuencës respiratore

Figura 3.4.5 Rastet me TEP sipas seksit dhe frekuencës kardiake

Figura 3.4.6 Rastet me TEP sipas moshës dhe frekuencës respiratore

Figura 3.4.7 Rastet me TEP sipas moshës dhe frekuencës respiratore

Figura 3.4.8 Rastet me TEP sipas moshës dhe frekuencës kardiake

Figura 3.5.1 Rezultatet e probabilitetit klinik të TEP në lidhje me seksin

Figura 3.5.2 Rezultatet e Geneva score në lidhje me seksin

Figura 3.5.3 Rezultatet e Pesi në lidhje me seksin

Figura 3.5.4 Rezultatet e sPesi në lidhje me seksin

Figura 3.5.5 Rezultatet e probabilitetit klinik të TEP në lidhje me moshën

Figura 3.5.6 Rezultatet e Geneva score në lidhje me moshën

Figura 3.5.7 Rezultatet e Pesi në lidhje me moshën

Figura 3.5.8 Rezultatet e sPesi në lidhje me moshën

Figura 3.5.9 Krahasimi i probabilitetit sipas probabilitetit klinik dhe Geneva score

Figura 3.5.10 Krahasimi i rezultatit të riskut sipas PESI dhe sPesi

Figura 3.6.1 Prania e TVTH në lidhje me seksin

Figura 3.6.2 Të dhëna të EchoDoppler në lidhje me seksin

Figura 3.6.3 Prania e TVTH në lidhje me moshën

Figura 3.6.4 Të dhëna të EchoDoppler në lidhje me moshën

Figura 3.7.1 Të dhëna të rezultateve të pO₂ në lidhje me seksin

Figura 3.7.2 Të dhëna të rezultateve të pO₂ në lidhje me moshën

Figura 3.7.3 Të dhëna të rezultateve të pCO₂ në lidhje me seksin

Figura 3.7.4 Të dhëna të rezultateve të pCO₂ në lidhje me moshën

Figura 3.7.5 Të dhëna të rezultateve të pH në lidhje me seksin

Figura 3.7.6 Të dhëna të rezultateve të pH në lidhje me moshën

Figura 3.7.7 Të dhëna të rezultateve të HCO₃ në lidhje me seksin

Figura 3.7.8 Të dhëna të rezultateve të HCO₃ në lidhje me moshën

Figura 3.7.9 Të dhëna të rezultateve të SaO₂ në lidhje me seksin

Figura 3.7.10 Të dhëna të rezultateve të SaO₂ në lidhje me moshën

Figura 3.7.11 Rastet me TEP sipas seksit dhe AaDO₂

Figura 3.8.1 Të dhëna të rezultateve të hematokritit në lidhje me seksin

Figura 3.8.2 Të dhëna të rezultateve të azotemisë në lidhje me seksin

Figura 3.8.3 Të dhëna të rezultateve të fibrinogjenit në lidhje me seksin

Figura 3.8.4 Të dhëna të rezultateve të hematokritit në lidhje me moshën

Figura 3.8.5 Të dhëna të rezultateve të azotemisë në lidhje me moshën

Figura 3.8.6 Të dhëna të rezultateve të fibrinogjenit në lidhje me moshën

Figura 3.8.7 Të dhëna të rezultateve të D-dimer në lidhje me seksin

Figura 3.8.8 Të dhëna të rezultateve të D-dimer në lidhje me moshën

Figura 3.9.1 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit EKG sipas seksit

Figura 3.9.2 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit Echografik

Figura 3.9.3 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit radiografik të toraksit

Figura 3.9.4 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit angioCT

Figura 3.9.5 Të dhëna të rezultateve të ekzaminimit EchoDoppler

Figura 3.11.1 Grupmosha e pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.2 Prejardhja e pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.3 Mënyra e shtrimit e pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.4 Ngjarja e parë apo recidiva e pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.5 Profesionit i pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.6 Nozologjia e semundjeve shoqëruese të pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.7 Simptomat dhe shenjat klinike të pacientëve me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.8 Frekuenca respiratore në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.9 Frekuenca kardiake në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.10 Rezultate të azotemisë në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.11 Rezultate të fibrinogjenit në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.12 Rezultate të pH në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.13 Rezultate të pO₂ në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.14 Rezultate të pCO₂ në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.15 Rezultate të SaO₂ në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.16 Rezultate të HCO₃ në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.17 Rezultate të BE në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.18 Rezultate të D-dimer në pacientët me EP të vdekur në spital

Figura 3.11.19 Rezultate PESI në pacientët me EP të vdekur në spital

PARATHËNIE

Tromboembolia pulmonare (TEP) është një nga patologjitë më frekvente dhe me mortalitet të lartë. Gjithashtu diagnoza e TEP mbetet një nga problemet më të vështira me të cilën përballen klinicistët. Embolia pulmonare është një sëmundje e rëndë me incidencë dhe mortalitet të lartë. Diagnoza vazhdon të jetë një sfidë – ku rreth 50% e embolive pulmonare fulminante nuk njihen para vdekjes së pacientit. Prevalenca e embolisë pulmonar në autopsi vazhdon të jetë e lartë, duke përbërë 12-15% të pacientëve, që kanë qenë të hospitalizuar. Vetëm në rreth 30% të rasteve të vërtetuara nga autopsia diagnoza është bërë gjatë jetës.

Pas sëmundjes së arterieve koronare dhe iktus, EP akute renditet e treta në mesin e llojeve më të zakonshme të sëmundjeve kardiovaskulare. Nëse nuk trajtohet, EP akute është e lidhur me një shkallë të konsiderueshme të vdekshmërisë (deri në 30%), ndërsa shkalla e vdekshmërisë së EP të diagnostikuar dhe të trajtuar është 2-8%.

Karakteristikë e embolisë pulmonare është mortaliteti i hershëm. Brenda një deri në dy orë pas fillimit të simptomatologjisë, ndodhin 45-90% e të gjitha vdekjeve gjatë TEP. Në rastet që mbijetojnë ngjarjet embolike, rreziku afatgjatë është manifestimi i hipertensionit pulmonar. Kjo shkaktohet nga përsëritja, shpesh nga mikroembolitë klinikisht jo evidente dhe/ose riperfuzionimi i pamjaftueshëm i shtratit pulmonar pas trombembolisë.

Kërkesat mjekësore, si në diagnozë dhe terapi të embolisë pulmonare, janë ndërdisiplinore në bashkëpunim të ngushtë midis specialiteteve mjekësore, duke patur njohuri të sakta të ndryshimeve patofiziologjike.

Megjithë përparimet në parandalimin, diagnozën dhe trajtimin e tromboembolisë, embolia pulmonare akute është një nga shkaqet kryesore të vdekjes. Diagnostikimi në kohë i embolisë pulmonare dhe fillimi i shpejtë i terapisë së duhur zvoglon ndjeshëm mortalitetin dhe pasojat. Nga ana tjetër procedimi me hamendje, në mungesë të diagnozës së saktë, bën që të aplikohet mjekim i panevojshëm potencialisht i rrezikshëm dhe i shtrenjtë.

Duke u nisur nga arsyet e mësipërme dhe në vazhdimësi dhe të punimit “Të dhëna klinike – paraklinike të Tromboembolisë pulmonare”(Punim Master,2006) u vlerësua e rëndësishme nevoja e një analize dhe studimi të thelluar klinik të TEP, identifikimit dhe diagnostikimit sa më të hershëm të tij. Mendojmë që ky punim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë mbi rritjen e aftësive diagnostike – mjekuese, në minimizimin e pasojave

invalidizuese dhe frekuencës së mortalitetit, nëpërmjet konsolidimit të strategjive profilaktike, terapeutike dhe mjekuese. Gjithashtu do të kontribuojë në kosto efektivitetin e shërbimit shëndetësor.

1. HYRJE

1.1 Të dhëna të literaturës

Embolizmi pulmonar (EP) është obstrukcioni akut (i plotë ose i pjesshëm) i një ose më shumë degëve të arteries pulmonare të shkaktuar nga materiali embolik me origjinë ekstrapulmonare nga qarkullimi venoz sistemik. Nëse kjo pengesë shkaktohet nga materiali trombotik, përcaktohet më saktësisht nga termi tromboembolizëm pulmonar (TEP).

Embolizmi pulmonar është emergjenca e tretë më e shpeshtë kardiovaskulare pas infarktut akut të miokardit dhe ictusit cerebral dhe është shkaku kryesor i vdekjes në shtatzani. Vlerësohet incidencë vjetore prej rreth 100 rastesh të reja për 100,000 njerëz; kjo incidencë tenton të rritet në mënyrë progresive, si në burra ashtu edhe në gra, me përparimin e moshës; kulmi i incidencës është regjistruar në subjekte mbi 70 vjeç. (1) Përcaktimi i saktë i incidencës së kësaj patologjie është mjaft i vështirë për shkak të vështirësive të ngritjes së dyshimit klinik dhe zbatimit të procedurave të ndryshme diagnostikuese. Sipas Heit, incidenca e tromboembolisë venoze, e cila përfshin trombozën e thellë venoze (TVTH) dhe EP, është 117 raste në vit për 100,000 banorë.

(2)

Embolia pulmonare është një sëmundje e rëndë me incidence dhe mortalitet të lartë. Diagnoza vazhdon të jetë një sfidë. (3).

1.2 Të dhëna historike

Një tekst mjekësor indian nga Susruta (rreth 600-1000 BCE) përshkroi një pacient që kishte "këmbë të ënjtura dhe të dhimbshme, që ishte e vështirë për t'u trajtuar" (4). Një referencë e parë për këtë patologji tashmë mund të gjendet në Galenin, i cili në shekullin e 2 pas Krishtit. hipotezoi mundësinë e infarktut nga embolia pulmonare në pacientët astmatikë. Përveç kësaj, ka mungesë të dhenave të trombozës së thellë venoze në antikitet. (5) Në një rishikim të literaturës mjekësore të 20 shekujve të mëparshëm, John Hull në 1800 (6) nuk gjeti asnjë përmendje të sëmundjes, që sugjeronte trombozë venoze ose tromboflebit, po ashtu dhe autorë të tjerë e konfirmuan këtë. (7) Në artin e Greqisë, Romës, Egjiptit, Persisë, vendeve arabe apo në

Amerikën e Jugut, nuk ka raste të paraqitjes së fryrjes së këmbës së njëanshme në statuja, basorelieve, gdhendje, piktura, figurina, bizhuteri, qeramikë, gdhendje apo monedha. (7) Një pllakë kushtimore nga Asklepion në Athinë paraqet një këmbë me venat me variçe, por jo edemë. (8) Shembulli i parë i ënjtjes unilaterale të një këmbë, me sa duket nga TVTH, u ilustrua në një dorëshkrim francez të shekullit të 13-të, i cili u riprodhua në një artikull nga Dr Lewis Dexter. (5) Ilustrimi tregon një burrë me edemë unilaterale të këmbës dhe nëntë fistula, me sa duket abscese. Henri VIII i Anglisë (1491-1547) kishte trauma të shumëfishta këmbësh, ulcera të këmbëve dhe edema të këmbëve tipike të TVTH kronike. (9) Ai përdori si mjekim më të efektshëm aplikimin e pluhurit të perlave në ulçerën e këmbës. Megjithatë, referimi i drejtpërdrejtë për EP dhe infarktin e mushkërive është i pranishëm në punën e Laennec, ku flasim për "apopleksi pulmonare". (2)

Përshkrimi i parë i embolise pulmonare mund të jetë nga Giovanni Battista Morgagni në 1761. (10) Ai përshkroi trombose të mëdha të gjakut në enët pulmonare të pacientëve që vdiqën papritur, por nuk ishte në gjendje të jepte një shpjegim për praninë e tyre.

Por përkufizimi i parë i EP është nga Hélié, një mjek francez, i cili në 1837 e përshkroi në literaturë rastin e parë të EP. Ishte një punëtore lavanderie 65 vjeçare, e cila ishte e shkurtër dhe mbipeshë, e cila u shtrua në spital për distorsion të ekstremitetit inferior dhe dy javë më vonë, ndërsa bisedonte me fqinjët, asaj papritmas ju shfaq cianoze e fytyrës. Pas disa minutash e rimori vehten, por vdiq pak pas kësaj gjatë një aksesi të ngjashëm. Në autopsi mjeku përshkroi "një zemër të zgjeruar dhe mpiksje të errët të organizuara mirë në ventrikulin e djathtë dhe në arterien pulmonare". (2)

Rudolf Virchow (1821-1902) tregoi se shkaqet themelore të trombozës intravaskulare janë hiperkoagulabiliteti i gjakut, lezionimi i paretit vazal dhe staza në qarkullimin e gjakut.

1.3 Epidemiologjia

Embolia pulmonare është një sëmundje e rëndë me incidence të lartë dhe mortalitet. Gjithashtu diagnoza e TEP mbetet një nga problemet më të vështira me të cilën përballohen klinikistët. Diagnoza vazhdon të jetë sfidë – ku deri rreth 50% e embolive pulmonare fulminante nuk njihen para vdekjes së pacientit. (3) Incidenca vjetore e TVTh dhe EP në popullatën në përgjithësi të Vendeve perëndimore është vlerësuar respektivisht 1,0 dhe 0,5 për 1000. (11) Sipas (12) TEV

është një çrregullim relativisht i zakonshëm që prek 1-2 për 1000 individë çdo vit, dhe incidenca rritet ndjeshëm me moshën, nga rreth 1 në 10 000 në të rriturit e rinj, në 1 në 100 në të moshuar. Sipas autorëve, megjithëse nuk disponohen të dhëna të sakta epidemiologjike, incidenca e EP vlerësohet të jetë përafërsisht 60 deri 70 për 100,000, dhe ajo e trombozës venoze rreth 124 për 100,000 të popullsisë së përgjithshme. (13,14) Udhëzuesit europianë në raportet për diagnozën dhe menaxhimin të EP tregojnë përqindjet vjetore të incidencës së trombozës venoze dhe EP prej afërsisht 0,5 deri 1,0 për 1000 banorë. (15) Megjithatë, shifrat aktuale kanë gjasa të jenë dukshëm më të larta, sepse EP e heshtur mund të zhvillohet deri në 40% në 50% të pacientëve me trombozë të thellë venoze (TVTH). (16) Përveç kësaj, studimet e autopsisë kanë treguar se EP ishte diagnostikuar para vdekjes në 30% deri në 45% të pacientëve. (17) Pas sëmundjes së arteries koronare dhe iktus, EP akute renditet e treta në mesin e llojeve më të zakonshme të sëmundjeve kardiovaskulare. Ndërsa të dhënat klinike tregojnë se shumica e rasteve të EP ndodhin në moshën 60-70 vjeç, të dhënat e autopsisë tregojnë incidencë më të lartë tek individët 70 deri në 80 vjeç. Nëse nuk trajtohet, EP akute është e lidhur me një shkallë të konsiderueshme të vdekshmërisë (deri në 30%), ndërsa shkalla e vdekshmërisë së EP të diagnostikuar dhe të trajtuar është 8%. Deri në 10% të pacientëve akutë EP vdes papritmas. Dy nga tre pacientë që pesojne EP vdesin brenda 2 orëve pas paraqitjes. (15, 18) Në rajonin e Oksfordit të Mbretërisë së Bashkuar, frekuenca e shtrimit të TEV ra nga mesi i viteve 1970 deri në vitin 1988. (19) Në pacientët me moshë më të vogël se 50 vjeç, frekuenca ishte më e lartë tek gratë sesa tek meshkujt dhe pati rënje pak më shumë tek gratë krahasuar me burrat. Në pacientët e moshës 50 vjeç e lart, përqindjet e shtrimit në spital ishin më të larta tek meshkujt se sa gratë dhe paraqiten rënje të ngjashme për të dyja gjinitë. Në fillim të viteve 1990, shpeshësitë e shtrimeve në spital për EP filluan të rriten në të dy grupet e moshave të vjetra dhe në të dy gjinitë. (20) Në lidhje me normat e vdekshmërisë në rajonin e Oksfordit, kishte një rënie të vazhdueshme të vdekshmërisë së EP nga fundi i viteve 1970 deri në vitet 1990. Ky trend ishte i ngjashëm si në meshkuj ashtu edhe në femra dhe në grupmoshat më të reja dhe të vjetra. (20)

Në Distriktin Brest të Francës Perëndimore, me një popullsi prej 342,000 banorë, incidenca e EP ishte 1.8 për 1,000 në vit. (13) TVTH pa EP kishte një incidencë prej 1.2 për 1,000 në vit, ndërsa EP me ose pa TVTH kishte një incidencë prej 0.6 për 1,000 në vit. Incidenca EP u rrit ndjeshëm me rritjen e moshës për burrat dhe gratë. Për ata mbi moshën 75 vjeç, incidenca ishte 1 për 100

në vit. EP ndodhi në shtëpi në 63% të individeve të prekur. Prej tyre, 16% ishin të hospitalizuar në periudhën e 3 muajve të mëparshëm. (20) Sipas një rishikimi retrospektiv i një grupi të bazuar në popullsi, rezultoi incidencë e EP prej 1.2 për 10,000 në vit. Incidenca u rrit ndjeshëm me rritjen e moshës. (21)

Midis grupeve me rrezik të lartë për emboli pulmonare venoze (EPV), frekuenca e EP asimptomatike ka gjasa edhe më të larta se ajo që është raportuar në mesin e pacientëve tëskanuar për arsye të tjera, sesa në ata të skanuar për të përjashtuar EP. Për shembull, në një studim të vogël të 48 pacientëve ortopedikë, 4% e pacientëve që kanë nënshtruar artroplasti totale të gjurit dhe 5% e atyre që i janë nënshtruar artroplasti koksofemorale, kanë pasur EP në 24-36 orë pas operacionit. (22)

Prevalenca e EP në autopsi (afërsisht 12–15% në të hospitalizuar) nuk ka ndryshuar për tre dekada.(23) Në ecurinë imediate, sipas studimit ICOPER (18), që përfshin 2454 pacientë me EP akute, mortaliteti gjatë tre muajve ka qenë 17,5%. Disa herë EP paraqet ‘coup de grace’ për pacientë të destinuar të vdesin. Sidoqoftë nga autopsi të ndryshme referohet për 27% deri 68% vdekje “të prevenueshme”. (24) Në perspektivën e largët ka risk të zhvillimit të hipertensionit pulmonar si pasojë e embolizmit të përsëritur apo mungesës së rekanalizimit vaskular.

Nuk mund të percaktohet numri i rasteve klinikisht të heshtura, jo fatale. Dihen diskordancat klinike dhe autopsike. Zbulimi në autopsi i EP të pa suspektuara, fatale apo kontribuese në vdekje, ka diapazon nga 3% deri 8%. (23)Sipas Stein e bshp, EP në autopsi shkaktoi vdekjen në 5%, kontribuoi në vdekje në 0.5% dhe ishte e rastësishme në 9.2% të 404 autopsive. Shumë pacientë me EP të mëdha ose fatale të pa dyshuara kishin sëmundje të avancuara shoqëruese. Pacientët që vuajnë ngjarje të papritura dhe të pashpjegueshme në spital janë një grup në të cilin mund të dyshohet diagnoza e EP. (23)

1.4 Faktoret etiologjike

EPV aktualisht konsiderohet të jetë rezultat i një ndërveprimi midis faktorëve të rrezikut të lidhura me pacientin dhe të situatës. (25) Faktorët predispozues të lidhura me pacientin zakonisht janë të përhershëm, ndërkohë që faktorët e rrezikut që lidhen me situatën janë më shpesh të përkohshëm. Megjithatë, vlerat parashikuese të këtyre faktorëve nuk janë të barabartë dhe EPV mund të ndodhë në pacientë pa ndonjë faktor predispozues të identifikueshëm.

Rudolf Virchov mori si të mirëqenë një shekull më parë tre faktorë potencialë, që mbivendosen me njeri tjetrin, që predispozojnë për trombozë venoze: trauma lokale e paretit të vazës, hiperkoagulibiliteti dhe staza. Sot ne besojmë se shumica e pacientëve që vuajnë nga EP kanë një predispozicion të trashëguar, që mbetet klinikisht i heshtur gjer sa ndodh një stresues i fituar i tillë si kirurgji, obezitet, gravidancë. Kur identifikohet EP duhet të kërkohet një anamnezë familjare e detajuar për tromboembolizëm venoz.

Kondita që lidhen me një rrezik në rritje të trombozës përfshijnë si më poshtë:

- Kondita primare (gjenetike)

Mutacionet në faktorin V (Rezistenca ndaj proteinës C të aktivizuar)

Deficit i antitrombinës III

Deficiti i proteinës C ose proteinës S

Defekt i fibrinolizës

Hiperhomocisteinemia

- Kondita sekondare (të fituara)

Qendrim i zgjatur në shtrat ose imobilizim (shumë orë udhëtimi)

Infarkti i miokardit

Dëmtim indor (kirurgji, frakturë, djegie)

Kancer

Protezë valvulare kardiake

Koagulimi intravaskular i diseminuar

Lupus antikoagulant

Fibrilacioni atrial

Kardiomiopati

Sindromi nefrotik

Gravidanca dhe periudha puerperale

Gjendje hiperestrogjenike

Përdorimi kontraktivëve oral

Anemia e drepanocitare

Pirja e duhanit

Gjendje inflamatore kronike

Hiperviskozitet hematik

Obeziteti

Iktus

Gjendje të hiperkoagulimit, trombofili apo çrregullime protrombotike, janë çrregullime që predispozojnë pacientin ndaj tromboembolizmit venoz dhe nganjëherë arterial.

Identifikimi i gjendjeve të tilla mund të indikojë nevojën e profilaksisë agresive gjatë periudhave me risk të lartë, nevojën për mjekim të zgjatur pas episodeve fillestare të EP, evitimin e kontraceptivëve oralë dhe ekzaminimin e familjarëve asimptomatik, kur është identifikuar një çrregullim familjar.

1.5 Shkaqe primare (gjenetike)

Pacientët me trombofili të trashëguar kanë tendencë të kenë episode klinike të tromboembolisë venoze (TEV) para moshës 45 vjeçare dhe episodet kanë tendencë të jenë periodike. (26) Edhe pse rreziku relativ për EPV mund të jetë 2-11 herë, rreziku aktual mbetet relativisht modest. (27)

Rezistenca ndaj proteinës C të aktivizuar (Faktori V Leiden) është një çrregullim hemostatik i karakterizuar nga një përgjigje e dobët antikoagulante ndaj proteinës C të aktivizuar (APC). Kjo shkakton një rrezik të rritur të ngjarjeve trombotike të venave, të cilat mund të shkaktojnë probleme të qarkullimit të gjakut siç është embolia pulmonare. (28) Ky çrregullim i koagulimit mund të jetë i lindur ose i fituar, ku forma e trashëguar transmetohet në mënyrë autosomale dominante. (29) Proteina C e aktivizuar (me proteinen S si një kofaktor) degradon faktorët Va dhe VIIIa. Rezistenca ndaj proteinës së aktivizuar C është pamundësia e proteinës C për të inaktivuar një ose të dy faktorët e aktivizuar, V ose VIII. Kjo rezulton në një gjenerim të zgjatur të trombinës, që mund të çojë në një gjendje hiperkoagulimi.

Megjithatë faktori V Leiden është më i zakonshëm se gjithë gjendjet e hiperkoagulimit të trashëguar të tjerë të identifikuar, përfshirë mutacionin e genit të protrombinës, deficitin e proteinës C, proteinës S, antitrombinës III dhe çrregullimeve të plasminogjenit.

Rreth 4-7% e popullsisë së përgjithshme është heterozigot për faktorin V Leiden dhe rreth 0.06-0.25% e popullsisë është homozigot për faktorin V Leiden. (26) Prevalenca e faktorit V Leiden në pacientët me trombozë venoze të pashpjegueshme është 20%. (30) Tromboza e thellë venoze, me ose pa EP, ishte e pranishme në 57% të pacientëve me mutacione të faktorit V Leiden. Pacientët me faktor V mutacion Leiden paraqiten me një rritje të rrezikut të trombozës prej dy deri në tetëfish krahasuar me individët me koagulim normal. (26) Rreziku relativ i trombozës për bartësit u tregua se është rritur shtatëfish për heterozigotët dhe 80-fish për homozigotët tek pacientët <70 vjeç pa asnjë malinjitet. (31)

Deficiti i Antitrombines III

Megjithëse hiperkoagulabiliteti ishte implikuar për herë të parë në trombozën venoze nga Virchow në 1856, ishte gati një shekull më vonë që u identifikua shkaku i parë specifik, një mangësi e antitrombin III. (32) Antitrombina III është një antikoagulant natyral, që inaktivizon një numër enzimesh në kaskadën e koagulimit (faktorët IIa, IXa, Xa, XIa dhe XIIa). Mangësia e antitrombines III trashëgohet si një tip dominues autosomal me heterozigotë, që kanë një rrezik të rritur të TEV. Ka dy lloje të mangësisë së antitrombinës III. Në mungesën e tipit I, ka një reduktim të antitrombinës funksionale dhe në mungesën e tipit II, ekziston një molekulë anormale. (33) Pacientët me deficit të antitrombinës III kanë një rrezik 8-10 herë më të madh të zhvillimit të trombozës sesa individët me koagulim normal. (26)

Deficiti i proteinës C

Mungesa e proteinave C trashëgohet si një çrregullim autosomal dominues dhe heterozigot është një faktor i rëndësishëm rreziku për TEV. Janë raportuar dy lloje të mungesës së proteinave C. (26) Mungesa e tipit I është një mangësi sasiore me sasi të reduktuara të aktivitetit të proteinave C për shkak të sintezës së reduktuar. Mungesa e tipit II është një defekt kualitativ për shkak të një molekule C defektive të proteinave. Heterozigot për mungesën e proteinave C është gjetur në rreth 6% të familjeve me trombofilinë e trashëguar, në 3% të pacientëve me një episod të parë të TVTH të pashpjeguar dhe në 0,3% të individëve të shëndetshëm. (34) Prevalenca e mungesës së proteinave C në pacientët me trombozë varion nga 1.5 deri në 11.5%. (35) Tromboza e thellë venoze, me ose pa EP, ishte e pranishme në 88% të pacientëve me

mangësi të proteinave C. (26) Pacientët me mangësi të proteinave C kanë një rrezik 4-10 herë më të madh të trombozës në krahasim me grupet e kontrollit me koagulim normal. (26)

Deficiti i proteinës S

Mungesa e proteinave S trashëgohet si një çrregullim autosomal dominues, me heterozigotë, që kanë një rrezik të rritur të TEV në krahasim me anëtarët të pandikuar të familjes së tyre. (36) Ekzistojnë tre klasifikime të mungesës së proteinave S. Mungesa e tipit I rezulton nga një sasi jo adekuate e proteinave normalisht funksionale S të pranishme në të dy format e lira dhe të lidhura. Mungesa e tipit II është një molekulë S defektive e proteinave. Mungesa e proteinës S të tipit III karakterizohet nga një sasi e vogël e proteinave S të lirë, por sasi e përgjithshme normale e proteinës totale S. Shumica e pacientëve me mungesë të proteinave S kanë mangësi të tipit I, prevalenca e të cilave është 6% në familje me trombofilinë e trashëguar dhe 1-2% të pacientëve me TVTH për herë të parë të pashpjeguar. (34) Prevalenca e mungesës së proteinave S në pacientët me trombozë varion nga 1.5 në 13.2%. (35) Në pacientët me mungesë të proteinave S, 74% zhvillojnë TVTH dhe 72% zhvillojnë tromboflebitin sipërfaqësor. (36) Të tjerë raportojnë TVTH, me ose pa EP, të jenë të pranishëm në 100% të pacientëve me deficiencë proteine S. (26) Pacientët me mungesë të proteinave S kanë një rrezik 8-10 herë më të lartë të trombozës krahasuar me individë me koagulim normal. (26)

Mutacioni i Prothrombin G20210A

Aleli G20210A i protrombinës është për shkak të një tranzicioni glicinë në argininë në pozicionin 20210 të gjenit të protrombines. (33) Geni jo normal shkakton koncentime të rritura të protrombines. Mendohet se rritja e sasisë së protrombinës qarkulluese rregullon kaskadën e koagulimit. (33) Prevalenca e mutacionit G20210A të protrombinës në popullatën e përgjithshme është 2%. (30) Rreth 6.2% e pacientëve me mutacionin e gjenit G20210A të protrombinës kishin trombozë venoze. (30, 33)

Rritja e niveleve të faktorit VIII

Prevalenca e niveleve të rritura të faktorit VIII në kaukazianët në popullatën e përgjithshme është 11%. (30) Pacientët me nivele të larta të faktorit VIII (> 1500 IU/L) kishin rrezik

pesëfishor rritje për trombozë kur krahasoheshin me pacientët me nivele më të ulëta të faktorit VIII (<1000 IU/L). (37) Midis pacientëve që paraqitnin një episod fillestar të TVTH të pashpjeguar, 25% kishin nivele të faktorit VIII mbi 1500 IU/L. (30, 38) Për çdo rritje prej 100 IU/L në nivelet e faktorit VIII, rreziku për një episod të vetëm të TVTH u rrit 10% dhe rreziku për TVTH recidivues 24%. (39) Faktori VIII mund të rritet gjatë një sëmundje akute. (40) Për këtë arsye, duhet të matet niveli i proteinës C-reaktive për të përcaktuar nëse rritja e faktorit VIII ka të ngjarë të jetë reagues i fazës akute. (40) Shtatzënia dhe përdorimi i kontraktivëve oralë mund të rrisin nivelet e faktorit VIII. (41)

Nivelet e rritura të faktorit XI

Nivelet e rritura të faktorit XI, një komponent i mekanizmave intrinseke, janë implikuar si një faktor rreziku për TEV. (42) Rritja mbi 110 U/dl në nivelet e faktorit XI u shoqërua me 2,2-fish rritje të rrezikut të trombozës venoze (38, 42)

Defiçiti i kofaktorit II të Heparinës

Kofaktori II i heparinës, i njohur gjithashtu si kofaktor A i heparinës ose kofaktor dermatan sulfat, frenon trombin duke formuar një kompleks heparin-kofaktortrombinë II. (43) Funkzioni fiziologjik i molekulës është i paqartë, por mund të shërbejë si agjent natyror antitrombozë në prani të sulfatit të dermatanit. Mungesa e trashëguar e kofaktorit II të heparinës është e rrallë. Ajo është e trashëguar si tipar autosomal dominant. Studime të kufizuara kanë treguar se heterozigota për mangësi heparin kofaktor II nuk është një rrezik i mundshëm për trombozë pa faktorët e tjerë të rrezikut shoqërues. (44) Disa, megjithatë, kanë raportuar episode trombotike në 36% të individëve me mangësi. (44)

Disifibrinogjenemite e trashëguara

Një numër i fibrinogjeneve anormale shoqërohen me sindromë hiperkoagulabiliteti të disifibrinogjenemive. Dhjetë për qind e pacientëve me disifibrinogjenemi zhvillojnë trombozë venoze me trombozë arteriale, që janë të rralla. (45) Disifibrinogjenemia hereditare është një

tipar dominues autosomal me përjashtim të disa rasteve që duket të jenë tipare recesive. (45) Koha e trombines (TT) është prova më e ndjeshme e shqyrtimit për disfibrinogjenitë. Koha e trombinës mund të zgjatet ose të shkurtohet dhe koha e reptilazës zgjatet gjithashtu. Pacientët me ngjarje të përsëritura trombotike mund të kërkojnë antikoagulum afatgjatë. (46)

Çrregullimet e prodhimit të plazminës

Displazminogjenemia, nivelet e ulëta të plasminogjenit, zvogëlimi i sintezës ose çlirimit të aktivatorit të plasminogjeneve të indeve dhe nivelet e rritura të inhibitorit të aktivizuesit të plasminogjenit shoqërohen me fibrinolizë të dëmtuar. (46)

Hiperhomocisteinemia

Nivelet e ngritura plazmatike të homocisteinës përbëjnë një faktor rreziku për trombozën venoze dhe atë arteriale. Disa sugjerojnë që hiperhomocisteinemia kontribuon në trombozën venoze dhe arteriale nga efekti i saj toksik në endotelin e enëve të gjakut dhe në kaskadën e koagulimit. (47) Hiperhomocisteinemia ndodh në 5-10% të popullsisë së përgjithshme (41) dhe në 10% të pacientëve me TEV (30), me një rrezik relativ të tromboembolisë venoze prej 2.5. (38, 47)

Sindroma e adezionit të trombociteve

Sindroma e adezionit të trombociteve është trashëguar sipas tipit dominues autosomal që rezulton në trombocitet që janë hiperagreguese ndaj epinephrinës dhe/ose adenosinë phosphate. (41) Si trombi arterial, ashtu edhe, në një masë më të vogël, trombi venoz mund të ndodhë në pacientët me sindromën e adezionit të trombociteve. (48)

Meqenëse faktorët e rrezikut gjenetik janë të rrallë ose kanë një efekt të dobët të përgjithshëm, dobia e tyre për praktikën klinike është ende minimale dhe rrallë ndikon në trajtimin. Kërkimi për trombofilinë nuk indikohet kur identifikohen faktorët e rrezikut të fituar (p.sh. operacioni ose

kanceri) dhe duhet të kufizohen në TEV idiopatike tek pacientët e rinj (<50 vjeç) ose në pacientët me TEV të përsëritura.

1.6 Shkaqe të fituara

Shumica e shkaqeve të fituara që predispozojnë për tromboza mund të vihen në dukje nga anamneza dhe ekzaminimi objektiv. Shkaqe kalimtare apo reversibël janë imobilizimi, trauma ose kirurgji e madhe, kontraceptivët orale, mjekimi zëvendësues me hormone, udhëtime të zgjatura. Shkaqet që janë në përgjithësi irreversibël përfshijnë sëmundjet mieloproliferative, sindroma nefrotike, neoplazitë, hemoglobinurinë paroksismale nokturne, sindromi antiphospholipid.

Shtatzënia dhe periudha pas lindjes

TEV është një nga shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënës. Rreth dy të tretat e rasteve të TEV ndodhin gjatë shtatzënisë dhe një të tretën pas lindjes. Një studim i rasteve tregoi se rreziku i TEV u rrit pesë herë gjatë shtatzënisë dhe u rrit 60 herë gjatë 3 muajve pas lindjes në krahasim me femrat jo shtatzëna. Rreziku ishte më i lartë në tremujorin e tretë të shtatzënisë dhe gjatë 6 javëve të para pas lindjes. Rreziku i trombozës gjatë shtatzënisë ndikohet nga prania e anomalive pro-trombotike. Femrat me Faktorin V Leiden ose protrombin 20210A, dy variante gjenetike pro-trombotike të zakonshme, kanë një rrezik të rritur prej 30 deri në 50 herë të TEV gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes në krahasim me ato që nuk janë shtatzënë.(49)

Terapia zëvendësuese hormonale dhe terapia kontraceptive orale

Shumica e kontraceptivëve oralë përbëhen nga një kombinim i estrogjenit dhe progjestogjenit. Reduktimi i dozës së estrogjenit me kalimin e kohës ka zvogëluar rrezikun e TEV në femra, megjithëse ka ende rrezik të rritur prej dy deri në pesëfish. (50) Meqenëse rreziku absolut i TEV është i ulët në femrat e reja, rreziku vjetor në përdoruesit e kontraceptivëve oralë mbetet e ulët në dy deri në tre raste për 10,000. Rreziku është më i lartë gjatë vitit të parë të përdorimit. Lloji i progjestogjenit ndikon në rrezikun e trombozës venoze, me një rrezik të dyfishtë më të lartë për kontraceptivët që përmbajnë një gjeneratë të tretë (desogestrel dhe gestodene) se sa një gjeneratë të dytë (levonorgestrel) progjestogjen. (50)

Terapia zëvendësuese e hormoneve është e përshkruar për trajtimin e simptomave të menopauzës dhe rrit rrezikun e TEV nga dy deri katër herë. (51) Megjithatë, ndryshe nga rruga orale e administrimit, estrogjeni transdermal nuk ka efekt të kalimit përmes mëlçisë dhe është sugjeruar që kjo mund të çojë në më pak rrezik të trombozës. Kohët e fundit, një studim i madh i rasteve multicentrike dhe një meta-analiza treguan se estrogjeni oral, por jo estrogjeni transdermal, rriti rrezikun e tromboembolizmit venoz

Krahasuar me mos përdoruesit e estrogjenit, raporti i shanseve të diagnozës fillestare të TEV në përdoruesit aktual të estrogjenit oral ishte 2.5 dhe në përdoruesit e estrogjenit transdermal ishte 1.2. (52) Rreziku i VTE në femrat që përdorin estrogjenin oral ishte më i lartë në vitin e parë të trajtimit krahasuar me trajtimin për > 1 vit. (52)

Pacientët me kancer të prostatës metastatike të trajtuara me diethylstilbestrol nga goja 3 mg/ditë zhvilluan trombozë të thellë venoze (TVTH) ose emboli pulmonare (EP) në 7 nga 101 (7%). (53)

Kanceri i avancuar që kanë pasur këta pacientë është gjithashtu i lidhur me gjendje hiperkoagulabiliteti që shpesh rezulton në tromboemboli venoze. (54)

Efekti trombozues i estrogjenit oral është i lidhur fort me dozën. Një dozë orale e 1 mg/ditë e estrogjenit kishte efekt të vogël trombotik, ndërsa doza orale prej 3 mg/ditë dhe 5 mg/ditë u shoqëruan me norma të larta trombi arterial dhe tromboemboli venoze. (55)

Sëmundjet malinje

Metoda më e përdorur për të parashikuar probabilitetin klinik, rezultati i Wells, është një rregull parashikimi klinik, përdorimi i të cilit është i ndërlikuar nga versionet e shumta që janë në dispozicion. Në 1995, Philip Steven Wells, fillimisht zhvilloi një rregull parashikimi (bazuar në kërkim të literaturës) për të parashikuar mundësinë e EP, bazuar në kriteret klinike. Rregulli i parashikimit u rishikua në 1998.(205) Ky rregull i parashikimit u rishikua më tej kur u thjeshtua gjatë një vlefshmërie nga Wells et al. në vitin 2000. (206) Në botimin e vitit 2000, Wells propozoi dy sisteme të ndryshme të pikëzimit duke përdorur cutoffs 2 ose 4 me të njëjtin rregull parashikimi. (206) U propozua një version shtesë, "versioni i modifikuar i zgjeruar", duke përdorur cutoffs më të fundit me 2, por përfshirë gjetjet nga studimet fillestare të Wells-it.(205, 206)

Vlerësimi i probabilitetit klinik të EP sipas kriterëve të pikezimit Wells (106)

Variabli	Pikë
Simptoma klinike dhe shenja të TVTH (tumefaksion i ekstremiteteve dhe dhimbje në palpacion)	3
Asnjë diagnozë alternative nuk është më e mundur se EP	3
Frekuenca kardiake > 100 herë/min	1.5
Imobilizim ose kirurgji gjatë 4 javëve të mëparëshme	1.5
TVTH/EP të mëparëshme	1.5
Hemoptizi	1
Malinjitet (mjekuar brenda 6 muajsh ose paliative)	1
Pikët totale	

Piket totale <2 tregojnë për probabilitet të ulët të EP; 2–6 për probabilitet të moderuar të EP; >6 për probabilitet të lartë të EP.

Sipas Wicki et al. (107) vlerësimi i pikëzimit "Gjeneva" bënte mundur identifikimin e pacientëve me risk të ulët, që mund të kualifikoheshin për trajtim ambulator të EP.

Kriteret sipas Geneva score (106):

Kriteri	Pikët
Mosha	
60–79vjec	+1
≥80 vjec	+2
DVT ose PE të mëparshme	+2
Kirurgji recente (<4jave)	+3
Fr kardiake>100	+1
PaCO ₂	
<35mmHg	+2
35–39mmHg	+1
PaO ₂	
<49mmHg	+4
49–59mmHg	+3
60–71mmHg	+2
72–82mmHg	+1
Rtg	
Atelektaze diskoide	+1
Ngjitje e hemidiafragmës	+1

Pikët totale: <5 probabilitet i ulët; 5–8 probabilitet mesatar; >8 probabilitet i lartë

Për të vlerësuar rrezikun e lartë dhe rrezikun e ulët në pacientët me EP janë zhvilluar Indeksi i gravitetit të embolisë pulmonare (PESI) score (108, 109) dhe Indeksi i thjeshtësuar i gravitetit të embolisë pulmonare (sPESI) score (110).

Indeksi i pikëzimit i gravitetit i embolisë pulmonare (PESI) (108):

Variabli	Piket
Mosha	1 pikë / vit
Mashkull	10
Anamnezë e kancerit	30
Anamnezë insuf. kardiake	10
SPOK	10
Pulsi > 110 / min	20
TA sistolik <100 mm Hg	30
Frekuenca respiratore ≥30 / min	20
Temperatura <36 °C	20
Dezorientimi, letargjia, stupor apo koma	60
SaO ₂ <90%	20

Vleresimi i riskut sipas pikëzimit PESI

Risku	Pikezimi
Shumë i ulët (Klasa I)	≤65
I ulët (Klasa II)	66-85
I ndërmjetshëm (Klasa III)	86-105
I lartë (Klasa IV)	106-125

Variabli	Pikëzimi
Mosha mbi 80 vjec	1
Anamnezë për kancer	1
Anamneza për sëmundje kronike kardiopulmonare	1
Pulsi > 100/min	1
Tensioni arterial < 100 mmHg	1
SaO ₂ , 90%	1
Risku	Pikëzimi
Risk i ulët	0
Risk i lartë	≥ 1
Shumë i lartë (Klasa V)	> 125

Indeksi i pikëzimit i thjeshtëzuar i gravitetit i embolisë pulmonare (sPESI) (110)

Rezultati i Indeksit të gravitetit të embolisë pulmonare (PESI) score dhe vlerësimi sipas PESI të thjeshtuar japin rezultatet e ulëta të rrezikut që janë të dobishme për identifikimin e pacientëve, që mund të jenë kandidatë për trajtim në shtëpi. Rezultati i pikëzimit të Gjenevës (107) u hartua posaçërisht për të identifikuar pacientët me risk të ulët. Disa sisteme të tjera të vlerësimit janë zhvilluar për të identifikuar pacientët me EP të cilët janë në rrezik të ulët të një ngjarjeje të pafavorshme dhe për këtë arsye mund të jenë kandidatë të mundshëm për trajtim në shtëpi. (111)

Nëse pacienti konsiderohet me rrezik të ulët (rezultat 0) nga sPESI, pacienti ka një rrezik të përgjithshëm të vdekshmërisë (1.1%) ose morbiditet të rëndë (1.5%). Nëse pacienti konsiderohet me rrezik të lartë (rezultati ≥ 1) nga sPESI, pacienti ka një rrezik të përgjithshëm të lartë të vdekshmërisë (8.9%) ose morbiditet të rëndë (2.7%), menaxhimi duhet te jetë ne spital. Sipas PESI në Klasa e rrezikut I , rreziku i vdekshmërisë 30-ditore varion nga 0 në 1.6%; Klasa e rrezikut II -rreziku i vdekshmërisë 30-ditore varion nga 1.7 në 3.5%;

Klasa e rrezikut III - rreziku i vdekshmërisë 30-ditore varion nga 3.2 në 7.1%; Klasa e rrezikut IV - rreziku i vdekshmërisë 30-ditore varion nga 4 në 10.4%; Klasa e rrezikut V - rreziku i vdekshmërisë 30-ditore varion nga 10.0 në 24.5%. (119) PESI në mënyrë të besueshme identifikon pacientët me EP që janë në rrezik të ulët të vdekjes dhe që janë kandidatë të mundshëm për trajtim ambulator. PESI mund të ndihmojë mjekët të marrin vendime më racionale në lidhje me shtrimin në spital për pacientët me EP.

Graviteti i EP

Graviteti	I	II	III	IV
Klinik	Diskrete Dispne, dhimbje torakale	Fillim akut, dispne, dhimbje torakale, takikardi, ankth, eventualisht: hemoptizi, ethe, likuid pleural	Si II Cianozë Sinkop	Shtohet Shock, Arrest kardio - respirator
TA sistemik	Normal	↔↓	↓	↓↓, amplitudë e vogël
Presioni në arterien (AP)	Normal 12 -16mmHg	↔↓ 16 – 25 mmHg	Presioni mesatar AP 25 – 30 mmHg	Presioni mesatar AP > 30 mmHg
PaO ₂	Normal	< 80 mmHg	< 70 mmHg	< 60 mmHg
Obliterimi vazal	Degët periferike	Arterie segmentare	Nje degë e AP ose disa a.lobare	Nje degë e AP ose disa a.lobare (trunkus i AP)

Ekzaminimi i pacientëve me dyshim për EP mbetet problematik dhe kontroversial – ka disa rrugë për të "përcaktuar" dhe "përrjashtuar" diagnozën (ose më e rëndësishme për të marrë vendimin për antikoagulantë ose jo). Diagnoza e embolisë pulmonare është e vështirë. Gjëja më e rëndësishme është që të përfshihet në diagnozën diferenciale. Sidomos embolitë e vogla nuk evidentohen, por janë shpesh tregues pararendës për emboli të medha, të rënda. Më shumë se gjysma e embolive pulmonare diagnostikohen vetëm pas vdekjes.

Përtej sistemeve të Wells dhe Gjenevës, të cilat klinikistët përdorin për të ndihmuar në gjykimin për trombozë, kriteret e percaktimit të EP (PERC) mund të ndihmojnë për të përjashtuar EP në pacientët e departamentit të urgjencës me rrezik të ulët.(188)

Kriteret e përjashtimit të embolisë pulmonare (PERC) ndihmojnë në vlerësimin e personave në të cilët dyshohet emboli pulmonare, por nuk ka gjasa. Për dallim nga rezultati i Wells dhe rezultati i Gjenevës, të cilat janë rregulla të parashikimit klinik që synojnë stratifikimin e rrezikut të personave me EP të dyshuar, rregulli PERC është krijuar për të përjashtuar rrezikun e EP në njerëz kur mjeku tashmë e ka stratifikuar në kategori me rrezik të ulët.

Individët në këtë kategori të rrezikut të ulët pa asnjë prej këtyre kriterëve të mëposhtme nuk vazhdojnë ekzaminime të mëtejshme për EP: SaO₂ <95%, ënjtje të njëanshme të këmbëve, hemoptizi, TVTH ose EP të mëparshme, ndërhyrje kirurgjikale ose trauma, mosha > 50 vjec, përdorimi i hormoneve, takikardi. Arsyeja e këtij vendimi është se testimi i mëtejshëm (konkretisht angioCT) mund të shkaktojë më shumë dëm (nga ekspozimi i rrezatimit dhe kontrasti) sesa rreziku i EP. (207) Rregulli PERC ka një ndjeshmëri prej 97.4% dhe specifikë prej 21.9% me një normë negative false prej 1.0%. (208) Nëse një pacient plotëson të gjitha kriteret e PERC dhe ka një probabilitet të ulët të kriterëve EP sipas Wells dhe mendimin gestalt të mjekut vlerësues, atëherë një EP mund të përjashtohet. (208) Në realitet, shumë pak pacientë i plotësojnë këto kriteret dhe vlerësimi PERC nuk është i besueshëm për ambientin spitalor.

Mjetet e lartpërmendura: Rezultati i Wells, rezultati i Gjenevës dhe PERC punojnë më së miri për të vlerësuar nevojën për një punë të mëtejshme të pacientëve të qëndrueshëm që paraqiten në urgjencë; me pacientë të sëmurë dhe pacientë me sëmundje kritike, mjete të tilla nuk janë aq të besueshme. Elementet e punës së diagnostikimit do të ndryshojnë në varësi të faktit nëse pacienti është shtruar në spital dhe nëse ka paqëndrueshmëri hemodinamike. Në pacient me EP të dyshuar, diagnoza e TVTH proksimale në një pacient simptomatik, ose në pacient asimptomatik i cili ka kundërindikacione për angio- CT, është i mjaftueshëm për të konkluduar për EP.

1.11 Menaxhimi

Masat terapeutike varen nga obstrukcioni vaskular dhe, para së gjithash, nga ekzistenca pastabilitetit kardio-cirkulator (gjendje shok-u dhe/ose pamjaftueshmëri ventrikulare të djathtë).

Mjekimi i embolisë pulmonare të vërtetuar duhet të përqëndrohet në tre objektiva:

- a) të korrigojë pamjaftueshmërinë cirkulatore të rastit,
- b) të mënjanojë recidivat e parakohshme me afatë gjatë,
- c) të kufizojë mbeturinat vaskulare pulmonare.

Antikoagulimi dhe tromboliza

Antikoagulimi i menjëhershëm i plotë është i detyrueshëm për të gjithë pacientët të dyshuar për TVTH ose emboli pulmonare. Ekzaminimet diagnostike nuk duhet të vonojnë terapinë empirike antikoagulante. Terapia trombolitike duhet të përdoret në pacientët me emboli pulmonare akute të cilët kanë hipotension (presioni i gjakut sistolik <90 mm Hg) të cilët nuk kanë rrezik të lartë të hemoragjisë dhe në pacientë të zgjedhur me emboli pulmonare akute që nuk shoqërohen me hipotension të cilët kanë një rrezik të ulët hemoragjie prezantimi fillestar klinik i të cilëve ose dekursi klinik sugjeron një rrezik të lartë të zhvillimit të hipotensionit. (112) Antikoagulimi afatgjatë është kritik për parandalimin e përsëritjes së TVTH ose embolisë pulmonare, sepse edhe në pacientët të cilët janë plotësisht antikoagulluar, TVTH dhe embolizimi pulmonar mundet dhe shpesh tëpërsëritet.

Barnat antikoaguluese përfshijnë si në vijim:

- Heparinëtë pafraksionuar
- Heparinë me peshë molekulare të ulët
- Frenuesit e Faktorit Xa
- Fondaparinux
- Warfarin

Agjentët trombolitikë të përdorur në menaxhimin e embolisë pulmonare përfshijnë si në vijim:

- Alteplazë
- Reteplase

Opsionet e menaxhimit kirurgjikal përfshijnë si në vijim:

- Embolektomi dhe fragmentimi nepermjet te kateterit ose embolektomi kirurgjikale
- Vendosja e filtrave vena cava

Tromboliza

Të gjithë pacientët me EP kërkojnë stratifikim të shpejtë të rrezikut. Terapia trombolitike duhet të përdoret në pacientët me EP akute, që shoqërohen me hipotension (TA sistolike < 90 mm Hg) të cilët nuk kanë rrezik të lartë të hemoragjisë. (112) Në këtë grup nuk duhet te vonohet tromboliza sepse mund të zhvillohet shoku i pakthyesëm kardiogjen. Terapia trombolitike sugjerohet tek pacientët e zgjedhur me EP akute me një rrezik të ulët të hemoragjisë, në të cilët prezantimi fillestar klinik ose dekursi klinik pas fillimit të antikoagulimit sugjeron një rrezik të lartë të zhvillimit të hipotensionit. Vlerësimi i gravitetit të embolisë pulmonare, prognozës dhe rrezikut të hemoragjise përcaktojnë nëse duhet të fillojë terapia trombolitike. Terapia trombolitike nuk rekomandohet për shumicën e pacientëve me EP akute që nuk shoqërohen me hipotension. (112)

Megjithëse shumica e studimeve demonstrojnë superioritetin e terapisë trombolitike në lidhje me zgjidhjen e anomalive radiografike dhe hemodinamike brenda 24 orëve të para, ky avantazh vihet re 7 ditë pas trajtimit. Provat klinike të kontrolluara nuk kanë demonstruar përfitime në lidhje me uljen e vdekshmërisë ose zgjidhjen e menjëherëshme të simptomave, kur aktualisht krahasohet me heparinën. Një rishikim i madh retrospektiv sugjeron që përdorimi i terapisë trombolitike në pacientët e paqëndrueshëm me EP mund të çojë në vdekshmëri të reduktuar kur krahasohet vetëm me terapinë antikoaguluese. Përdorimi i njëkohshëm i terapisë trombolitike dhe filtrave vena cava në pacientë të tillë mund të reduktojë edhe më tej vdekshmërinë. (113, 114)

Në një meta-analizë të 16 studimeve të randomizuara që krahasojnë terapi trombolitike me terapinë antikoaguluese në pacientët me emboli pulmonare, duke përfshirë pacientët hemodinamikisht të qëndrueshëm me disfunktion ventrikular të djathtë, Chatterjee et al zbuluan se terapia trombolitike, në krahasim me terapinë antikoagulante standarte, reduktoi vdekshmërinë me 47%, por u shoqërua me një rritje prej 2.7 herë të hemoragjive të mëdha. (115)

Megjithatë, studiuesit gjetën gjithashtu se frekuenca e hemoragjisë së madhe nuk u rrit ndjeshëm me trombolizë tek pacientët më të rinj se 65 vjeç, ndërsa trefishuar më shumë në nëngrupin e pacientëve më të vjetër se 65 vjeç. (115) Terapia trombolitike ishte shoqëruar me një rrezik më të madh të hemorragjisë intrakraniale dhe një rrezik më të ulët të embolisë pulmonare rekurente.

(115) Derisa studimet klinike të rastësishme të demonstrojnë një përfitim të qartë morbiditeti ose vdekshmërie, roli i terapisë trombolitike në menaxhimin e embolisë pulmonare akute do të mbetet i diskutueshëm (sidomos në menaxhimin e pacientëve me rrezik të ndërmjetëm). (116, 117, 118) Indikacionet e pranuar aktualisht për terapi trombolitike përfshijnë paqëndrueshmërinë hemodinamike (BP sistolike <90 mm Hg) ose një vlerësim të faktorit të rrezikut klinik që sugjeron që hipotensioni ka gjasa të zhvillohet.

Antikoagulimi

Terapia me heparinë të pafraksionuar

Në pacientët me EP akute, antikoagulimi me UFH IV, LMWH, ose fondaparinux është i preferuar nga mos përdorimi i antikoagulimit. (112) Shumica e pacientëve me EP akute duhet të marrin LMWH ose fondaparinux në vend të UFH IV. Në pacientët me EP, nëse paraqiten shqetësime lidhur me absorbimin subkutan, ekziston insuficiencë e rëndë renale, ose nëse është duke u konsideruar terapi trombolitike, UFH IV është forma e rekomanduar e antikoagulimit fillestar. (112) Klinikistët shpesh zgjedhin të përdorin UFH IV në preferencë ndaj LMWH dhe fondaparinux në rrethana klinike specifike ku ka gjasa të kryhen procedurat mjekësore ose kirurgjikale dhe gjysëmjeta e shkurtër e UFH IV lejon ndërprerjen e përkohshme të antikoagulimit dhe uljen e supozuar të rrezikut të hemoragjisë gjatë procedurës. Megjithëse kjo strategji ka provat mbështetëse të kufizuara, duket se përfaqëson një praktikë të arsyeshme. Efikasiteti i terapisë me heparinë varet nga arritja e një niveli terapeutik kritik të heparinës brenda 24 orëve të para të trajtimit. Niveli kritik terapeutik i heparinës është 1.5 herë vlera e kontrollit bazë ose kufiri i sipërm i intervalit normal të kohës së trombolastinës aktivizuar (aPTT).

Nëse zgjidhet UFH IV, duhet të aplikohet një bolus fillestar prej 80 UI/kg ose 5000 UI, i ndjekur nga një infuzion prej 18 UI/kg/h ose 1300 UI/h, me qëllim të arritjes së shpejtë dhe ruajtjes të aPTT në nivele që korrespondojnë me nivelet terapeutike të heparinës. Doza fikse dhe regjimet e monitoruara të UFH subkutane janë në dispozicion dhe janë alternativa të pranueshme.

Terapi me heparinë me peshë molekulare të ulët

Udhëzimet aktuale për pacientët me EP akute rekomandojnë LMWH mbi UFH IV dhe mbi UFH SC. (112) Në pacientët që trajtohen me LMWH, janë të preferuara regjimet një herë në ditë ndaj atyre dy herë në ditë. Zgjedhja midis fondaparinux dhe LMWH duhet të bazohet në konsideratat lokale duke përfshirë koston, disponueshmërinë dhe njohjen e përdorimit.

LMWH-të kanë shumë përparësi ndaj UFH. Këta agjentë kanë një bioavailabilitet më të madh, mund të administrohen me injeksione subkutane dhe kanë kohëzgjatje më të gjatë të efektit antikoagulues. Mund të përdoret një dozë fikse e LMWH dhe monitorimi laboratorik i aPTT nuk është i nevojshëm.

Studimet që krahasojnë LMWH me UFH kanë treguar se LMWH është të paktën po aq efektive dhe e sigurt si UFH. Studimet nuk kanë treguar ndonjë dallim të rëndësishëm në ngjarjet e përsëritura tromboembolike, hemoragji të mëdha, ose vdekshmëri midis dy llojeve të heparinës.

LMWH mund të administrohet në mënyrë të sigurtë në mjedis ambulator. Kjo ka çuar në zhvillimin e programeve në të cilat pacientët klinikisht të qëndrueshëm me EP trajtohen në shtëpi, me kursime të konsiderueshme të koston. Udhëzimet e ACCP sugjerojnë që pacientët me EP me rrezik të ulët dhe që kanë kushte të pranueshme në shtëpi të dalin herët nga spitali (dmth. ne pesë ditët e para të trajtimit). (112) Një studim ndërkombëtar që krahason trajtimin ambulator me të hospitalizuar (të dy duke përdorur enoxaparin LMWH si terapi fillestare) në pacientëve me rrezik të ulët me EP akute dhe arriti në përfundimin se trajtimi ambulator ishte jo-inferior ndaj trajtimit hospitalor. (119)

Frenuesit direkt të trombinës dhe inhibitorët e faktorit Xa

Apixaban, dabigatran, rivaroxaban dhe edoxaban janë alternativa ndaj warfarin për profilaksinë dhe trajtimin e EP. Apixaban, edoxaban dhe rivaroxaban inhibojnë faktorin Xa, ndërsa dabigatran është një inhibitor direkt i trombinës.

Fondaparinux

Në pacientët me EP akute, Fondaparinux si trajtim fillestar është i favorizuar mbi UFH IV dhe mbi UFH SC. (112) Zgjedhja midis Fondaparinux dhe LMWH duhet të bazohet në konsideratat

lokale për të përfshirë koston, disponueshmërinë dhe njohjen e përdorimit. Fondaparinux katalizon inaktivizimin e faktorit Xa nga antitrombina pa frenuar trombinën.

Sipas një studimi të randomizuar të 2213 pacientëve me embolizëm pulmonar simptomatik (99 120), Fondaparinux e aplikuar një herë në ditë rezultoi që të ketë frekuencë të ngjashme si në aplikimin e UFH IV në lidhje me përsëritjen e EP, hemoragjisë dhe vdekjes.

Në përgjithësi, përdorimi i LMWH ose Fondaparinux është më i rekomanduar se UFH IV dhe UFH SC. Kjo është për shkak të një bioavailabiliteti më të parashikueshëm, fillimin më të shpejtë të efektit të plotë antikoagulant dhe përfitimin se zakonisht nuk ka nevojë për të monitoruar efektin antikoagulant. Megjithatë, nëse lind paqartësi lidhur me saktësinë e dozimit, mund të monitorohen nivelet e faktorit Xa për të përcaktuar efikasitetin.

Terapia me Warfarin

Një antagonist i vitaminës K, i tillë si warfarina, duhet të fillojë në të njëjtën ditë si terapia antikoagulantë në pacientët me EP akute. (112) Antikoagulimi parenteral dhe warfarina duhet të vazhdojnë së bashku për të paktën pesë ditë dhe derisa INR të jetë 2.0.

Efekti antikoagulues i warfarinës është ndërmjetësuar nga inhibimi i faktorëve të varur nga vitamina K, të cilat janë II, VII, IX dhe X. Efekti i pikut nuk ndodh deri në 36-72 orë pas administrimit të medikamentit dhe dozimi është i vështirë për t'u titruar.

Për të vlerësuar përshtatshmërinë e terapisë me warfarin monitorohet raporti i kohës së protrombinës i shprehur si INR. Niveli i rekomanduar terapeutik për tromboembolinë venoze është INR prej 2-3. Ky nivel i antikoagulimit zvogëlon dukshëm rrezikun e hemoragjisë pa humbjen e efektivitetit. Fillimisht matjet e INR kryhen në bazë ditore; sapo pacienti të jetë stabilizuar në një dozë specifike të warfarinës, përcaktimet e INR mund të kryhen çdo 1-2 javë ose në intervale të gjata.

Kohëzgjatja e terapisë antikoaguluese

Pacienti me ngjarje të parë tromboembolike që ndodh për shkak tëfaktorëve të rrezikut reversibël, si imobilizimi, kirurgjia ose trauma, duhet të marrë terapi me warfarin për të paktën 3 muaj. Nuk është vërejtur asnjë ndryshim në frekuencën e përsëritjes në asnjë prej 2 studimeve që krahasojnë 3 kundrejt 6 muajve të terapisë antikoagulante në pacientët me ngjarje të parë idiopatike (ose të pa provokuara). (121, 122) Rekomandimi aktual është antikoagulimi për të

paktën 3 muaj në këto pacientë; nevoja për zgjatjen e kohës së antikoagulimit duhet të rivlerësohet pas kësaj kohe.

Udhëzimet aktuale të ACCP rekomandojnë që të gjithë pacientët me EP të paprovokuar të marrin tre muaj trajtim me antikoagulim dhe të kenë një vlerësim të raportit të risk-përfitim së zgjatjes të terapisë në fund të tre muajve. (112) Pacientët me një episod të parë të tromboembolisë venoze dhe me një rrezik të ulët ose të moderuar të hemoragjisë duhet të zgjasin terapinë antikoagulante. Pacientët me një episod të parë të tromboembolisë venoze që kanë rrezik të lartë të hemoragjisë duhet të kenë terapi të kufizuar deri në tre muaj.

Në pacientët me një episod të dytë të pa provokuar të tromboembolisë venoze dhe rrezikun e ulët ose të moderuar të hemoragjisë, rekomandohet terapi e zgjatur antikoagulante. Pacientët që kanë EP dhe faktorë të rrezikut të pre-ekzistente irreversibël, si mungesa e antitrombinës III, proteina S dhe C, mutacioni i faktorit V Leiden ose prania e antittrupave antifosfolipid duhet të vendosen në antikoagulimin afatgjatë.

Mjekimi ndihmes

Masa ndihmese të rëndësishme janë heqja e dhimbjes (veçanërisht me medikamente antiinflamatore jo steroid), O₂, mbështetje psikologjike. Dobutamina – agonist β adrenergjik me efekte inotrope pozitive dhe vazodilatator pulmonar – mund të përdoret në trajtimin e insuficiencës kardiake dhe shokut kardiogjenik. Ngarkesa me likuide duhet të jetë kujdes për arsye të dilatimit ventrikular të djathtë që mund të çojë në reduktimin e mëtejshëm të hedhjes së zemrës së majtë.

1.12 Frekuenca dhe sequenca e organizimit të tromboembolisë

Një thrombus përmban zona të gjëra të masave të trombociteve të aglutinuara. Së pari depozitohen trombocitet, pasuar nga leukocitet, të ndjekur pas një periudhe të ndryshueshme kohore nga fibrina me eritrocitet e bllokuara dhe disa leukocite të shpërndara. Shkalla e organizimit të tromboembolisë është vlerësuar në lepujt. Janë paraqitur rezultatet e mëposhtme (123, 124):

- 8 minuta. Trombi mbulohet nga një bordurë eozinofilike e trombocite. Sasi të vogla të

fibrinës u ndërvendosen midis trombociteve në buzë të trombit.

- 3 ditë. Trombi përmbante masa të qelizave të kuqe, fibrinë, trombocitet dhe qelizat e bardha së bashku me një numër makrofagësh. Pjesët e sipërfaqes që nuk janë në kontakt me muret e vazos ishin të mbuluara nga qelizat të sheshta dhe në vende të mbështetjes nga një shtresë e qelizave të zgjatura. Trombocitet ishin veçanërisht të përhapura pranë lidhjes të trombusit me paretin vazal. Proeminente ishin qelizat mononukleare.
- 5 dhe 7 ditë. Fillimet e vaskularizimit ishin të dukshme. Kapilarët vërehen brenda masës së trombove dhe në zonat celulare të lidhjes me intimën. Zona qëndrore e trombusit paraqet kryesisht detrite.
- 7 ditë. Trombet okluzive në disa zona retraktohen dhe mbulohen nga qelizat e rrafshta, dhe paraqesin një ose më shumë ankorime celulare të forta në intimën. Makrofagët janë evidente dhe përmbanin lipide, fibrinë dhe mbeturina celulare së bashku me qelizat fibroblastike.
- 14 ditë. Trombi përbëhej nga masa qelizore që përmbajnë grumbuj të vegjël fibrine dhe sasi të ndryshueshme të indeve yndyrore dhe fibroze.
- 20 ditë. Disa trombe u shfaqën si masa polipoide, që dilnin në lumen dhe përmbajnë sasi variabël lipidesh, ind fibroz dhe elastik dhe ndonjëherë kalcium, ndërsa të tjerë shfaqnin lipide brenda qelizave shkuamoze dhe mbulesë indi fibrotik, që përmban fibroblaste, kolagjen dhe inde elastike.
- 30 ditë. Trombemboli u shndërrua në trashje ekscentrike fibroyndyrore të intimës. (123, 124)

2. MATERIALI DHE METODIKA

2.1 Qëllimi i studimit

Korelacione klinike, imazherike dhe laboratorike të tromboembolisë pulmonare, me qëllim të përfutimit të informacionit të besueshëm nëbazë të dhënave dhe përmirësimin e metodologjive dhe standartizimi me metodat bashkëkohore diagnostike.

2.2 Objektivat specifike

- Identifikimi i karakteristikave demografike të sëmurëve me TEP.

- Identifikimi i gjendjeve të tilla, të fituara apo kongjenitale, që predispozojnë zhvillimin e TEP.
- Analizimi i karakteristikave klinike të sëmurëve me TEP.
- Vlerësimi i rezultatet të pretesteve të probabilitetit klinik për TEP.
- Vlerësimi i rezultateve të ekzaminimeve instrumentale.
- Vlerësimi i rezultateve të ekzaminimeve laboratorike.
- Skemat e antikoagulantëve të përdorura në mjekimin e TEP.
- Vdekshmeria spitalore e pacientëve me TEP.

2.3 Materiali dhe metodika

Tipi i studimit

Ky është një studim retrospektiv në të sëmurët me TEP të shtruar gjatë vitit 2017 në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

Grupi studimor

Janë studiuar 121 pacientë me TEP të hospitalizuar gjatë vitit 2017 në repartet e sëmundjeve pulmonare. Mosha mesatare ka qënë 65 ± 13 vjeç (diapazoni 25-88vjeç), 61 (50.4%) pacientë femra, me komorbiditetet - 106 (87.6%). Janë hospitalizuar si urgjencë 117 (96.7%) pacientë. Nga terësia e pacientëve 110 (90.9%) janë shtruar për herë të parë dhe 11 (9.1%) me shtrim të përsëritur si pasojë e rekurencës së TEP. Gjithashtu janë analizuar 18 pacientë që kanë pësuar exitus laetalis. Diagnoza është përcaktuar duke përdorur metodat standarte të diagnostikimit të kësaj patologjie: të dhënat anamnestike –klinike, imazherike (veçanërisht angioCT) dhe laboratorike (veçanërisht D-Dimer). Janë vlerësuar të dhënat e ekzaminimit EKG dhe Echokardiografike, si në drejtim të të dhënave diagnostike ashtu dhe për ndikimin e sëmundjes së TEP në zemër.

EchoDoppler është vlerësuar për ndihmën në përcaktimin e diagnozës, si dhe në përcaktimin e zanafillës së sëmundjes. Gjithashtu është vlerësuar lloji i trajtimit me antikoagulante.

Të dhënat janë përfutuar në bazë të " Skedë për të sëmurë me sëmundjen TEP" (aneks 8)

Karakteristika të pacientëve në studim	Pacientë	Minimum	Maksimum	Mesatare	Std. Deviation
Mosha (vjeç)	121	25.00	88.00	65.23	12.59

Cigare/ditë	35	2.00	60.00	23.77	12.64
Vite pirje duhani	35	2.00	50.00	23.77	12.65
Paketa/vjet	35	.30	120.00	32.19	28.60
Vite ndërprerje duhani	14	1.00	28.00	12.28	9.40
Frekuenca respiratore	121	17.00	28.00	20.76	2.45
Frekuenca kardiake	121	55.00	145.00	91.93	16.01
pO2 mm Hg	121	33.50	107.00	67.83	13.48
BE	121	-13.50	8.20	-2.29	3.24
AaDO2	121	0.00	73.40	39.54	13.93
D dimer	121	229.00	27375.00	4683.55	3903.57

Përpunimi statistikor

Të gjitha të dhënat e mbledhura u hodhën në programin Microsoft-Excel, nga ku u eksportuan në SPSS (Statistical Package for Social Sciences) 20.0 dhe Medstat, me të cilët janë kryer analizat statistikore të të dhënave. Për të gjithë variablat (ndryshorët) kategorikë (nominale, përfshi shkallën binare/dikotomike dhe ordinale), u llogaritën numrat absolute dhe përqindjet përkatëse. Për të gjithë variablat numerike, ku të dhënat i nënshtroheshin shpërndarjes normale, u llogaritën mesataret aritmetike \pm deviacionet standarde përkatëse. Për të dhënat joparametrike (ordinale) u llogaritën koeficientët e korrelacionit Kendall tau.

Diferencat mes grupëve të variablave diskrete, u kryen me anë të testit Hi-katror. Paraqitja e të dhënave u krye me anë të tabelave të thjeshta dhe të përbëra, si dhe nëpërmjet grafikëve. U konsideruan sinjifikante Vlerat e $p \leq 0.05$.

Studimi ka disa kufizime. Rezultatet tona u bazuan tërësisht në të dhënat e shtrimeve në spital dhe pavion tëpneumologjisë, sesa në popullatën e përgjithshme, kështu që tendencat nacionale epidemiologjike për EP nuk mund të vlerësoheshin më saktë. Të dhënat tona nuk përmbajnë pacientët që kanë vdekur jashtë spitalit, në shtëpi ose në një institucione të tjera. Gjithashtu, të

dhënat tona janë nga spital i kujdesit terciar pneumologjik dhe nuk përfshijnë pacientë nga spitalet e kujdesit sekondar, në të cilat incidenca e EP supozohet më e ulët dhe vdekshmëria më e lartë si rezultat i strukturave më të dobëta të diagnostikimit dhe trajtimit për EP, si dhe nga spitale të tjerë nga spitale terciare.

3. REZULTATE

3.1 Pacientë tëhospitalizuar me TEP gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 nga 4181 shtrime në pneumologji, 266 (6.4%) raste kanë qenë me EP prej të cilëve 139(52.3%) meshkuj dhe 127(47.7%) femra. Sipas grupmoshës, vërehet seka rritje të rasteve me rritjen e moshës në të dy gjinitë, deri në moshën 55 vjec ka numër më të madh të pacienteve femra, shpeshësi e njëjtë në grupmoshë 55-64 vjec dhe predominim në meshkuj mbi 64 vjec.

Tabela 3.1.1 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grup moshës

Grupmosha	Meshkuj (%)	Femra (%)	Total (%)
Deri 24 vjeç		4 (1.5)	4(1.5)
25-34	3(1.1)	6(2.3)	9(3.4)
35-44	8(3)	8(3)	16(6)
45-54	10(3.6)	14(5.3)	24(9)
55-64	37(13.9)	36(13.5)	73(27.4)
≥65	81(30.4)	59(22.2)	140(52.6)
Total	139(52.3)	127(47.7)	266(100)




Figura 3.1.1 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grup moshës

Qytetare kanë qenë 171(64.3%), prej të cilëve 91(34.2% e rasteve në total apo 53.2% e

pacientëve meshkuj) meshkuj dhe 80(30.1% e rasteve në total apo 46.8% e pacientëve femra) femra. Fshatare kanë qenë 95(35.7%), prej të cilëve 48(18% e rasteve në total apo 50.5% e pacientëve meshkuj) meshkuj dhe 47(17.7% e rasteve në total apo 49.5% e pacientëve femra) femra.

Tabela 3.1.2 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas banimit

Gjinia	Qytetar	Fshatar	Total
Meshkuj	91(53.2%)	48(50.5%)	139(52.3%)
Femra	80(46.8%)	47(49.5%)	127(47.7%)
Total	171(100%)	95(100%)	266 (100%)




Figura 3.1.2 Rastet me EP të shtruar gjatë vitit 2017 sipas banimit

Tabela 3.1.3Vdekjet nga EP në të shtruar gjatë vitit 2017 sipas grupmoshës dhe gjinisë

Grupmosha	Meshkuj (%)	Femra (%)	Total (%)
45-54		1(5.5)	1(5.5)
55-64	1(5.5)	1(5.5)	2(11.1)
≥65	12(66.7)	3(16.7)	15(83.4)
Total	13(72.2)	5(27.8)	18(100)





Figura 3.1.3 Vdekjet nga EP nëtështuar gjatë vitit 2017 sipas grupmoshës dhe gjinisë

Nga 177 vdekje (4.2% e shtrimeve për sëmundje pulmonare) nga sëmundjet pulmonare 18 (10.2% e totalit të vdekjeve ose 6.7% e pacientëve të shtruar me EP) ishin si pasojë e TEP. Nga 266 pacientë të shtruar me EP kanë pësuar exitus laetalis 18 (6.7%), prej të cilëve pjesa predominuese – 15 (83.4%) në moshën ≥ 65 vjeç dhe kryesisht meshkuj -13 (72.2%).

3.2 Karakteristika të sëmurëve me TEP

Të sëmurët e shtruar me TEP kanë qenë 60 (49.6%) meshkuj dhe 61 (50.4%) femra. Moshë mesatare e të sëmurëve të marrë në studim ka rezultuar 65.23 ± 13 vjeç (25-88 vjeç), meshkuj



64.03 ± 12.5 dhe femra 66.41 ± 12.7 , pa ndryshime sinjifikante (sig 0.3). Në moshën mbi 64 vjeç vihet re numër më i madh i femrave.

Figura 3.2.1 Rastet me TEP sipas seksit dhe prejardhjes

Kanë rezultuar më shumë qytetarë (67.8 %) se sa fshatarë (32.2 %), ku megjithëse pa diferenca sinjifikante ka numër më të madh meshkujsh qytetarë dhe femra fshatare.

Tabela 3.2.1 Rastet me TEP sipas seksit dhe prejardhjes

Seksi	Qytetar/fshatar		Total
	Qytetar	Fshatar	
Meshkuj	43(35.5%)	17(14%)	60(49.6 %)
Femra	39(32.2%)	22(18.2%)	61(50.4%)
Total	82(67.8%)	39(32.2%)	121(100%)

Pearson Chi-Square .828, Asymptotic Significance (2-sided) .363

Pearson's R .083 Approximate Significance .367

Spearman Correlation .083 Approximate Significance .367




Figura 3.2.2 Rastet me TEP sipas seksit dhe prejardhjes

Siç vihet re në tabelën dhe figurën numri i rasteve, si për meshkuj dhe për femrat, është në rritje

me rritjen e grupmoshës: si meshkujt dhe femrat përbëjnë 0.8% të rasteve në grupmoshën 25-34 vjeç, ndërsa në grupmoshën mbi 64 vjeç meshkujt përbëjnë 24% të rasteve dhe femrat 31.5%. Pacientët e shtruar me TEP të moshës mbi 64 vjeç përbëjnë 55.4% të rasteve në tërësi.

Tabela 3.2.2 Rastet me TEP sipas seksit dhe grupmoshës

Seksi	Mosha (vjeç)					Total
	25-34	35-44	45-54	55-64	>64	
Meshkuj	1 (0.8%)	4 (3.3%)	8 (6.6%)	18 (14.9%)	29 (24%)	60 (100 %)
Femra	1 (0.8 %)	5 (4.1%)	4 (3/3%)	13 (10.7%)	38 (31.4%)	61 (100 %)
Total	2 (1.7 %)	9 (7.4%)	12 (9.9%)	31 (25.6%)	67 (55.4%)	121 (100 %)

Pearson Chi-Square 3.452, Asymptotic Significance (2-sided) .485

Pearson's R .087 Approximate Significance .341

Spearman Correlation .124 Approximate Significance .175




Figura 3.2.3 Rastet me TEP sipas seksit dhe grupmoshës

Gjithashtu, si në pacientët me prejardhje urbane apo rurale, rezulton rritje e numrit të rasteve me rritjen e moshës. Në grupmoshën 25-34 vjeç pacientët qytetar përbëjnë 1.7% të rasteve (asnjë fshatar), ndërsa mbi moshën 64 vjeç rezultuan 35.5% qytetar dhe 32.2% fshatar.

Tabela 3.2.3 Rastet me TEP sipas moshës dhe prejardhjes

Mosha (vjeç)	Qytetar/fshatar		Total
	Qytetar	Fshatar	
25-34	2 (1.7 %)	-	2 (1.7 %)

35-44	6(5 %)	3(2.5 %)	9(7.4 %)
-------	--------	----------	----------

45-54	11(9.1 %)	1(0.8 %)	12(9.9 %)
55-64	20(16.5 %)	11(9.1 %)	31(25.6 %)
>64	43(35.5 %)	24(19.8 %)	67(55.4 %)
Total	82(67.8 %)	39(32.2 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 4.639, Asymptotic Significance (2-sided) .326

Pearson's R .122 Approximate Significance .183

Spearman Correlation .113 Approximate Significance .219




Figura 3.2.4 Rastet me TEP sipas moshës dhe prejardhjes

Sipas profesionit 31 (25.6 %) rezultojnë bujq, 82 (67.8%) punëtorë dhe 8(6.6%) nëpunës. Në totalin e rasteve meshkuj 11(18.3%) janë bujq, 43(71.7%) – punëtorë dhe 6(10%) nëpunës, ndërsa në femrat 20(32.8%) – bujqesha, 39(63.9%) – punëtore dhe 2(3.3%) – nëpunëse.

Tabela 3.2.4 Rastet me TEP sipas seksit dhe profesionit

Seksi		Profesioni			Total
		Bujk	Punëtor	Nëpunës	
Meshkuj	Raste	11	43	6	60
	% e totalit	9.1%	35.5%	5.0%	49.6%
Femra	Raste	20	39	2	61
	% e totalit	16.5%	32.2%	1.7%	50.4%
Total	Raste	31	82	8	121
	% e totalit	25.6%	67.8%	6.6%	100.0%

Pearson Chi-Square 4.800, Asymptotic Significance (2-sided) .091

Pearson's R -.198 Approximate Significance .030

Spearman Correlation $-.195$ Approximate Significance $.032$




Figura 3.2.5 Rastet me TEP sipas seksit dhe profesionit

Sipas lidhjes së moshës dhe profesionit, TEP në të gjithë profesionet rritje e rasteve me rritjen e moshës.

Tabela 3.2.5 Rastet me TEP sipas moshës dhe profesionit

Moshë (vjeç)		Profesioni			Total
		Bujk	Punetor	Nëpunës	
25-34	Raste	-	2	-	2
	% e Total	-	1.7%	-	1.7%
35-44	Raste	3	6	-	9
	% e Total	2.5%	5.0%	-	7.4%
45-54	Raste	1	10	1	12
	% e Total	0.8%	8.3%	0.8%	9.9%
55-64	Raste	7	22	2	31
	% e Total	5.8%	18.2%	1.7%	25.6%
>64	Raste	20	42	5	67
	% e Total	16.5%	34.7%	4.1%	55.4%
Total	Raste	31	82	8	121
	% e Total	25.6%	67.8%	6.6%	100.0%

Pearson Chi-Square 4.596, Asymptotic Significance (2-sided) $.800$

Pearson's R $-.047$ Approximate Significance $.607$

Spearman Correlation $-.074$ Approximate Significance $.420$




Figura 3.2.6 Rastet me TEP sipas moshës dhe profesionit

Në rastet në studim rezulton se shumica e pacientëve, 85 (70.2%), kanë qenë jo fumatorë.

Tabela 3.2.6 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit

Seksi	Duhani			Total
	Jo fumator	Fumator	Ex fumator	
Meshkuj	29(24 %)	18(14.9 %)	13(10.7 %)	60(49.6 %)
Femra	56(46.3 %)	4(3.3 %)	1(0.8 %)	61(50.4 %)
Total	85(70.2 %)	22(18.2 %)	14(11.6 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 27.765, Asymptotic Significance (2-sided) $.000$

Pearson's R $-.461$ Approximate Significance $.000$

Spearman Correlation $-.478$ Approximate Significance $.000$




Figura 3.2.7 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit

Sasia e përdorimit të duhanit më shpesh ka qenë 11-20 cigare në ditë, më e theksuar në meshkujt.

Tabela 3.2.7 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit në cigare/ditë

Seksi	Cigare/ditë				Total
	deri 10	11-20	21-40	mbi 40	
Meshkuj	4(11.4 %)	15(42.9 %)	10(28.6 %)	1(2.9%)	30(85.7 %)
Femra	2(5.7 %)	2(5.7 %)	1(2.9 %)	-	5(14.3 %)
Total	6(17.1 %)	17(48.6 %)	11(31.4 %)	1(2.9 %)	35(100 %)

Pearson Chi-Square 2.275, Asymptotic Significance (2-sided) .517

Pearson's R -.218 Approximate Significance .208

Spearman Correlation -.210 Approximate Significance .225




Figura 3.2.8 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit cigare/ditë

Sipas viteve të përdorimit të duhanit rezulton se meshkujt me shpesh renditen në grupin 21- 40 vite, ndërsa femrat gjer maksimum 20 vite.

Tabela 3.2.8 Rastet me TEP sipas seksit dhe vite përdorim të duhanit

Seksi	Vite përdorim duhan				Total
	gjer 10	11-20	21-40	mbi 60	
Meshkuj	6(17.1 %)	7(20 %)	16(45.7 %)	1(2.9 %)	30(85.7 %)
Femra	2(5.7 %)	3(8.6 %)	-	-	5(14.3 %)
Total	8(22.9 %)	10(28.6 %)	16(45.7 %)	1(2.9 %)	35(100 %)

Pearson Chi-Square 5.600, Asymptotic Significance (2-sided) .133

Pearson's R -.330 Approximate Significance .053

Spearman Correlation -.351 Approximate Significance .039




Figura 3.2.9 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitet e përdorimit të duhanit

Sipas përdorimit të duhanit në paketa/vite rezulton se numri më i madh i rasteve në meshkuj grupohet në grupin deri 10 paketa/vite – 8(22.9%) dhe 41-60 paketa/vite – 6(17.1%), ndërsa në femrat sasia e përdorimit të duhanit është më e vogël – deri maksimumi 21-30 paketa/vite.

Tabela 3.2.9 Rastet me TEP sipas seksit dhe përdorimit të duhanit në paketa/vite

Paketa/vite	Seksi		Total
	Meshkuj	Femra	
deri 10	8(22.9 %)	3(8.6 %)	11(31.4 %)
11-20	5(14.3 %)	1(2.9 %)	6(17.1 %)
21-30	4(11.4 %)	1(2.9 %)	5(14.3 %)
31-40	4(11.4 %)	-	4(11.4 %)
41-60	6(17.1 %)	-	6(17.1 %)
61-80	1(2.9 %)	-	1(2.9 %)
81-100	1(2.9 %)	-	1(2.9 %)
mbi 100	1(2.9 %)	-	1(2.9 %)
Total	30(85.7 %)	5(14.3 %)	35(100 %)

Pearson Chi-Square 3.843, Asymptotic Significance (2-sided) .798

Pearson's R -.299 Approximate Significance .081

Spearman Correlation -.310 Approximate Significance .070

Tabela 3.2.10 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitet e ndërprerjes të duhanit

Seksi	Vite ndërprerje duhani			Total
	deri 5	6-15	mbi 15	
Meshkuj	6(42.9 %)	1(7.1 %)	6(42.9 %)	13(92.9 %)
Femra	-	-	1(7.1 %)	1(7.1 %)
Total	6(42.9 %)	1(7.1 %)	7(50 %)	14(100 %)

Pearson Chi-Square 1.077, Asymptotic Significance (2-sided) .584

Pearson's R .268 Approximate Significance .354

Spearman Correlation .269 Approximate Significance .352

Në personat që kanë ndërprerë përdorimin e duhanit meshkujt grupohen deri 5 vjet dhe rezulton vetëm një pacient mbi 15 vjet.




Figura 3.2.10 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitet e ndërprerjes duhanit
 Pacientët sipas moshës në lidhje me përdorimin e duhanit janë të shpërndarë në moshën mbi 35 vjeç, ndërsa ata që kanë ndërprerë duhanin janë kryesisht mbi 55 vjeç.

Tabela 3.2.11 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit

Mosha (vjeç)	Duhani			Total
	Jo fumator	Fumator	Ex fumator	
25-34	1(0.8 %)	1(0.8 %)	-	2(1.7%)
35-44	5(4.1 %)	4(3.3 %)	-	9(7.4 %)
45-54	7(5.8 %)	4(3.3 %)	1(0.8 %)	12(9.9 %)
55-64	17(14 %)	7(5.8 %)	7(5.8 %)	31(25.6 %)
>64	55(45.5 %)	6(5 %)	6(5 %)	67(55.4 %)
Total	85 (70.2 %)	22(18.2 %)	14(11.6 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 17.556, Asymptotic Significance (2-sided) .025

Pearson's R -.139 Approximate Significance .127

Spearman Correlation -.245 Approximate Significance .007




Figura 3.2.11 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit

Në lidhje me përdorimin e duhanit sipas moshës rezultojnë se shpërndarja më e lartë është në grup moshën 55-64 vjeç me 11-40 cigare në ditë.

Tabela 3.2.12 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit cigare/ditë

Moshë (vjeç)	Cigare/ditë				Total
	deri 10	11-20	21-40	mbi 40	
25-34	-	1(2.9 %)	-	-	1(2.9 %)
35-44	2(2.7 %)	2(5.7 %)	-	-	4(11.4 %)
45-54	-	3(8.6 %)	2(5.7 %)	-	5(14.3 %)
55-64	1(2.9 %)	7(20 %)	5(14.3 %)	-	13(37.1 %)
>64	3(8.6 %)	4(11.4 %)	4(11.4 %)	1(2.9 %)	12(34.3 %)
Total	6(17.1 %)	17(48.6 %)	11(31.4 %)	1(2.9 %)	35(100 %)

Pearson Chi-Square 9.809, Asymptotic Significance (2-sided) .633

Pearson's R .203 Approximate Significance .242

Spearman Correlation .151 Approximate Significance .387




Figura 3.2.12 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit cigare/ditë

Lidhja sipas moshës dhe vitet e përdorimit të duhanit rezultojnë të jetë me shpërndarje më të lartë në moshën mbi 55 vjeç dhe me vite përdorimi duhani prej 21-40 vitesh.

Tabela 3.2.13 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të përdorimit të duhanit

Moshë (vjeç)	Vite përdorim duhan				Total
	deri 10	11-20	21-40	mbi 60	
25-34	1(2.9 %)	-	-	-	1(2.9 %)
35-44	1(2.9 %)	3(8.6 %)	-	-	4(11.4 %)
45-54	-	2(5.7 %)	3(8.6 %)	-	5(14.3 %)
55-64	4(11.4 %)	2(5.7 %)	7(20 %)	-	13(37.1 %)
>64	2(5.7 %)	3(8.6 %)	6(17.1 %)	1(2.9 %)	12(34.3 %)
Total	8(22.9 %)	10(28.6 %)	16(45.7 %)	1(2.9 %)	35(100 %)

Pearson Chi-Square 13.350, Asymptotic Significance (2-sided) .344

Pearson's R .283 Approximate Significance .100

Spearman Correlation .245 Approximate Significance .156




Figura 3.2.13 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të përdorimit të duhanit

Dhe shpërndarja e duhanpirësve sipas paketa/vite është më e shprehur me rritjen e moshës.

Tabela 3.2.14 Rastet me TEP sipas moshës dhe përdorimit të duhanit paketa/vite

Paketa/vite	Mosha (vjeç)					Total
	25-34	35-44	45-54	55-64	>64	
deri 10	1(2.9 %)	2(5.7 %)	-	4(11.4 %)	4(11.4 %)	11(31.4 %)
11-20	-	2(5.7 %)	1(2.9 %)	1(2.9 %)	2(5.7 %)	6(17.1 %)
21-30	-	-	2(5.7 %)	3(8.6 %)	-	5(14.3 %)
31-40	-	-	1(2.9 %)	2(5.7 %)	1(2.9 %)	4(11.4 %)
41-60	-	-	1(2.9 %)	2(5.7 %)	3(8.6 %)	6(17.1 %)
61-80	-	-	-	1(2.9 %)	-	1(2.9 %)
81-100	-	-	-	-	1(2.9 %)	1(2.9 %)
mbi 100	-	-	-	-	1(2.9 %)	1(2.9 %)
Total	1(2.9 %)	4(11.4 %)	5(14.3 %)	13(37.1 %)	12(34.3 %)	35(100 %)

Pearson Chi-Square 20.395, Asymptotic Significance (2-sided) .850

Pearson's R .302 Approximate Significance .078

Spearman Correlation .205 Approximate Significance .237

Tabela 3.2.15 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të ndërprerjes të duhanit

Mosha (vjeç)	Vite ndërprerje duhanit			Total
	deri 5	6-15	mbi 15	
45-54	1(7.1 %)	-	-	1(7.1 %)
55-64	3(21.4 %)	-	4(28.6 %)	7(50 %)
>64	2(14.3 %)	1(7.1 %)	3(21.4 %)	6(42.9 %)
Total	6(42.9 %)	1(7.1 %)	7(50 %)	14(100 %)

Pearson Chi-Square 2.794, Asymptotic Significance (2-sided) .593

Pearson's R .200 Approximate Significance .493

Spearman Correlation .159 Approximate Significance .586

Rastet më të shumta të ndërprerjes së duhanit janë grupmoshën 55-64 vjeç.




Figura 3.2.14 Rastet me TEP sipas moshës dhe viteve të ndërprerjes të duhanit

Shtrimi ka qenë si urgjencë në pothuaj të gjithë rastet (96.7%).

Tabela 3.2.16 Rastet me TEP sipas seksit dhe mënyrës së shtrimit

Seksi	Lloji i shtrimit		Total
	Urgjent	Zakonshtëm	
Meshkuj	59(48.8%)	1(0.8 %)	60(49.6 %)
Femra	58(47.9%)	3(2.5 %)	61(51.4 %)
Total	117(96.7%)	4(3.3 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 1.000, Asymptotic Significance (2-sided) .317

Pearson's R .091 Approximate Significance .321

Spearman Correlation .091 Approximate Significance .321




Figura 3.2.15 Rastet me TEP sipas seksit dhe mënyrës së shtrimit

Të sëmurët me TEP të shtruar për herë të parë kanë rezultuar 110 (90.9%) raste dhe shtrim i përsëritur në 11 (9.1%) raste.

Tabela 3.2.17 Rastet me TEP sipas seksit dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Seksi	Shtrimi		Total
	Për herë të parë	Përsëritur	
Meshkuj	55(45.5 %)	5(4.1 %)	60(49.6 %)
Femra	55(45.5 %)	6(5 %)	61(50.4 %)
Total	110(90.9 %)	11(9.1 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square .083, Asymptotic Significance (2-sided) .774

Pearson's R .026 Approximate Significance .776

Spearman Correlation .026 Approximate Significance .776




Figura 3.2.16 Rastet me TEP sipas seksit dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Në 11 rastet e përsëritura të TEP nuk rezulton përparësi kohore e ndodhisë së parë.

Tabela 3.2.18 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitit të shtrimit të parë

Seksi	Sëmurë për herë të parë							Total
	2004	2011	2012	2014	2015	2016	2017	
Meshkuj	-	1(0.8%)	1(0.8%)	1(0.8%)	-	2(1.7%)	55(45.5 %)	60(49.6 %)
Femra	1(0.8%)	-	1(0.8%)	-	2(1.7%)	2(1.7 %)	55(45.5 %)	61(50.4 %)
Total	1(0.8%)	1(0.8%)	2(1.7%)	1(0.8%)	2(1.7 %)	4(3.3%)	110(90.9 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 4.992, Asymptotic Significance (2-sided) .545

Pearson's R -.043 Approximate Significance .639

Spearman Correlation -.026 Approximate Significance .780




Figura 3.2.17 Rastet me TEP sipas seksit dhe vitit të shtrimit të parë

Rezulton se rastet e TEP që nuk janë shtruar si urgjencë kanë qenë të moshës mbi 55 vjeç.

Tabela 3.2.19 Rastet me TEP sipas moshës dhe llojit të shtrimit

Moshë (vjeç)	Lloji i shtrimit		Total
	Urgjent	Zakonshëm	
25-34	2(1.7 %)	-	2(1.7 %)
35-44	9(7.4 %)	-	9(7.4 %)
45-54	12(9.9 %)	-	12(9.9 %)
55-64	29(24 %)	2(1.7 %)	31(25.6 %)
>64	65(53.7 %)	2(1.7 %)	67(55.4 %)
Total	117(96.7 %)	4(3.3 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 1.768, Asymptotic Significance (2-sided) .778

Pearson's R .044 Approximate Significance .629

Spearman Correlation .015 Approximate Significance .873




Figura 3.2.18 Rastet me TEP sipas moshës dhe llojit të shtrimit

Pacientët me TEP, si të shtrimit të parë dhe të përsëritur, janë në numër në rritje me rritjen e moshës.

Tabela 3.2.20 Rastet me TEP sipas moshës dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Mosha (vjeç)	Shtrimi		Total
	Për herë të parë	Përsëritur	
25-34	1(0.8 %)	1(0.8 %)	2(1.7 %)
35-44	9(7.4 %)	-	9(7.4 %)
45-54	11(9.1 %)	1(0.8 %)	12(9.9 %)
55-64	29(24 %)	2(1.7 %)	31(25.6 %)
>64	60(49.6 %)	7(5.8 %)	67(55.4 %)
Total	110(90.9 %)	11(9.1 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 5.369, Asymptotic Significance (2-sided) .251

Pearson's R .005 Approximate Significance .955

Spearman Correlation .038 Approximate Significance .676




Figura 3.2.19 Rastet me TEP sipas moshës dhe shtrimit të parë apo përsëritur

Tabela 3.2.21 Rastet me TEP sipas moshës dhe vitit të shtrimit të parë

Sëmurë për herë të parë	Moshë (vjeç)					Total
	25-34	35-44	45-54	55-64	>64	
2004	-	-	-	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
2011	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
2012	-	-	-	-	2(1.7%)	2(1.7%)
2014	-	-	1(0.8 %)	-	-	1(0.8%)
2015	-	-	-	-	2(1.7%)	2(1.7 %)
2016	1(0.8 %)	-	-	1(0.8)	2(1.7 %)	4(3.3 %)
2017	1(0.8 %)	9(7.4 %)	11(9.1 %)	29(24%)	60(49.6 %)	110(90.9%)
Total	2(1.7 %)	9(7.4 %)	12(9.9 %)	31(25.6 %)	67(55.4 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 30.411, Asymptotic Significance (2-sided) .171

Pearson's R -.032 Approximate Significance .730

Spearman Correlation -.041 Approximate Significance .658

3.3 Faktorë të fituara apo kongjenitalë, që predispojnë zhvillimin e TEP.

Pa faktor risku të fituar rezultojnë 11(9.1 %) pacientë, 6(5 %) meshkuj dhe 5(4.1 %) femra.

Faktorët e fituar të riskut që kanë ndikuar si të vetëm apo kombinimi i tyre në pacientët me TEP paraqiten në Tabelën , ndërsa shpeshësia e faktorëve të riskut në tërësi paraqitet në Tabelën dhe Figurën . Si faktorë risku të fituar të veçantë rezultojnë me shpesh inflamacioni kronik - 25(20.6%), obeziteti - 24(19.8%), fibrilacioni atrial – 19 (15.7 %), trauma me dëmtim indor - 18(14.9%), imobilizimi -15(12.4%) dhe malinjiteti - 12(9.9 %).

Tabela 3.3.1 Faktorët e fituar të riskut në pacientët me TEP sipas seksit

Faktor risku i fituar	Seksi		Total
	Meshkuj	Femra	
Pa faktor risku të fituar	6(5 %)	5(4.1 %)	11(9.1 %)
Imobilizim	1(0.8 %)	2(1.7 %)	3(2.5 %)
Imobilizim+Inflamacion kronik	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Imobilizim+dëmtim indor	2(1.7 %)	3(2.5 %)	5(4.1 %)
Udhëtim i gjatë	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Dëmtim indor	7(5.8 %)	4(3.3 %)	11(9.1 %)
Dëmtim indor+Imobilizim	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Dëmtim indor+Iktus	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Malinjitet	7(5.8 %)	5(4.1 %)	12(9.9 %)
Protezë valvulare kardiake	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Protezë valvulare kardiake+Insuf kongjестive kardiake	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Protezë valvulare kardiake+FA	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Lupus antikoagulant+imobilizim	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
FA	3(2.5 %)	6(5 %)	9(7.4 %)
FA+imobilizim	3(2.5 %)	1(0.8 %)	4(3.3 %)
FA+obezitet	1(0.8 %)	1(0.8 %)	2(1.7 %)
FA+Iktus	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
FA+insuf kongjестive kardiake	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Kardiomiopati	-	3(2.5 %)	3(2.5 %)
Kardiomiopati+sindrom nefrotik	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Kardiomiopati+obezitet	2(1.7 %)	1(0.8 %)	3(2.5 %)
Kardiomiopati+Insuf kongjестive kardiake	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Kardiomiopati+FA	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Sindrom nefrotik	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Inflamacion kronik	12(9.9 %)	7(5.8 %)	19(15.7 %)
Inflamacion kronik+obezitet	-	2(1.7 %)	2(1.7 %)
Inflamacion kronik+iktus	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Inflamacion kronik+insuf kongjестive kardiake	1(0.8 %)	1(0.8 %)	2(1.7 %)
Obezitet	4(3.3 %)	12(9.9 %)	16(13.2 %)
Obezitet+insuf kongjестive kardiake	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Iktus	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Kateter central	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Insuf kongjестive kardiake	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Total	60(49.6 %)	61(50.4 %)	121(100 %)

Pearson Chi-Square 33.419, Asymptotic Significance (2-sided) .398

Pearson's R .092 Approximate Significance .317

Spearman Correlation .104 Approximate Significance .256

Tabela 3.3.2 Shpeshësia e faktorëve të fituar të riskut sipas seksit

Faktor risku i fituar	Gjinia		Total
	Meshkuj	Femra	
Pa faktor risku të fituar	6(5 %)	5(4.1 %)	11(9.1 %)
Imobilizim	7(5.8 %)	8(6.6%)	15(12.4%)
Inflamacion kronik	13(10.7%)	12(9.9%)	25(20.6%)
Dëmtim indor	11(9.1 %)	7(5.8 %)	18(14.9%)
Udhëtim i gjatë	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Iktus	2(1.7 %)	2(1.7 %)	4(3.3 %)
Malinjitet	7(5.8 %)	5(4.1 %)	12(9.9 %)
Protezë valvulare kardiake	3(2.5 %)	-	3(2.5 %)
Insuf kongjестive kardiake	5(4.1 %)	2(1.7 %)	7(5.8 %)
FA	9(7.4 %)	10(8.3%)	19(15.7 %)
Lupus antikoagulant	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Obezitet	8(6.6%)	16(13.2)	24(19.8%)
Kardiomiopati	4(3.3 %)	5(4.1 %)	9(7.4 %)
Sindrom nefrotik	-	2(1.7 %)	2(1.7 %)
Kateter central	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)




Figura 3.3.1 Shpeshësia e faktorëve të fituar të riskut në pacientët me TEP

Në lidhje me moshën vihet re se faktorët e riskut të fituar rriten me rritjen e moshës dhe respektivisht 1.7% në grupmoshën 25- 34 vjeç, 5.7 % në grupmoshën 35 - 44 vjeç, 8.2 % në grupmoshën 45 - 54 vjeç, 23.9 % në grupmoshën 55 – 64 vjeç dhe 53.7% në grupmoshën >64 vjeç.

Tabela 3.3.3 Faktorët e fituar të riskut në pacientët me TEP sipas moshës

Faktor risku fituar	Moshë (vjeç)					Total
	25-34	35-44	45-54	55-64	>64	
Pa faktor risku të fituar	-	2(1.7 %)	2(1.7 %)	5(4.1 %)	2(1.7 %)	11(9.1 %)
Imobilizim	-	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)	3(2.5 %)
Imobilizim+Inflamacion kronik	-	-	-	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Imobilizim+dëmtim indor	-	-	2(1.7 %)	1(0.8 %)	2(1.7 %)	5(4.1 %)
Udhëtim i gjatë	-	-	1(0.8 %)	-	-	1(0.8 %)
Dëmtim indor	-	4(3.3 %)	-	4(3.3 %)	3(2.5 %)	11(9.1 %)
Dëmtim indor+Imobilizim	-	-	-	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Dëmtim indor+Iktus	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Malinjtet	-	-	-	5(4.1 %)	7(5.8 %)	12(9.9 %)
Protezë valvulare kardiake	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Protezë valvulare kardiake+Insuf kongjeste kardiake	-	-	-	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)
Protezë valvulare kardiake+FA	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Lupus antikoagulant+imobilizim	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
FA	-	-	1(0.8 %)	2(1.7 %)	6(5 %)	9(7.4 %)
FA+imobilizim	-	-	-	-	4(3.3 %)	4(3.3 %)
FA+obezitet	-	-	-	-	2(1.7 %)	2(1.7 %)
FA+Iktus	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
FA+insuf kongjeste kardiake	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Kardiomiopati	-	-	-	-	3(2.5 %)	3(2.5 %)
Kardiomiopati+sindrom nefrotik	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Kardiomiopati+obezitet	-	-	-	1(0.8 %)	2(1.7 %)	3(2.5 %)
Kardiomiopati+Insuf kongjeste kardiake	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Kardiomiopati+FA	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Sindrom nefrotik	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Inflamacion kronik	2(1.7 %)	1(0.8 %)	2(1.7 %)	4(3.3 %)	10(8.3 %)	19(15.7 %)
Inflamacion kronik+obezitet	-	-	1(0.8 %)	-	1(0.8 %)	2(1.7 %)
Inflamacion kronik+iktus	-	-	-	-	1(0.8 %)	1(0.8 %)
Inflamacion kronik+insuf kongjeste kardiake	-	-	-	-	2(1.7 %)	2(1.7 %)
Ngritje lart e diafragmes	1	2	3(17.6)
Shenja e Palla; Versament pleural; Ngritje lart e diafragmes	0	2	2(11.8)
Shenja e Westermark	1	1	2(11.8)
Shenja e Westermark. Versament pleural	0	1	1(5.9)
Versament pleural	0	3	3(17.6)
Total	3	14	17(110)

Sipas rezultateve te angioCT ne pacientet e vdekur me EP lokalizimi i trombev ka qene ne vaza segmentare ne 5(33.3%) raste, lobare ne 3 (20%) raste dhe primare ne 7(46.7%) raste.

Tabela 3.11.15 Te dhena te angioCT te pacienteve me EP te vdekur ne spital

Te dhëna te angioCT	Femra	Meshkuj	Total (%)
Segmentare	0	3	3(20)
Segmentare bilaterale	0	2	2(13.3)
Lobare	1	2	3(20)
Vaze primare	1	4	5(33.4)
Vaze primare bilaterale	1	1	2(13.3)
Total	3	12	15(100)

Frekuenca respiratorë ne pacientet e vdekur nga EP ka qene e rritur ≥ 20 /min ne 14(77.8%) te rasteve, ndërsa frekuenca kardiake 81-100/min ne 6(33.3%) raste dhe ≥ 101 /min ne 8(44.4%) raste.

Tabela 3.11.16 Frekuenca respiratore ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Frekuenca respiratore	Seksi		Total(%)
	Femra	Meshkuj	
≤ 20 /min	0	4	4(22.2)
≥ 20 /min	3	11	14(77.8)
Total	3	15	18(100)




Figura 3.11.8 Frekuenca respiratore ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.17 Frekuenca kardiake ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Frekuenca kardiake	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
80≤ /min	0	4	4(22.2)
81-100/min	1	5	6(33.3)
≥101 /min	2	6	8(44.4)
Total	3	15	18(100)




Figura 3.11.9 Frekuenca kardiake ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Echodoppler kryer ne 8 paciente, prej te cilëve 2 ka rezultuar me leziona vazale trombotike.

Ne pacientet e vdekur ne spital nga EP azotemia ka rezultuar e rritur ne 10(55.6%) raste, fibrinogjeni ne 9(50%) raste.

Tabela 3.11.18 Rezultate te azotemise ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Azotemia	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
E rritur	3	7	10(55.6)
Normal	0	8	8(44.4)
Total	3	15	18(100)




Figura 3.11.10 Rezultate te azotemise ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.19 Rezultate te fibrinogjenit ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Fibrinogjeni	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
E rritur	2	7	9(50)
Normal	1	8	9(50)
Total	3	15	18(100)




Figura 3.11.11 Rezultate te fibrinogjenit ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Rezultate te pH ne pacientet me EP te vdekur ne spital kane rezultuar te ulura ne 7(41.2%) raste dhe te rritura ne 8(47.1%) raste; pO₂ ka rezultuar ≤ 50 mmHg ne 4(25%) raste, 51-60 mmHg ne 5(31.3%) raste, 61-72 mmHg ne 4(25%) raste dhe ne vlera ≥73 mmHg 3(18.8%) raste; pCO₂ ka rezultuar < 36 mmHg ne 9(52.9%) raste, 36 - 44 mmHg ne 3(17.6%) raste, > 44 mmHg ne 5(29.4%) raste; SaO₂ ka rezultuar <75% ne 1(5.9%) raste, 75-89% ne 9(52.9%) raste, 90-94% ne 4(23.5%) raste, >94% ne 3(17.6%) raste; HCO₃ ka rezultuar < 22 mmol/L ne 11(64.7%) raste, 22–26 mmol/L ne 2(11.8%) raste, > 26 mmol/L ne 4(23.5%) raste; BE ka rezultuar -20.4 gjer -1.9 ne 11(68.8%) raste, -2 gjer +2 ne 3(18.8%) raste, 2.1 gjer 8.2 ne 2(12.5%) raste.

Tabela 3.11.20 Rezultate te pH ne pacientet me EP te vdekur ne spital

pH	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
< 7.38	1	6	7(41.2)
7.38 - 7.4	0	2	2(11.8)
> 7.4	2	6	8(47.1)
Total	3	14	17(100)




Figura 3.11.12 Rezultate te pH ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.21 Rezultate te pO2 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

pO2 (mmHg)	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
≤ 50	1	3	4(25)
51-60	2	3	5(31.3)
61-72	0	4	4(25)
≥73	0	3	3(18.8)
Total	3	13	16(100)




Figura 3.11.13 Rezultate te pO2 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.22 Rezultate te pCO2 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

pCO2	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
< 36 mmHg	1	8	9(52.9)
36 - 44 mmHg	0	3	3(17.6)
> 44 mmHg	2	3	5(29.4)
Total	3	14	17(100)




Figura 3.11.14 Rezultate te pCO2 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.23 Rezultate te SaO2 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

SaO2	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
<75%	0	1	1(5.9)
75-89%	2	7	9(52.9)
90-94%	1	3	4(23.5)
>94%	0	3	3(17.6)
Total	3	14	17(100)




Figura 3.11.15 Rezultate te SaO2 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.24 Rezultate te HCO3 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

HCO3	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
< 22 mmol/L	1	10	11(64.7)
22–26 mmol/L	0	2	2(11.8)
> 26 mmol/L	2	2	4(23.5)
Total	3	14	17(100)




Figura 3.11.16 Rezultate te HCO3 ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Tabela 3.11.25 Rezultate te BE ne pacientet me EP te vdekur ne spital

BE	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
-20.4 gjer -1.9	0	11	11(68.8)
-2 gjer +2	1	2	3(18.8)
2.1 gjer 8.2	1	1	2(12.5)
Total	2	14	16(100)




Figura 3.11.17 Rezultate te BE ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Ne pacientet e vdekur ne spital me EP D-Dimer ka rezultuar ≤ 500 ng/mL ne 1(6.3%) rast, 500.1-2000 ng/mL ne 1(6.3%) rast, 2000.1-4000 ng/mL ne 3(18.8%) raste dhe >4000 ng/mL ne 11(68.8%) raste.

Tabela 3.11.26 Rezultate te D-dimer ne pacientet me EP te vdekur ne spital

D-Dimer	Seksi		Total (%)
	Femra	Meshkuj	
≤ 500 ng/mL	0	1	1(6.3)
500.1-2000 ng/mL	1	0	1(6.3)
2000.1-4000 ng/mL	1	2	3(18.8)
>4000 ng/mL	1	10	11(68.8)
Total	3	13	16(100)




Figura 3.11.18 Rezultate te D-dimer ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Pacientet janë trajtuar me Heparine te pa fraksionuar ne 16(88.9%) raste dhe ne 2(11.1%) raste me LMWH.

Probabiliteti klinik ne pacientet me EP te vdekur ne spital ka rezultuar i larte ne 3(17.6%) raste dhe i moderuar ne 14(82.4%) raste, ndërsa Geneva score ka rezultuar probabilitet i ulet ne 1(5.9%) rast, probabilitet mesatar ne 15(88.2%) raste dhe probabilitet i larte ne 1(5.9%) rast.

Tabela 3.11.27 Probabiliteti klinik ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Probabiliteti klinik	Seksi		Total (%)
	Femer	Mashkull	
I larte	0	3	3(17.6)
I moderuar	3	11	14(82.4)

Tabela 3.11.28 Geneva score ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Geneva score	Seksi		Total (%)
	Femer	Mashkull	
Probabilitet i ulet	0	1	1(5.9)
Probabilitet mesatar	3	12	15(88.2)
Probabilitet i larte	0	1	1(5.9)

Rezultati PESI ne pacientet me EP te vdekur ne spital ka rezultuar Klasa I ne 1(5.9%) rast, Klasa II ne 3(17.6%) raste, Klasa III ne 2(11.8%) raste, Klasa IV ne 7(41.2%) raste dhe Klasa V ne 4(23.5%) raste. Pra shume i ulet dhe i ulet ka rezultuaar ne 4(23.5%), ndërsa mesatar gjer shume i larte ne 13 (76.5%) raste. Rezultate sPESI ka rezultuar ne te gjitha rastet me risk te larte.

Tabela 3.11.29 Rezultate PESI ne pacientet me EP te vdekur ne spital

Rezultati Pesi	Seksi		Total (%)
	Femer	Mashkull	
Klasa I	0	1	1(5.9)
Klasa II	2	1	3(17.6)
Klasa III	0	2	2(11.8)
Klasa IV	1	6	7(41.2)
Klasa V	0	4	4(23.5)




Figura 3.11.19 Rezultate PESI ne pacientet me EP te vdekur ne spital

4. Diskutim

4.1 Prevalenca e EP ne te hospitalizuarit

Embolia pulmonare (EP) është sëmundja e tretë më e shpeshtë akute kardiovaskulare pas infarktut akut miokardi dhe Iktusit cerebral (125). Nga të dhënat e studimit rezultoi se EP përben 6.4% të rasteve të shtruar për sëmundje respiratore. Sipas (23) prevalenca e vlerësuar e EP akute në pacientët e shtruar në spital ishte 1.0%; në shtrimet në spitalet SHBA 0.4% (126) ; në shtrimet në spitalet kineze (127) 0.1% gjër 0.2. Përqindja e lartë e EP në të shtruarit e marrë në studim lidhet me profilin e kontigjentit të shtrimeve spitalin tone, krahasuar me atë të spitalit të përgjithshëm.

Numri i pacientëve të hospitalizuar me EP akute mund të jetë nënvlerësimit i numrit aktual të pacientëve me EP akute, sepse disa vdesin para pranimit, ndoshta deri në 25%. (128) Megjithatë, sipas autoreve, ky mund të jetë një mbivlerësim; vetëm 0.4% e pacientëve me EP vdiqën në departamentet emergjente. Përveç kësaj, ka pacientë me EP të heshtur, frekuenca e të cilëve është e papërcaktuar. EP e madhe ose fatale e padyshuar është konstatuar afërsisht në 4% të pacientëve në autopsi. Gjithashtu, pacientët me EP, të cilët trajtohen në shtëpi nuk identifikohen në të dhënat. Incidenca vjetore e TVTh dhe EP në popullatën në përgjithësi të Vendeve përendimore është vlerësuar respektivisht 1,0 dhe 0,5 për 1000 (11). Sipas (12) TEV është një çrregullim relativisht i zakonshëm që prek 1-2 për 1000 individë çdo vit. Sipas autorëve, megjithëse nuk disponohen të dhëna të sakta epidemiologjike, incidenca e EP vlerësohet të jetë përafërsisht 60 deri 70 për 100,000, dhe ajo e trombozës venoze rreth 124 për 100,000 të popullsisë së përgjithshme (13,14). Udhëzuesit evropianë në raportet për diagnozën dhe menaxhimin të EP tregojnë përqindjet vjetore të incidencës së trombozës venoze dhe EP prej afërsisht 0,5 deri 1,0 për 1000 banorë. (15). Megjithatë, shifrat aktuale kanë gjasa të jenë dukshëm më të larta, sepse EP e heshtur mund të zhvillohet deri në 40% në 50% të pacientëve me trombozë të thellë venoze (TVTH) (16).

Në pacientët e shtruar me EP nuk rezultuan ndryshime sinjifikante në lidhje me gjininë, 52.3% ishin meshkuj dhe 47.7% femra ($P = 0.4544$). Në lidhje me prevalencën gjinore të TEV kanë rezultuar ndryshime midis të dy gjinive në grupe të ndryshme të grupmoshave. Anderson e bshp. gjetën një incidencë të ngjashme në të dy gjinitë. (129) Silverstein e bshp. raportuan shkallë të

incidencës pak më të lartë të gratë e reja, dhe preference modeste në burra të moshuar. (130) Cushman et al. raportuan incidenca të ngjashme midis burrave dhe grave, përveç shpeshtesie dy here më të lartë tek burrat mbi 75 vjeç. (cituar 130) Studimi i ICOPER rezultoi me mbizotërim në seksin mashkull në incidencën e tromboembolizmit pulmonar. (18) Në studimin e Nagamalesh e bshp rezultoi incidencë më e lartë të EP tek popullata meshkuj (58% në meshkuj kundrejt 42% të femrat), por pjesa më e madhe e këtij ndryshimi ishte për shkak të niveleve më të larta të incidencës së EP tek meshkujt e moshuar; në moshe të re nuk pati ndryshime sinjifikante në incidencën e EP në secilin grup të popullsisë. (131)

Si dhe në të dhënat e literaturës në studim rezultoi rritje e prevalencës së EP me rritjen e moshës. Në moshat më të reja vëhet re shpeshtesi më e madhe në gjininë femer, gjë që barazohet në grup moshën 55-64 vjeç dhe më pas vëhet re numër më i madh i meshkujve. Yang dhe bshp konstatuan rritje eksponenciale të EP në meshkuj pas moshës 70 vjeçare dhe rënie të shpeshtesise së EP në femrat. (127)

Në rezultatet tona në lidhje me letalitetin spitalor rezultoi diferencë sinjifikante ($P = 0.05$) ndërmjet atij të përgjithshëm nga sëmundjet respiratore në total dhe nga EP. Shumica predominuese e vdekjeve kanë qenë në moshën ≥ 65 vjeç dhe kryesisht meshkuj. Shkalla e vdekshmërisë si pasojë e EP është nënvlerësuar. Nëse nuk trajtohet, EP akute është e lidhur me një shkallë të konsiderueshme të vdekshmërisë (deri në 30%), ndërsa shkalla e vdekshmërisë së EP të diagnostikuar dhe të trajtuar është 8%. Deri në 10% të pacientëve me EP akute vdes papritmas. Dy nga tre pacientë që pesojnë EP vdesin brenda 2 orëve pas paraqitjes, 4.2% në spital dhe 13.8% në 90 ditë pas daljes nga spitali (132). Embolia pulmonare është një ndërlikim i zakonshëm i shtrimit në spital dhe kontribuon në 5 deri në 10 përqind të vdekjeve në pacientët e shtruar në spital, duke e bërë atë një nga shkaqet kryesore të vdekjeve të parandalueshme në spital. (129) Shumica e këtyre pacientëve kishin sëmundje të avancuara shoqëruese. Nga të dhënat e studimit nuk vihen re diferencë sinjifikante në lidhje me gjininë dhe vendbanit.

4.2 Karakteristika të sëmurëve me TEP

Nga studimi rezultoi se përdorimi i duhanit është më evident në meshkujt se në femrat, si përse i përket shpeshtësisë ashtu dhe sasisë dhe kohëzgjatjes.

Embolia pulmonare është një ngjarje potenciale vdekjeprurëse kardiovaskulare, në të cilën korelacioni me pirjen e duhanit nuk është dokumentuar ende. Janë raportuar të dhëna konfliktuale për lidhjen midis pirjes së duhanit dhe rrezikut të tromboembolizmit venoz (EPV). Rezultatet kontradiktore janë në lidhje nëse pirja e duhanit është faktor rreziku për EP ose trombozë të thellë venoze (TVTH) (77) dhe meta-analiza nuk ka treguar se pirja e duhanit është faktor rreziku për tromboembolinë venoze (TEV). (78)Efektet e dëmshme të pirjes së duhanit në lidhje me sëmundjet kardiovaskulare arteriale janë të përcaktuara mirë. Sidoqoftë, lidhja midis pirjes së duhanit dhe EPV është më pak e qartë. Disa studime prospektive nuk kanë raportuar lidhje midis pirjes së duhanit dhe rrezikut të EPV. (133) Nga ana tjetër, disa studime observuese kanë demonstruar korelacion midis statusit të pirjes së duhanit dhe rrezikut të EPV (49, 134), ndërsa studime të tjera kanë raportuar se vetëm pirja e theksuar e duhanit shoqërohet me një rrezik të EPV. (77) Duket se pirja e duhanit mund të rrisë në mënyrë të pavarur rrezikun e tromboembolizmit. Për burrat që pinin duhan 15 cigare ose më shumë në ditë, rreziku relativ ishte 2.82 (95% CI, 1.30–6.13; $p = 0.009$) krahasuar me jo-fumatorët. (135) Në mënyrë të ngjashme, në gra të moshës 30 deri në 55 vjeç (77) mbipesha dhe pirja e duhanit ishin parashikues të pavarur të EP. Konfirmimi se pirja e duhanit është e lidhur me shkakun e TEV në sajë të niveleve të ngritura të fibrinogjenit kërkon dëshmi, që kjo e fundit është për shkak të pirjes së duhanit dhe se një nivel i tillë ka rëndësi klinike. (136)Megjithëse fibrinogjeni është propozuar të ketë një rol në trombozën venoze, të dhënat mbështetëse janë të kufizuara. Në një studim u demonstrua korrelacion pozitiv midis nivelit të fibrinogjenit plazmatik më të madh se 5 g/L dhe trombozës në pacientët të cilët kishin një episod të parë, të konfirmuar në mënyrë objektive të TVTH (137). Një studim i mëpasshëm mbi një popullsi të ngjashme zbuloi që nivelet e rritura të fibrinogjenit ishin të pavarura nga reagimi i fazës akute. (138) Në një studim të tretë, nivele të larta të fibrinogjenit shoqëroheshin me rrezikun e TVTH, por kryesisht tek të moshuarit. (139) Fibrinogjeni nuk rezultoi statistikisht i lidhur me EPV në dy studime të tjera. (140, 141)

Edhe pse janë hulumtuar rolet e mundshme moduluese të pirjes së duhanit në veprimtarinë e disa faktorëve të rëndësishëm në kaskadën e koagulimit, nuk mund të karakterizohet qartë një marrëdhënie e tillë. Elwakkad dhe kolegët (142) ekzaminuan pirjen e duhanit pasiv në pacientët me astmë dhe raportuan efekte potencialisht të rëndësishme në koagulimin e gjakut, me ngritje të

konsiderueshme në disa faktorë plazmatikë dhe rritje të agregimit të trombociteve dhe fibrinolizës. Edhe pse Dotevall (143) zbuloi se nivelet e fibrinogjenit në plazme ishin dukshëm më të larta në duhanpirësit, aktiviteti i faktorit plazmatik VIIIc nuk ndryshonte kur krahasohej me jo-duhanpirësit. Është interesante, Benowitz dhe bashkëpunëtorët e tyre (144) zbuluan se aktiviteti i faktorit VII ishte dukshëm më i ulët gjatë pirjes së cigareve sesa gjatë përdorimit të cerotit nikotine ose të placebo.

Perqendrimi i studimit që përfshin pirjen e duhanit dhe aspekte të ndryshme të koagulimit dhe fibrinolizës ka prirur të përqëndrohet në ndikimin e mundshëm në arteriosklerozë dhe më pak në EPV. Sidoqoftë, paralelet me EPV duhet të merren në konsideratë. Të dhënat konfliktuale ekzistojnë për sa i përket pirjes së duhanit dhe aspekteve të caktuara të koagulimit. (136)

Në studimin (145), pirja e duhanit (> 20 vjet-paketë) rezultoi të shoqërohet me një rrezik të rritur 1.5-fish të EPV totale dhe 1.8- rrezikun të rritur të EPV të provokuar, ndërsa asnjë lidhje nuk u gjet midis pirjes së theksuar të duhanit dhe rrezikut të EPV të pa-provokuar. Sidoqoftë, në analizën e rrezikut specifik për shkakun, rezultoi se pirja e theksuar e duhanit ishte shumë e lidhur me rritjen e rreziqeve të kancerit dhe IM, por jo me rrezikun e EPV në subjektet pa IM dhe kancer, që tregon se shumica e efektit të duhanpirjes në incidencën e EPV ndodh në personat me IM dhe kancer. (145) Në studimin në gratë që aktualisht pinin > 35 cigare në ditë, rreziku relativ i rregulluar për moshën për të gjithë EP ishte 2.1 dhe për EP idiopatike ishte 3.4 krahasuar me gratë që kurrë nuk kishin pirë duhan. Rreziku relativ i rregulluar për moshën i EP për gratë që pinin duhan 25-34 cigare në ditë ishte 1.7 për të gjitha EP dhe 1.8 për EP idiopatike. Rreziku më i tepërt për EP idiopatike ishte i kufizuar tek gratë që pinë më shumë se 20 cigare në ditë. Pacientët me një histori të kaluar të pirjes së duhanit nuk kanë rrezik për EP. (77) Një meta-analizë e 10 studimeve që përfshinin 3760 pacientë me trombozë dhe 34,520 kontrolle treguan se, në përgjithësi, pirja e duhanit nuk kishte efekt mbi TEV (78).

Pothuajse të gjithë pacientët e marrë në studim (96.7%) janë hospitalizuar si urgjencë mjekësore, për herë të parë (90.9%). Pacientë me recidivë kanë qenë në 9.1% të rasteve, në të cilët nuk rezulton përparësi kohore e ndodhisë së parë. Pacientët me TEP, si të shtrimit të parë dhe të përsëritur, janë në numër në rritje me rritjen e moshës. Rezulton se rastet e TEP që nuk janë shtruar si urgjencë kanë qenë të moshës mbi 55 vjeç.

4.3 Faktorë të fituar apo kongjenital, që predispojnë zhvillimin e TEP.

EPV aktualisht konsiderohet të jetë rezultat i një ndërveprimi midis faktorëve të rrezikut të lidhura me pacientin dhe të situatës (25). Faktorët predispozues të lidhura me pacientin zakonisht janë të përhershëm, ndërkohë që faktorët e rrezikut që lidhen me situatën janë më shpesh të përkohshëm. Megjithatë, vlerat parashikuese të këtyre faktorëve nuk janë të barabartë dhe EPV mund të ndodhë në pacientë pa ndonjë faktor predispozues të identifikueshëm.

Në studimin tonë pa faktor risku të fituar rezultojnë 9.1 % e pacientëve, 5 % meshkuj dhe 4.1 % femra. Faktorët e fituar të riskut që kanë ndikuar si të vetëm apo kombinimin e tyre kanë rezultuar në 90.9% të pacientëve me TEP. Si faktorë risku të fituar të veçantë rezultojnë më shpesh inflamacioni kronik - 25(20.6%), obeziteti - 24(19.8%), fibrilacioni atrial – 19 (15.7 %), trauma me dëmtim indor - 18(14.9%), imobilizimi -15(12.4%) dhe malinjiteti - 12(9.9 %).

Rreziku i embolisë pulmonare rritet me qëndrimin e zgjatur në shtrat ose imobilizimin e gjymtyrës. Imobilizimi çon në stanjacion venoz lokal duke akumuluar faktorët e koagulimit dhe fibrinën, duke rezultuar në formimin e koagulimit të gjakut. Në studim imobilizimi rezulton në 12.4% të pacientëve në total, 5.8% në meshkuj dhe 6.6% në femra.

Imobiliteti shoqërohet me ulje fluksit të gjakut venoz, veçanërisht në sakuset e valvulave venoze, duke çuar në inflamacion dhe hiperkoagulueshmëri. Në individë të rinj dhe të moshës së mesme, imobilizimi, si psh për shkak të shtrimit në spital ose dëmtimeve të vogla, është një faktor i konfirmuar rreziku për trombozë me vlerësime relative të rrezikut që variojnë nga 3 deri në 11. Megjithatë, nuk dihet në çfarë mase imobilizimi rrit rrezikun për tromboza venoze në individët më të vjetër. (149) Sipas (150) faktorët e rrezikut që lidhen me imobilitetin (d.m.th shtrimin në spital, operacioni, fraktura, dëmtime të vogla të këmbëve dhe imobilizimi kalimtar në shtëpi) u shoqëruan me rrezikun e trombozës venoze (si TVTH ashtu edhe EP me ose pa TVTH) në 3 muaj pas fillimit të imobilizimit (OR 2–13). Rreziku më i lartë i trombozës kishte rezultuar në imobilizim gjatë shtrimit në spital (OR 48.7, 95% CI 6.6–361.0) dhe rreziku i trombozës jashtë spitalit ishte rritur 15 herë gjatë 2 javëve pas daljes nga spitali; rreziku mbeti i rritur për 3 muaj më vonë pas daljes nga spitali. Studimet në lidhje me imobilitetin dhe rrezikun e trombozës në individë të moshuar raportuan vlerësime të ngjashme të rrezikut, duke filluar nga 1.5- 8 fish rritje të riskut. (150)

Udhëtimi i zgjatur rezultoi në studim si faktor risku në 0.8% të pacientëve. Lidhja midis pozicionit të ulur dhe rrezikut të trombozës së thellë venoze (TVTH) është përshkruar ndoshta për herë të parë nga Simpson në vitin 1940. Ky kirurg britanik vërejti rritje të konsiderueshme të embolise pulmonare (EP) fatale në britanikët të detyruar të qëndronin në pozicion ulur në kushte të ngushta për orë të tëra gjatë bombardimit në Londër. Raporti i shanseve për udhëtim me makinë > 4 orë ishte 2.2 dhe ishte edhe 2.2 për > 4 orë udhëtim me autobus, por ishte më i lartë për udhëtim me tren, 3.5. Rreziku i TEV-së me udhëtim me makinë, autobus ose tren > 4 orë ishte më i lartë në udhëtarët me faktor V Leiden (koeficienti 8.1), në ata që kishin indeks të masës trupore më shumë se 30 kg/m² (raporti 9,9), në ata që ishin më shumë se 1.90 m gjatësi (raporti 4.74) dhe në ata që përdorën kontraceptivë oral (raporti i rastësishëm > 20). Me udhëtimin nga çdo mjet, rrezik 18% më i lartë për TEV është identifikuar për çdo rritje 2-orëshe të kohëzgjatjes së udhëtimit. Periudhat e zgjatura në ambjente të ngushta, pavarësisht nga udhëtimi, mund të çojnë në EP. (cituar 87)

Sipas të dhënave të studimit ka rezultuar se 20.6% e pacientëve kanë patur të dhëna për inflamacion kronik (10.7% e meshkujve dhe 9.9% e femrave) dhe 14.9% të dhëna të dëmtimit indor (9.1% e meshkujve dhe 5.8% e femrave). Në studimin e Gjonbrataj e bshp. (146) aktiviteti i proteinave S dhe prania e infeksionit ishin faktorë të rëndësishëm që shoqërohen me EP të provokuar. Theksohet se duhet t'i kushtohet vëmendje pranisë së infeksionit në pacientët me EP të provokuar. Shkalla e infeksionit ishte 2 herë më e lartë në pacientët me EP të provokuar sesa në ata me EP të pa-provokuar. Infeksioni më i shpeshtë i shoqëruar me EP ishte pneumonia. Sidoqoftë, frekuenca e pneumonisë ishte 2 herë më e lartë në pacientët me EP të paprovokuar sesa në ata me EP të provokuar. Lidhja midis EP dhe infeksionit mbështetet nga disa studime. (37, 147, 1148) Në studime të tjera raporti i shanseve varion nga 1.7 në 5.0. (148)

Në veçanti, historia e mëparshme e trombozës sipërfaqësore të venave, imobiliteti që nuk lidhet me spitalin dhe seksi mashkull ishin faktorë të rëndësishëm rreziku për EPV simptomatike pas dëmtimit traumatik me HR më të madh përkatësisht 2.7, 2.4, dhe 2.1. Godat e bshp. treguan se periudha e rrezikut të EPV pas dëmtimit akut është më e larta gjatë 3 muajve të parë pas lëndimit. (151)

Kanceri është shkaku i dytë më i zakonshëm i hiper-koagulueshmërisë, duke përbërë 10-20% të TVTH spontane (41). Në studim rezulton se 9.9% e pacientëve kanë vuajtur me sëmundje malinje (5.8% e meshkujve dhe 4.1% e femrave).

Përafërsisht 15% e pacientëve me kancer kanë trombozë klinike dhe deri në 50% kanë trombozë në autopsi (56). Mekanizmi me të cilin qelizat e tumorit kontribuojnë në trombozë nuk është i qartë. Është treguar se qelizat tumorale ndërveprojnë me trombin dhe plasminën dhe ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e trombusit. (43) Pacientët me sëmundje malinje kanë rritje të dyfishte të zhvillimit të tromboembolisë venoze. (57) Krahasuar me personat pa malinjitet, rreziku i zhvillimit të TEV simptomatike është shtatë herë më i lartë në pacientët me kancer. (58) Në 235,149 raste të kancerit, TEV simptomatike të konfirmuara janë diagnostikuar brenda 2 viteve në 1,6%. (59) Në modelet për vlerësimin e rrezikut, sëmundja metastatike në kohën e diagnozës ishte përcaktuesi më i fortë i TEV. (59) Të gjitha llojet e tumoreve hematologjike dhe solide janë shoqëruar me VTE, por rreziku i TEV ndryshon në lloje të ndryshme të kancerit. (59) Në përshtatje për moshën dhe stadin, diagnoza e VTE ishte një parashikues i rëndësishëm i vdekjes gjatë vitit të parë për të gjitha llojet e kancerit. (59)

Në pacientët me TEV simptomatike, prevalenca e kancerit shoqërues, e panjohur para diagnozës së TEV dhe zbuluar nga hetimi rutinë në kohën e diagnozës TEV, ndryshon midis 4% dhe 12%. (60) Rreziku i kancerit okult është i rritur tre deri në katër herë në pacientët me TEV idiopatike krahasuar me TEV dytësore. (60) Duke marrë parasysh incidencën e lartë të diagnostikimit të kancerit në muajt fillestarë pas TEV, ekzaminimi për malinjitet bazë mund të jetë i rëndësishëm klinikisht. Megjithatë, literatura nuk është konkordante, nëse indikohet depistim i gjërë për malinjitet t okult.

Tromboza e lidhur me kancerin është shkak kryesor i vdekshmërisë në pacientët me kancer, më së shumti lloji i zakonshëm është tromboembolizmi venoz (EPV). Disa faktorë rreziku për zhvillimin e EPV gjithashtu janë së bashku në pacientët me kancer, të tilla si kimioterapia dhe imobilizimi, duke kontribuar në rritjen e rrezikut të pacientëve me kancer në zhvillimin të VTE në krahasim me pacientët pa kancer. Qelizat kanceroze janë të afta të aktivizojnë kaskadën e koagulimit dhe vetitë e tjera protrombotike të qelizave pritëse. Gjithashtu shumë trajtime antikanceroze përshkruhen si mekanizma shtesë për promovimin e EPV. (152)

Armand Trousseau raportoi për herë të parë për marrëdhëniet midis trombozës dhe kancerit në 1865. Që atëherë, studime të shumta kanë vërtetuar se tromboza është një ndërlikim i zakonshëm për pacientët me kancer, duke kontribuar në shkakun e dytë kryesor të vdekshmërisë në pacientët me kancer (153).

Komplikimet trombotike në kancer mund të ndryshojnë nga tromboembolizmi arterial ose venoz në koagulimin intravaskular të disseminuar (154, 155). Pavarësisht lidhjes së njohur mes kancerit dhe sëmundjes tromboembolike, mekanizmat që nxisin ngjarjet tromboembolike në pacientët me kancer nuk janë të qarta dhe duket se janë të shumëanshme (156). Pacientët me kancer janë përgjithësisht në gjendje hiperkoagulibiliteti ose protrombotike, pasi ata zakonisht paraqiten me anomali në secilën përbërës të triades Virchow, duke kontribuar kështu në trombozë. Të tre përbërësit janë stazë e fluksit të gjakut, dëmtimi endothelial dhe hiperkoagulueshmëria, kjo e fundit si pasojë e anomalive në mekanizmat e koagulimit dhe fibrinolitike, si dhe aktivizimi i trombociteve. Mekanizmat specifikë nuk janë kuptuar mirë dhe mund të jenë specifike të tumorit me që lloje të ndryshme të kancerit kanë shkallë të ndryshme të rrezikut për trombozën e lidhur me kancerin.

Pacientët me kancer kanë rritje 5-7-fish të rrezikut të zhvillimit të EPV (58, 157) dhe ata që zhvillojnë EPV priren të kenë prognozë dukshëm më të keqe në krahasim me pacientët me kancer pa EPV. (158)

Diagnoza e EPV është ndërlikim serioz i kancerit që ndikon negativisht në cilësinë e jetës së pacientit dhe zvogëlon normat e përgjithshme të mbijetesës. (159, 160). Vlerësohet se afërsisht 4-20% e pacientëve me kancer do të përjetojë EPV gjatë ecurisë së kancerit, shkalla është më e lartë në periudhën fillestare pas diagnozës. Cdo vit, 0.5% e pacientëve me kancer do të pësojnë trombozë në krahasim me një normë të incidencës prej 0,1% në popullsinë e përgjithshme (161, 162)

Në 31.4% të pacientëve në studim kanë rezultuar sëmundje shoqëruese të zemrës. Insuficiencia kardiake, që në studimin tonë ka rezultuar në 5.8% të rasteve, është faktor rreziku për tromboembolinë venoze (TEV), e definuar si embolia pulmonare (EP) dhe/ose tromboza e thellë venoze (TVTH). Rritja e rrezikut të TEV të observuar me insuficiencën e zemrës i është atribuar reduktimit të fluksit të shkaktuar nga debiti i ulët kardiak dhe anomalitë e funksionit të trombociteve dhe funksionit endotelial (65). Pacientët me insuficiencë të rëndë të zemrës kanë

më shumë gjasa të kenë aktivizimin e trombociteve dhe sistemin e koagulimit (66). Gjithashtu, pacientët me insuficiencë të zezmës kanë më shumë gjasa të kenë faktorët e rrezikut të TEV si imobilizimi (53% kundrejt 42%, $p < 0,0001$), infeksion akut (33% kundrejt 27%, $p = 0,01$) dhe sëmundje pulmonare obstruktive kronike 29% kundrejt 12%, $p < 0.0001$) (67). Pacientët me insuficiencë të zezmës kanë tendencë të jenë më të vjetër, gjë që gjithashtu rrit rrezikun e TEV (65). Shkalla e EP në pacientët e hospitalizuar me insuficiencë të zezmës ka rënë nga 1.38% në vitet 1979-1981 në 0.61% në vitet 2000-2003 (68).

Insuficienca e zezmës duket të jetë një faktor më i fortë i rrezikut tek gratë. Dries e bshp. raporto i ndryshim të rëndësishëm midis gjinive në shpërndarjen e ngjarjeve tromboembolike në pacientët me insuficiencë të zezmës. Ndër gratë me insuficiencë të zezmës, 24% kishin EP, ndërsa tek meshkujt me insuficiencë të zezmës 14% kishin EP (69).

Diagnozat spitalore të sëmundjes së zezmës u shoqëruan me një rrezik të rritur ndjeshëm të tromboembolizmit venoz në 3 muajt pasues. Rreziku relativ ishte veçanërisht i lartë për emboli pulmonare të izoluar pa diagnozë të njëkohshme të trombozës parësore venoze të thellë. Korelacioni ishte shumë më i lartë për sëmundjet valvulare të djathta se sa të majta. Rreziqet e rritura relative të shoqëruara me infarkt miokardi dhe dështim të zezmës duket se shtrihen përtej 3 muajve fillestar nga shtrimi në spital për sëmundje të zezmës, por korelacioni ishte shumë më i dobët për një kohë më të gjatë. Vlerësimet e rrezikut janë në thelb më të theksuara kur episodet e tromboembolizmit venoz ishin diagnoza të dyta, duke treguar se tromboembolizmi venoz ishte ndërlikim i sëmundjes së zezmës dhe jo anasjelltas. (163)

Rritja e rrezikut të trombozës venoze të thellë, e vetme ose e shoqëruar me emboli pulmonare, pas një diagnoze kardiake është në përputhje me faktin se disa sëmundje të zezmës shkaktojnë staza venoze dhe presion venoz sistematik të ngritur. (68) Rritja e rrezikut të embolisë pulmonare të izoluar në 3 muajt pas incidentit të sëmundjes së zezmës sugjeron që disa sëmundje të zezmës mund të shkaktojnë drejtpërdrejt zhvillimin e embolisë simptomatike pa trombozë të dukshme periferike. Tromboza intrakardiace e djathtë është një faktor rreziku për emboli pulmonare ashtu si tromboza intrakardiace e majtë është një faktor rreziku i vendosur mirë për embolinë arteriale siç është ajo që ndodh, për shembull, në fibrilacion atrial. (164) Të dhënat konfirmojnë që ngjarjet kardiovaskulare ndikojnë në rrezikun e mëvonshëm të tromboembolizmit venoz, të paktën në 3 muajt pas ngjarjes kardiovaskulare ose gjatë shtrimit

fillestar në spital për ngjarjen. (165) Studimet e mëparshme nuk kanë raportuar asnjë lidhje midis markuesve joinvazivë të arteriosklerozës në pacientët pa simptoma dhe rrezikut pasues të tromboembolizmit venoz. (166, 167) Prandaj, rregjimi i shtratit dhe imobilizimi i lidhur me sëmundjen klinike të zemrës ka të ngjarë të shpjegojnë pjesërisht rrezikun e rritur.

Formimi i trombit në atriumin e djathtë është raportuar gjithashtu në pacientët me FA (168), duke sygjëruar se embolia pulmonare (EP) mund të lindë nga trombi intrakardiak. Edhe pse tradicionalisht perceptohet si një ndërlikim i trombozës së venave të thella (TVTH), të dhënat tregojnë se 50% e ngjarjeve të EP ndodhin në mungesë të TVTH-ve të zbulueshme. (169) Në të dhënat tona rezulton se FA kanë patur 15.7% e pacientëve (7.4% e meshkujve dhe 8.3% e femrave). Të dhënat nga studimet mbështesin konceptin se FA është një faktor rreziku për EP. Disa studime me bazë spitalore kanë demonstruar prevalencë të FA në pacientët me EP akute në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Në një studim zbuluan se pacientët me FA kishin një rrezik të shtuar të tromboembolizmit venoz pasues (EPV). Rreziku ishte veçanërisht i lartë gjatë 6 muajve të parë pas diagnostikimit të FA, veçanërisht për EP dhe 15% deri 20% të ngjarjeve të EP në popullatë mund t'i atribuohen FA. (170) Lidhje e ngjashme midis FA dhe EP u tregua në një studim i regjistrit i bazuar në popullsi të madhe nga Tajvani. (171)

Lidhja e dukshme midis FA dhe EP mund t'i atribuohet faktorëve të rrezikut të përbashkët, të shkaktuara nga faktorë të lidhur me vetë FA (p.sh. trombi intrakardiak), ose të ndërmjetësuar nga iktusi ose ndërlikimet që lidhen me iktusin si pasojë e FA. Studimet klinike dhe studimet e bazuara në popullatë kanë treguar bindshëm se pacientët me iktus cerebral kanë rrezik të rritur të EPV, veçanërisht gjatë muajve të parë pas diagnozës. (172, 173, 174) Iktuset e shkaktuara nga FA janë më të rënda dhe shpesh indikojnë shtrimin në spital dhe komorbiditetet, të tilla si dehidratimi, palëvizshmëria dhe infeksionet, të cilat mund të kontribuojnë shtesë për të rritur rrezikun e EP.(73)

Pacientët me iktus janë në rrezik të veçantë për të zhvilluar trombozë të thellë venoze (TVTH) dhe emboli pulmonare (EP) për shkak të paralizës së gjymtyrëve, qëndrimit të zgjatur në shtrat dhe aktivitetit protrombotik të rritur (70). Shkalla më e lartë e EP, TVTH dhe TEV në pacientët me iktus hemorragjik në krahasim me pacientët me infarkt ishemik mund të kërkojë përdorimin më të shpeshtë të profilaksisë antitrombotike në pacientët me goditje hemorragjike, megjithëse trajtimi nuk ishte i njohur. (71)

The International Stroke Trial Collaboration Group tregoi se në pacientët me infarkt ishemik, të cilët kanë marrë heparinë me dozë të ulët (5000 IU dy herë në ditë), incidenca e EP brenda 14 ditëve ishte 33 nga 4860 (0.7%) dhe në ata që morën heparin me doze mesatare (12,500 IU dy herë në ditë), incidenca e EP brenda 14 ditëve ishte 20 nga 4856 (0.4%). Përveç kësaj, disa kanë marrë aspirine 300 mg/ditë. Në të gjithë pacientët të trajtuar me aspirinë, heparine, së bashku të dyja ose asnje, incidenca e EP varioonte nga 0.5 në 0.8% (72). Shumica e studimeve të terapisë antitrombotike për ictus cerebral ose për parandalimin e TVTH në pacientët me ictus përjashtonin pacientët me ictus hemorragjik. (72)

Megjithëse vdekjet brenda disa ditëve të ictus janë zakonisht për shkak të pasojave të drejtpërdrejta të dëmtimit të trurit, ato që ndodhin gjatë javëve të ardhshme janë kryesisht për shkak të problemeve potencialisht të parandalueshme, duke përfshirë EP (73).

Në studimin tonë 3.3% e pacientëve kanë patur ictus cerebral (1.7% e meshkujve dhe 1.7% e femrave).

Sipas Rinde (172) Rreziku i EPV është i rritur gjatë 3 muajve të parë pas ictus ishemik. Rreziku veçanërisht i lartë i EPV të provokuar sugjeron që faktorë shtesë predispozues, të tilla si imobilizimi, potencojnë rrezikun e EPV në pacientët me ictus ishemik.

Edhe pse embolia pulmonare klinikisht e evidente (EP) ndodh në vetëm 1% të pacientëve me ictus gjatë 14 ditëve të para pas ictus akut (72), EP mund të përbëje deri në 25% - 50% të vdekjeve pas ictus akut. (173)

Në studimin (172) subjektet që zhvilluan ictus ishemike kishin një rrezik të shtuar të EPV, krahasuar me ato pa ictus ishemik në popullatën e përgjithshme. Shkalla e incidencës dhe rreziku relativ ishin veçanërisht të larta gjatë 3 muajve të parë pas ictus ishemik dhe u zvogëlua me shpejtësi pas kësaj.

Sipas nje studimi rezultoi se vetëm mosha dhe mbipesha ishin faktorë të rrezikut të përbashkët për ictus ishemike dhe EPV.(133) Të dhënat nuk përjashtojnë, mundësinë e efekteve të përbashkëta midis mjedisit të përbashkët dhe të trashëguar si faktorë të rrezikut protrombotik që mund të rritin rrezikun e EPV në kushte të rrezikut të lartë të trombozës në lidhje me vetë ictus ishemik (p.sh., shtrimi në spital, imobilizimi dhe infeksionet akute sekondare).

Antitruapat antifosfolipide, që në studimin tonë janë konstatuar në 0.8% të pacientëve, shoqërohen me trombozë artriale dhe venoze (61). Nëngrupet më të zbuluara të antitrupave antifosfolipidë janë antitruapat lupus antikoagulant, antitruapat anticardioliopin dhe antitruapat anti-B2-glikoprotein I. Rritja e shprehjes dhe aktiviteti i faktorit indor është ndërmjetësuar nga antitruapa kundër proteinave të lidhura me fosfolipid, të pranishme në qelizat endoteliale ose në qeliza të tjera. Reagimi antigjen-antitrup çliron faktorin indor, që inicion kaskadën e koagulimit që çon në gjendjen prothrombotike (62). Mekanizmi i saktë me anë të të cilit këto antitruapa e nxisin sinjalin e transduksionit për të prodhuar faktorin indor ende nuk janë sqaruar.

Sindroma antifosfolipid primar ndodh tek pacientët pa dëshmi klinike të sëmundjes autoimune, ndërsa sindroma sekondare antifosfolipid ndodh në bashkëpunim me sëmundjet autoimune. Lupus erythematosus sistemik (SLE) është çrregullimi më i zakonshëm autoimun që shoqërohet me sindromin antiphospholid. (62)

Tromboza e thellë venoze, manifestimi më i zakonshëm i sindromës antifosfolipid, ndodh në 29-55% të pacientëve me sindromë, dhe rreth gjysma e këtyre pacientëve kanë emboli pulmonare. (63) Meqënëse nuk ekziston lidhje përfundimtare ndërmjet manifestimeve klinike specifike dhe nëngrupeve të veçanta të antitrupave antifosfolipidë dhe pacientët mund të jenë negativë sipas një prove dhe pozitivë për një tjetër, rekomandohen teste të shumëfishta për antitruapat antifosfolipide. (62) Embolia pulmonare e përsëritur mund të shkaktojë hipertension pulmonar, që mund, në mënyrë të pazakontë, në raste të rënda, të shoqërohet me insuficiencë të izoluar të valvulës trikuspidale. Sipas Farmer- Boatwright e bshp. (175) deri në 20% të rasteve të trombozës së venave të thella, me dhe pa emboli pulmonare, mund të shoqërohen me antitruapa antifosfolipid. Këta antitruapa zakonisht zbulohen në analizat për lupus antikoagulues dhe testet për antitruapa anticardioliopin.

Sindroma nefrotike gjithashtu një faktor rreziku për tromboembolinë venoz (TEV) (74), në studim rezultoi në 1.7% të pacientëve, të gjitha të gjinise femrore.

Sindroma nefrotike ndodh me shpesh tek të rriturit e rinj. Tromboza venoze renale ka rezultuar e pazakontë. Prandaj, embolia pulmonare (EP) në pacientët me sindromin nefrotik ka të ngjarë të jetë për shkak të trombozës së thellë venoze (TVTH) (74) dhe jo trombozës së venës renale, siç kishin dyshuar autorë të tjerë (75). Në një analizë të sëmurësh spitalor, pacientët me sindromin nefrotik, 0.5% kishin EP, 1.5% kishin TVTH dhe shumë pak raste për të llogaritur një numër të saktë kishin trombozë renale të venave. Ndër ata që nuk kishin sindromin nefrotik, 0,4% kishin EP, 0,9% kishin TVTH dhe 0,003% kishin trombozë të venave renale. Rreziqet relative ishin 1.39 për EP dhe 1.72 për DVT. (74) Në pacientët të moshës 18-39 vjeç, rreziku relativ i TVTH në pacientët me sindromin nefrotik ishte 6.81. (74) Midis pacientëve 40 vjeç, rreziku relativ i TVTH ishte më i ulët, 1.05.

Fenomenet tromboembolike te pacientët nefrotikë postulohen si rezultat i humbjes me anë të urinës të faktorëve antitrombotikë nga veshkat e prekura dhe rritja e prodhimit të faktorëve protrombotikë nga mëlçia. Shumica e rasteve të EPV të shoqëruara me sindrom nefrotik të raportuara në literaturë kanë një diagnozë të njohur paraprakisht të sindromit nefrotik. (176)

Në një studim prospektiv nga Zhang et al., në pacientë me sindrom nefrotik 35% kishin EP dhe/ose trombozë të v. renale. Ata zbuluan se EP është më e zakonshme se tromboza venoze renale në pacientët nefrotikë dhe shumica e pacientëve ishin asimptomatikë (84%). (177) Medjeral-Thomas et al. raportojnë që EPV shfaqet në 7-40% të pacientëve me sindrom nefrotik. (178) Kayali e bshp. raporton tromboza venoze e thellë të jetë ndërlikimi më i zakonshëm trombotik në pacientët nefrotikë. (74) Në të kundërt, Suri e bshp. zbuloi se EP është më e zakonshme se TVTH. (179) Në një studim nga Li e bshp. EPV u demonstrua në 36% të pacientëve. (180) Të dhënat e disponueshme janë të kufizuara dhe kontradiktore dhe si të tilla theksojnë nevojën për studime në të ardhshme në këtë popullatë pacientësh.

Shkaku i gjendjes hiperkoaguluese në pacientët me sindromin nefrotik nuk është plotësisht i qartë. Në sindromin nefrotik, dëmtimi i membranës glomerulare rezulton në rritjen e filtrimit të proteinave të vogla si antitrombin III, plazminogenit, proteinës C dhe proteinës S, dhe kjo nga

ana tjetër çon në rritjen e koagulimit. Në pacientët me sindrom nefrotik, humbja e albuminës dhe hipoalbuminemia rezultuese sjell rritje të sintezës hepatike të fibrinogjenit, gjë që favorizon gjithashtu formimin e trombit. (181)

Tromboembolizmi në sindromin nefrotik mund të jetë venoz ose arterial; sidoqoftë, incidenca e trombozës arteriale është shumë më e ulët në krahasim me venozen. (182) EPV në pacientët nefrotikë përfshin TVTH, EP dhe trombozën e v. renale.

Pacientët me sindrom nefrotik kanë të rritur reaktivitetin e trombociteve dhe shpesh trombocitozë. Është thelbësore se shumë pacientë me sindrom nefrotik mund të kenë faktorë të tjerë rreziku për trombozë venoze përveç sindromit nefrotik. Faktorë të tillë të rrezikut përfshijnë imobilizim të zgjatur, operacione të kohëve të fundit, TVTH dhe EP të mëparëshme, mbipeshë, prania e kateterëve venoz qendror, iktus cerebral dhe paralizë. (183) Kështu, është thelbësore t'i qasemi vlerësimit të rrezikut trombotik në këta pacientë në një mënyrë të plotë.

Obeziteti ka rezultuar se është një faktor rreziku dhe prognostikues në sëmundje të ndryshme.

Obeziteti u tregua si faktor rreziku për embolinë pulmonare (EP) dhe trombozën e thellë venoze (TVTH) tek meshkujt dhe femrat. Në pacientët e studiuar nga ne rezultoi me obezitet 19.8% e rasteve dhe, në përputhje me shumicën e literaturës, më shpesh në femra (6.6% e meshkujve dhe 13.2% e femrave). Femrat obeze kishin një rrezik më të madh relativ për DVT sesa meshkujt obezë, 2.75 kundrejt 2.02. Prevalenca si e EP dhe TVTH në femrat shtatzëna obeze ishte më e lartë se në meshkujt obezë. Rreziku relativ i EP, duke krahasuar pacientët obezë me pacientë jo obezë, ishte 2.21 dhe për TVTH ishte 2.50. Obeziteti pati ndikimin më të madh tek pacientët < 40 vjeç, në të cilët rreziku relativ për EP në pacientët obezë ishte 5.19 dhe rreziku relativ për DVT ishte 5.20. (76)

Sipas (76), ndër pacientët e hospitalizuar diagnostikuar me obezitet 0.8% kishin EP. Në pacientët e hospitalizuar, të cilët nuk ishin diagnostikuar me obezitet, EP u diagnostikua në 0,3%. Tromboza e thellë venoze u diagnostikua në 2,0% pacientët e diagnostikuar me obezitet dhe në 0.8% të cilët nuk u diagnostikuan me obezitetin.

Sipas Poowana wittayakom (184) nëse obeziteti ka disa vlera prognostike në EP akute nuk është raportuar mirë. Në studimin e tyre zbuluan se pacientët me mbipeshë me EP kanë rezultate më

të mira prognostike në krahasim me pacientët nëneshë ose normale të përcaktuar nga sPESI. Ky konstatim është në përputhje me studimet e mëparshëm të pacientëve të shtruar në spital që tregojnë përfitim në vdekshmëri. (185) Faktorë të tillë si rezerva ushqyese mund të luajnë një rol të madh në këto grupe të pacientëve.

Sipas autoreve gratë shpesh kanë faktorë rreziku shtesë për EPV siç janë përdorimi oral kontraceptiv, terapia hormonale, shtatzënia ose periudha pas lindjes. (186) Sidoqoftë, burrat, në krahasim me gratë, kishin rrezik më të lartë për të zhvilluar EPV simptomatike pas traumës (HR 2.1, 95% CI: 1.4 –3.1). Për më tepër, ndërsa fraktura është një faktor i njohur rreziku EPV në krahasim me individët pa trauma, në mesin e pacientëve me trauma akute, fraktura nuk ishte faktor i pavarur rreziku për EPV. Rritja e moshës së pacientit, seksi mashkull, rritja e gravitetit të dëmtimit, imobiliteti para traumës, dëmtimi i indeve të buta në këmbë dhe tromboza e mëparshme sipërfaqësore e venave mund të identifikojnë pacientët me rrezik të shtuar për EPV brenda 92 ditëve pas shtrimit në spital për traumat akute, të pavarura nga operacioni. Këto karakteristika mund të jenë të dobishme për stratifikimin e pacientëve me trauma në rrezik të lartë dhe të ulët të VTE, si dhe për të synuar profilaksinë e EPV për ata pacientë që do të përfitonin më shumë. Shkalla e profilaksisë EPV ishte më e lartë në rastet e EPV sesa grupin e pacientëve të tjere, duke sugjeruar që profilaksia ishte ose e pamjaftueshme ose e dështuar. Për tu shënuar, 62% e rasteve zhvilluan EPV pas daljes nga spitali, duke sygjëruar rol të mundshëm për profilaksinë e zgjatur jashtë spitalit. Konfirmimi i këtyre hipotezave do të kërkojë studime shtesë. (146)

Kateterët qendror venoz dhe filli nga implantimi i defibrilatorëve kardiakë dhe pacemakers janë të zakonshme në pacientët me insuficiencë të zemrës dhe kanë rezultuar se rrisin rrezikun e trombozës së thellë të venave të ekstremiteteve të sipërme (65). Në rastet tona ka rezultuar vetëm një grua (0.8% e rasteve) me kateter central venoz.

Tromboza e kateterit central venoz mund të shkaktojë jo vetëm në okluzionin vaskular dhe të kateterit, por edhe infeksion, emboli pulmonare dhe formimin e tromboembolit të zemrës së djathtë. Trombi brenda kamerave kardiake shoqërohet me një rrezik të shtuar të vdekshmërisë për shkak të potencialit të tyre për embolizim të vazave pulmonare. (187) Të dhënat mbi shpeshësinë në literaturë variojnë dhe ndryshojnë në bazë të faktorëve të individit, karakteristikave të kateterit, lokalizimi i kanjucionit dhe infuzioneve të administruara.

Vlerësimet e trombozës në lidhje me kateterin central venoz ndryshojnë në varësi të vendit të futjes, në përgjithësi, duke filluar nga 2% në 4%. EP ndodh në afërsisht 15% të individëve me TVTH në ekstremitetin e sipërm të lidhur me kateterin venoz. (187)

Në lidhje me moshën vihet re se faktorët e riskut të fituar rriten me rritjen e moshës dhe respektivisht 1.7% në grupmoshën 25- 34 vjeç, 5.7 % në grupmoshën 35 - 44 vjeç, 8.2 % në grupmoshën 45 - 54 vjeç, 23.9 % në grupmoshën 55 – 64 vjeç dhe 53.7% në grupmoshën >64 vjeç.

4.4 Të dhëna klinike të sëmurëve me TEP.

Tromboembolia venoze është sëmundje me spektër klinik duke filluar nga tromboza asimptomatike e venave të thella deri tek emboli pulmonare fatale. Fatkeqësisht, EP mund të jetë asimptomatike ose e pranishme me vdekje të papritur. Në disa raste, EP mund të ndodhë shumë papritur, pa ndonjë paralajmërim. Simptomat e EP, kur vërehen, janë gjithashtu shumë jospecifike. Për shembull, dispnea dhe dhimbje në gjoks mund të shfaqen me pneumoni, bronkit, ose probleme të tjera të mushkërive ose zemrës. Dhimbja në kraharror mund të shkaktohet nga një numër problemesh, duke përfshirë sforcim të muskujve, problemet e zemrës, infeksionet e mushkërive, problemet e stomakut, si psh refluksi i acidit ose hernie hiatale, apo edhe nga ankthi. Kurdoherë që një pacient ka simptoma të tilla si dispne ose dhimbje në gjoks, veçanërisht kur personi ka faktorë të tjerë të rrezikut për TVTH (siç është operacioni i kohës së fundit, shtrimi në spital për një sëmundje mjekësore ose imobilizimi recent), EP duhet të konsiderohet si mundësi. (188)

Në paraqitjen e të sëmurëve në spital simptomi më i shpeshtë ka qenë dispnea në efort - 116(95.9%), pasuar nga dhimbja torakale -103(85.1%), dispnea në qetësi – 90 (74.4%), temperaturë - 23(19%), hemoptizi – 17(14%). Gjendje sinkopale ose presinkopale kanë patur 11(9.1%) pacientë. Në grupin në studim nuk ka patur asnjë rast në gjendje shoku apo vdekje e menjëherëshme. Hipoksemia është konstatuar në 55(45.5%) pacientë, aritmi kardiake – 23(19%), hipertension pulmonar – 16(13.2%) dhe insuficiencë të zemrës së djathtë -10(8.3%) pacientë. Shpeshtësia e pranisë së simptomave është më e shpeshtë me rritjen e moshës, gjë që ka lidhje me frekuencën më të lartë të sëmundjes së TEP me rritjen e moshës.

Në studimin Prospective Investigation of Pulmonary Embolism Diagnosis II (PIOPED II), pacientët me EP kishin një variete shenjash dhe simptomash. Simptomat më të zakonshme ishin dispnea, zakonisht e shfaqjes brenda sekondave, në qetë si ose efort (73%), dhimbje pleuritike (44%) dhe kollë (34%) (7). Paraqitja klinike e EP ndryshon gjerësisht, sic vihet re dhe në studimin tonë, ku dispnea është simptoma më e shpeshtë. Simptomat ndryshojnë nga dispne e rëndë, cianoza ose sinkopi që sugjerojnë EP masive ndërsa dhimbje pleuritike, kollë ose hemoptizë që tregon EP më të vogël periferike. Sipas Nagamalesh e bshp. (131) të gjithë pacientët në studim janë paraqitur me dispne, dhimbje në gjoks (29%) dhe sinkop (32%) ishin simptomat e tjera të raportuara shpesh.

Simptomat e embolisë pulmonare janë tipike me fillim të menjëhershëm dhe mund të përfshijnë një ose më shumë nga sa vijon: dispne, takipnea, dhimbje në gjoks të natyrës "pleuritike" (përkeqësuar nga frymëmarrja), kollë dhe hemoptizi. (189) Rastet më të rënda mund të përfshijnë shenja të tilla si cianoza, kolapsi dhe paqëndrueshmëria e qarkullimit të gjakut për shkak të rënies së fluksit të gjakut nëpër mushkëri dhe në anën e majtë të zemrës. Rreth 15% e të gjitha rasteve të vdekjes së papritur i atribuohen EP. (190) Ndërsa EP mund të paraqitet me sinkopë, më pak se 1% e rasteve të sinkopit janë për shkak të EP. (191)

Embolia pulmonare u identifikua në pothuajse një nga çdo gjashtë (17.3%) pacientët e shtruar në spital për një episod të parë të sinkopit. (192) Sinkopi në përgjithësi pritet të ndodhë në pacientët me emboli pulmonare nëse ato kanë një bllokim të papritur të arterieve pulmonare më proksimale që çon në një depresion kalimtar në debitin kardiak. (193) Prandoni e bshp. (192) konstatuan se në 67.1% të pacientëve, të cilët kishin emboli pulmonare që u diagnostikuan sipas të dhënave nga CT ose autopsia, vendndodhja më proksimale e embolit ishte një arterie kryesore pulmonare ose një arterie lobare. Në mënyrë të ngjashme, në pacientët që janë vlerësuar me skanimin e ventilimi-perfuzionit, defekti i perfuzionit ishte më i madh se 25% të zonës totale të mushkërive në 50.0% të pacientëve. Këto gjetje sugjerojnë se, në të paktën gjysmën e pacientëve me emboli pulmonare, shtrirja e trombozës ishte mjaft e madhe duke shkaktuar bllokim të papritur të rrjedhës së gjakut, që do të kishte të ngjarë të rezultojë në një humbje të papritur të vetëdijes. (192) Sidoqoftë, në afro 40% të pacientëve, shtrirja e obstruksionit vaskular pulmonar ishte më e vogël. Për shkak se nuk kishte një qasje standarte për vlerësimin e sinkopit, një numër i pacientëve me emboli të vogla pulmonare mund të kenë pasur sinkope që shoqëroheshin me një

gjendje tjetër. Sidoqoftë, mekanizma të tjerë mund të përfshihen në shfaqjen e sinkopës pasi të jetë zhvilluar emboli pulmonare, siç janë mekanizmat vazodepresor ose frenues kardiake.(194) Për më tepër, kur një koagul largohet nga sistemi venoz dhe vendoset në qarkullimin pulmonar, mund të shkaktojë aritmi kur kalon në zemër. Prandaj, edhe koagulat më të vogla mund të jenë shkak i mundshëm i sinkopit. (192)

Sipas Altinsoy e bshp. (195) sinkopa është një paraqitje atipike për emboli pulmonare akute. Ekzistojnë të dhëna kontradiktore në lidhje me sinkopën dhe prognozën e EP. Prevalenca e sinkopit ishte 13% në kohën e prezantimit. Në krahasim me pacientët pa sinkop, ata me sinkop kishin frekuencë më të lartë të embolisë qëndrore (përkatësisht 83% ndaj 43%, $P = 0.002$), disfunksionim të ventrikulit të djathtë (91% ndaj 68%, $P = 0.021$) dhe pozitivitet të troponinës (80 % vs 39%, $P = 0.001$) por jo vdekshmëri 30-ditore (13% vs 10%, $P = 0.716$). Analiza multivariante tregoi se lokalizimi qëndror dhe pozitiviteti i troponinës kardiake ishin korrelacionet e pavarura të pranisë së sinkopit në pacientët me EP. Frekuenca e sëmundjes kardipulmonare ishte më e ulët, dhe kohëzgjatja nga fillimi i simptomave deri në pranimin në spital ishte më e shkurtër në pacientët me sinkop, megjithëse nuk ishte sinjifikante. (195)

Sinkopa ka shumë të ngjarë të paraqesë një gjendje të ndërmjetme midis EP masive dhe hipotensionit. Në pacientët me EP me sinkop, prognoza duket se varet nga patologjia themelore, mosha e pacientit, komorbiditetet dhe kohëzgjatja nga fillimi i simptomave deri në pranimin në spital dhe përdorimi i terapisë trombolitike. Paraqitja klinike dhe periudha nga fillimi i simptomave deri në paraqitjen ndryshojnë në pacientët në varësi të një numri faktorësh. Simptomat klasike të EP përfshijnë dhimbjen e gjoksit, dispne dhe hemoptizinë. Si dhe në studimin tone, sinkopa është një simptomë atipike e EP dhe ka një prevalencë të raportuar prej afro 10% si shenjë prezantuese fillestare.(196, 197, 198, 199) Ka të dhëna kontradiktore në lidhje me sinkopën dhe prognozën e EP. Sipas studimeve, prania e episodit sinkopal në prezantimin e EP u raportua se shoqërohej me një rrezik të lartë të vdekshmërisë. (196) Sidoqoftë, kjo nuk u konfirmua në studimet e mëvonshme. (198) Në të kundërt, një punim sugjeroi gjithashtu që sinkopi ishte i shoqëruar me prognozë të mirë. (200) Është e rëndësishme të përcaktohet nëse sinkopi shoqërohet me prognozë të dobët për të lejuar shtresimin e shpejtë të rrezikut dhe trajtimin e duhur.

Tri mekanizmat kryesorë patofiziologjikë të propozuar në zhvillimin e sinkopit në EP akute janë insuficienca akute e zemrës së djathtë, disritmia me hemodinamikë të paqëndrueshme (siç është bradikardia ose takikardia), dhe refleksi vazovagal. Okluzioni i > 50% i shtratis vaskular pulmonar mund të shkaktojë insuficiencë akute të ventrikulit të djathtë, mbushje të dëmtuar të ventrikulit të majtë, takikardi, hipotension dhe ulje të perfuzionit cerebral. Ky duket të jetë mekanizmi kryesor përgjegjës për zhvillimin e sinkopit.

Temperaturë e shkallës së ulët mund të jetë e pranishme, veçanërisht nëse ka hemorragji pulmonare shoqëruese ose infarkt (201), në studimin tonë ka rezultuar në 23(19%) pacientë.

Embolia pulmonare e vogël ka tendencë të vendoset në zona më shumë periferike pa qarkullim kolateral, ato kanë më shumë të ngjarë të shkaktojnë infarkt të mushkërive dhe versamente të vogla (që të dyja janë të dhimbshme), por jo hipoksi, dispne ose paqëndrueshmëri hemodinamike siç është takikardia. EP më të mëdha, të cilat priren të qëndrojnë në qendër, zakonisht shkaktojnë dispne, hipoksi, presion të ulët të gjakut, takikardi dhe zbehje, por shpesh janë pa dhimbje sepse nuk ka infarkt të mushkërive për shkak të qarkullimit kolateral. Prezantimi klasik për EP me dhimbje pleuritike, dispne dhe takikardi ka të ngjarë të shkaktohet nga një emboli e madhe e fragmentuar duke shkaktuar EP të mëdha dhe të vogla. Kështu, EP-të e vogla shpesh mund të mos diagnostikohen sepse ato shkaktojnë vetëm dhimbje pleuritike pa ndonjë të dhene tjetër dhe EP të mëdha shpesh nuk diagnostikohen sepse ato janë pa dhimbje dhe imitojnë gjendje të tjera që shpesh shkaktojnë ndryshime të EKG-së dhe ngritje të vogla në nivelet e troponinës dhe BNP. Triada klasike e simptomave të EP përfshin dispne, hemoptizi dhe dhimbje pleuritike në gjoks, por shumë pacientë janë gjithashtu asimptomatikë ose kanë një paraqitje atipike (sinkopi, dhimbje barku, shfaqje aritmi kardiake, konvulsione, etj). (202, 203) Diagnostikimi i EP vazhdon të jetë i vështirë për shkak të ndryshueshmërisë në pamjen klinike midis pacientëve. Mund të jetë e vështirë të përcaktohet korrelacioni klinik kur sinkopi është simptoma paraqitëse e EP akute. Sinkopi duket se ka të bëjë me EP qendrore dhe/ose masive. (196, 197) Nëse sinkopi shoqërohet me okluzion të plotë të fluksit pulmonar të gjakut, ai përparon në arrest kardial dhe vdekje. Sidoqoftë, në raste të tjera, sinkopi është i shkurtër dhe shoqërohet me hipotension kalimtar sepse okluzioni në arteriet qendrore pulmonare i nënshtrohet hapjes së pjesshme. Kjo situatë rezulton në mbijetesën e pacientit, dhe në të njëjtën kohë, ajo errëson diagnozën pasi tensioni i gjakut

mund të jetë stabilizuar.(196) Prandaj, interpretohet gjithashtu si "shenjë e harruar" e embolisë pulmonare kërcënuese për jetën.(204).

Nuk është për t'u habitur, pacientët me dispne, takikardi, hipotension, ose shenja klinike ose simptoma të trombozës në vena të thella kishin më shumë të ngjarë të kishin emboli pulmonare, siç ishin edhe ata me kancer aktiv. Sidoqoftë, përqindja e pacientëve që nuk i kishin këto tipare, por që kishin një konfirmim objektiv të embolisë pulmonare, nuk ishte e papërfillshme. (192)

Frekuenca respiratore/minutë ka qenë mbi 25 në 4(3.3%) pacientë meshkuj, 7(5.8%) femra dhe në 11(9.1%) në rastet në total. Frekuenca respiratore ka rezultuar gjer 20/minutë në 34(28.1%) në pacientë meshkuj dhe 31(25.6%) femra, në diapazonin 21-25/minutë në 25(20.7%) meshkuj dhe 27(22.3%) femra, në diapazonin 26-30/minutë në 1(0.8%) meshkuj dhe 3(2.5%) femra. Në totalin e pacientëve ka qenë gjer në 20/minutë në 65(53.7%), 21-25/min në 52(43%) dhe 26-30/min në 4(3.3%).

Frekuenca kardiake në pacientët meshkuj, femra dhe në total ka rezultuar respektivisht: gjer 60/minutë në 2(1.7%), 2(1.7%) dhe 4(3.3%); 61-80/minutë në 13(10.7%), 11(9.1%) dhe 24(19.8%); 81-100/minutë në 34(28.1%), 31(25.6%) dhe 65(53.7%); 101-120 në 11(9.1%), 13(10.7%) dhe 24(19.8%); ndërsa vetëm në pacientë femra rezultoi në dy 121-140/minutë dhe në dy mbi 140/minutë.

Sic shihet në shumicën e pacientëve në studim ka qenë prezente takipnea dhe takikardia. Në studimin Prospective Investigation of Pulmonary Embolism Diagnosis II (PIOPED II), pacientët me EP kishin një variete shenjash dhe simptomash. Shenjat e zakonshme ishin takipnea (54%) dhe takikardia (24%). (7) Me vetëm 24% të pacientëve që paraqitën takikardi, në shumicën e pacientëve u mungonte një nga gjetjet më të zakonshme. Për më tepër, PIOPED II përjashtoi shumë lloje të pacientëve, siç janë ata me nivele të ngritura kreatinine kronike ose në dializë, pacientë me sëmundje kritike ose individë me IM të kohëve të fundit. Zbatueshmëria pra është e kufizuar. Prandaj, indeks i lartë i dyshimit dhe vlerësim i faktorëve të rrezikut janë thelbësore për njohjen e ngjarjeve emboli pulmonare. Takikardia (58%) dhe takipnea (32%) ishin shenjat e zakonshme të vërejtura. (131)

Paraqitja klinike e EP ndryshon gjerësisht, ku dispnea është simptoma më e shpeshtë. Simptomat ndryshojnë nga dispne e rëndë, cianoza ose sinkopi që sugjerojnë një EP masive ndërsa dhimbje pleuritike, kollë ose hemoptizë që tregon një EP më të vogël periferike.

Dispnea është simptomi më i shpeshtë dhe takipnea është shenja më frekvente. Ndërsa dispnea, sinkopa, hipotensioni apo cianoza tregojnë EP masive; dhimbja pleurale, kolla ose hemoptizia shpesh sugjestinojnë emboli të vogël të lokalizuar distalisht në afërsi të pleurës.

Në ekzaminimin objektiv individë të rinj dhe më parë të shëndoshë mund të paraqiten në gjëndje ankthi por pa shenja të tjera, dhe atëherë kur anatomikisht kanë EP të madhe. Nuk konstatohen patjetër shenjat “klasike” si takikardia, ethe jo e lartë, fryrje të venave të qafës, akcentim i tonit dytë të a.pulmonare. Disa herë ndodh bradikardi paradoksale. Në pacientët e vjetër, që ankojnë diskomfort torakal jo të qartë, diagnoza e EP mund të mos jetë e qartë gjër në shfaqjen e shenjave të insuficiencës së zëmrës së djathtë. Fatkeqësisht për shkak të shpeshtësisë së sindromit ishemik akut koronar, mund të kalohet pa u diktuar mundësia e EP të rrezikshëm për jetën dhe mundet, që këto pacientë të dërgohen në shtëpi pasi përjashtohet diagnoza e infarktit me percaktime të enzimave dhe EKG-ve në seri.

TVTh janë vetëm <50% të pacientëve simptomatike – temperaturë lokale, ënjtje, cianozë, dhimbje ose ndjenjë të tensionimit në këmbën e prekur. Kjo është arsyeja pse simptomat pulmonare janë shpesh të parat në embolinë pulmonare. Graviteti i tabllës klinike varet nga masa e obstruksionit vazal dhe nga shpejtësia e krijimit të saj. Embolitë e vogla mund të mbeten klinikisht të heshtura, bllokimi i një prej degëve primare mundet që në një kohë të shkurtër të përfundojë me vdekje. Simptomat tipike janë dispnea, takipnea, dhimbje gjoksi therëse, kollë, takikardi ose dhe sinkope dhe shok. Në një pjesë të madhe të pacientëve shfaqet frikë e theksuar.(99)

Shumica e embolive pulmonare fulminante ka ecuri në formë valësh, shpesh kanë ecurinë e embolive të vogla recidivuese me simptomatikë diskrete, prandaj duhet të kihen në vëmendje kriza marramendje, të fikët për kohë të shkurtër dhe takikardi.

4.5 Vlerësimi klinik

Ekzaminimi i pacientëve me dyshim për EP mbetet problematik dhe kontroversial – ka disa rrugë për të "përcaktuar" dhe "përfshijtur" diagnozën (ose më e rëndësishme për të marrë vendimin për antikoagulantë ose jo). Diagnoza e embolisë pulmonare është e vështirë. Gjëja më e rëndësishme është që të përfshihet në diagnozën diferenciale. Sidomos embolitë e vogla nuk evidentohen, por janë shpesh tregues për embolitë e mëdha, të rënda. Më shumë se gjysma e embolive pulmonare diagnostikohen vetëm pas vdekjes.

Për shumicën e pacientëve, vlerësimi klinik i probabilitetit është mënyrë e lehtë dhe efektive për të vendosur se cili pacient duhet të kryejë ekzaminime të mëtejshme. Embolia pulmonare akute e dyshuar (EP) është shkak i zakonshëm për konsultimin dhe pranimin akut në spital. Vlerësimi klinik është i nevojshëm për të vlerësuar probabilitetin para testimit të EP, si dhe për të përcaktuar se çfarë testi diagnostik kërkohet. Vlerësimi klinik mund të përdoret në një mënyrë të pastrukturuar për të gjeneruar vlerësim para testit të probabilitetit ose mund të përdoret në një rezultat formal të probabilitetit klinik për të kategorizuar pacientët në (zakonisht) grupe të ulëta, të ndërmjetëm ose me rrezik të lartë. (209)

Në studimin tonë vlerësimi i probabilitetit klinik të EP sipas kriterëve të pikëzimit Wells rezultoi i lartë -12(9.9%), imoderuar - 108(89.3 %) dhe i ulët - 1(0.8 %). Vlerësimi i probabilitetit klinik të EP sipas Geneva score rezultoi i lartë -6(5.0 %), i moderuar - 82(67.8%) dhe i ulët – 33 (27.3%). U krye testi i korrelacionit ndërmjet probabilitetit klinik & Geneva score, që rezultoi - 0.174 (sig. 0.057) - pra korrelacion afersisht domethënës, duke rezultuar me vlerësues vlerësimi sipas testit të probabilitetit klinik.

Sipas një studimi në pacientë me EP akute (210) rezultuan me probabilitet të lartë 59%, të moderuar 29%, të ulët 15%. Këta studiues rekomanduan në probabilitetin e ulët klinik nëse D-dimer negativ, EP përjashtohet, nëse pozitiv D-dimer kryhet MDCT dhe trajtim të bazuar në rezultate; në probabiliteti klinik të moderuar: nëse D-dimer negativ EP përjashtohet, por sidoqoftë, nëse MDCT negativ me D-dimer negativ në këtë mjedis ka një probabilitet prej 5% për të qenë i rremë. Me sa duket, shkalla e gabimit 5% do të bjerë ndërsa përdoret më shpesh MDCT; nëse D-dimer pozitiv, kryhet MDCT dhe trajtim të bazuar në rezultate. Në probabilitetin

e lartë klinik kryhet MDCT: nëse është pozitiv, pacienti vendoset në trajtim, nëse negativ nevojiten më shumë teste për të përjashtuar EP.

Në studimin (211) frekuencat e embolisë pulmonare në kategoritë me probabilitet të lartë, të ndërmjetëm dhe të ulët ishin, përkatësisht: 75%, 81.2% dhe 29.4% për rezultatin origjinal të Gjenevës; 80%, 42.1% dhe 0% për modelin Wells. Miniati et al. (212) krahasoi performancën e tre modeleve (modeli Wells, modeli Gjenevë dhe modeli Pisa) në 215 pacientë radhazi me emboli pulmonare të dyshuar. Probabiliteti klinik i parashikuar nga modelet u kategorizua si i ulët, i ndërmjetëm ose i lartë. Në të gjithë pacientët, angiografia pulmonare është përdorur si standard diagnostifikues referues. Frekuencat e embolisë pulmonare në kategoritë e ulëta, të ndërmjetme dhe me probabilitet të lartë ishin, përkatësisht: 50%, 39% dhe 49% për modelin e Gjenevës; 12%, 54%, dhe 64% për modelin Wells. Kur u krahasuan saktësia parashikuese dhe përputhshmëria e kriterëve të Wells dhe Geneva, u gjet se dy metodikat e parashikimit kishin saktësi të ngjashme parashikuese për EP. Mund të argumentohet që kriteret e Wells janë më të shpejta, më të lehta dhe me kosto më efektive, si dhe sigurojnë rezultate të ngjashme me ato të kriterëve të Gjenevës.

Lucassen et al. (213) në analizën e tyre zbuluan se metodika e Uellsit me vlerë cutoff më të vogël se 2 kishte ndjeshmëri prej 0.84 dhe specifikim 0,58 dhe rregulli i Wells me vlerë të cutoff 4 ose më pak kishte ndjeshmëri prej 0.60 dhe specifikë prej 0.80, metodika e Gjenevës kishte ndjeshmëri prej 0.84 dhe specificitet prej 0.50.

Metodika e parashikimit të Gjenevës dhe kriteret e Wells përdoren për të llogaritur probabilitetin para testimit të pacientëve për të parashikuar se kush ka emboli pulmonare. Këto rezultate janë mjete që duhen përdorur me gjykimin klinik në vendosjen e testit diagnostik dhe llojet e terapisë. (214)

Sfida kryesore në formimin e diagnostikimit të pacientëve me emboli pulmonare të dyshuar klinikisht është të dallohet saktë dhe me shpejtësi afërsisht 25% të pacientëve që kanë sëmundje dhe kërkojnë trajtim antikoagulant nga 75% të cilët nuk kanë nevojë. (215)

Udhëzimet BTS për administrimin e emboli pulmonare akute të dyshuar në 2003 rekomanduan që të gjithë pacientët me EP të mundshëm të vlerësojnë dhe dokumentojnë probabilitetin klinik. (216)

Metodikat e pikëzimit PESI dhe sPESI mund të vlerësojnë gravitetin e EP të pacientëve. Vendos subjektet në një rën nga pesë klasat (I-V), me vdekshmëri 30-ditore që varion nga 1.1% në 24.5%. Ata në klasat I dhe II janë me rrezik të ulët dhe ato në klasat III-V janë me rrezik të lartë. (217)

Indeksi i gravitetit të embolisë pulmonare (PESI) rezultoi në klasën I -30(24.8 %), në klasën II- 37(30.6 %), në klasën III - 35(28.9 %), në klasën IV - 15(12.4%) dhe në klasën V - 4(3.3%). Indeksi i thjeshtësuar i gravitetit të embolisë pulmonare (sPESI) rezultoi me rrezik të ulët - 59(48.8 %), mesatar - 50(41.3 %), të lartë – 11(9.1%) dhe shumë të lartë - 1(0.8 %). U krye testi i korrelacionit ndërmjet rezultatit Pesi & rezultatit sPesi, që rezultoi – 0.722 (sig 0.000), pra korrelacion domethënës ndërmjet të dy metodikave.

4. 6 Prania e TVTH

Në pacientët e shtruar me TEP ka qenë e pranishme tromboza e venave të thella në 16(13.2 %) meshkuj dhe 13(10.7 %) femra, në 29(24.0%) pacientë në total. Nga 31 ekzaminime Echo Doppler të kryera kanë rezultuar pozitive për leziona venoze 27(87.1%), prej të cilave 15(48.4 %) në meshkuj dhe 12(38.7 %) në femra. Prania e konstatuar në studim e TVTH është në shifra më të ulta nga çfarë jepet në literaturë, gjë që mund të shpjegohet dhe me kërkesën e ulët ekzaminuese për evidentimin e saj. Kjo vihet re dhe në rezultatet e Echodoppler, ku në rastet që është kryer ky ekzaminim ka patur 87.1% pozitivitet.

Tromboza e venave të thella (TVTH) dhe embolia pulmonare (EP) konsiderohen si dy shfaqje klinike të ndryshme të një sëmundjeje të vetme. (218) TVTH dhe EP gjithashtu ndajnë të njëjtët faktorë rreziku, përfshirë moshën, imobilizimin, malinjitetin aktiv dhe anamnezën e kirurgjisë ose traumës. Vitet e fundit, koncepti i tromboembolizmit venoz (EPV) është prezantuar si rezultat i TVTH dhe EP duke patur etiologji të ngjashme. Të dhëna të raportuara të pacientëve të hospitalizuar me TVTH variojnë nga 0.1 në 3.17%. (219, 220, 221)

Disa studime kanë treguar që një numër i pacientëve me TVTH simptomatike posedojnë EP të heshtur ndërsa TVTH asimptomatike mund të jetë e pranishme në shumë pacientë me EP. (222) Sidoqoftë, prevalenca e saktë e TVTH në pacientët me EP dhe domethënia klinike e TVTH shoqërues janë shumë të panjohura.

Disa studime kanë treguar prevalencë relativisht të lartë të TVTH shoqëruese, duke filluar nga 10% në 93% në studime të ndryshme me metodologji të ndryshme. (218) Yamaki et al. (223) kanë raportuar që 58.1% e pacientëve me EP kanë TVTH konkomitante me TVTH proksimale që gjendet në 30% të këtyre pacientëve. Girard et al. (224) kanë publikuar se 60% e pacientëve me EP simptomatik të provuar nga angioCT kishin TVTH të njëkohshme. Në pacient me EP të dyshuar, diagnoza e TVH proksimale në pacient simptomatik, ose në pacient asimptomatik i cili ka kundërindikacione për angiografinë CT, është i mjaftueshëm për të konkluduar për EP. (225) Ekografia venoze e ekstremitetit është një modalitet i shpejtë, jo invaziv që mund të zbulojë TVTH. Për shkak se mund të kryhet me paisje portative, US venoze mund të mohojë nevojën për transport potencialisht të rrezikshëm të pacientëve të paqëndrueshëm, me sëmundje kritike. Përdorimi i ECHO rezulton në zbulimin më të shpejtë të trombozave simptomatike dhe asimptomatike të ekstremiteteve. Kur u kryen nga mjekë të trajnuar të ICU, studimet e Echo kompresive për ekstremitetet dhanë një ndjeshmëri prej 86% dhe një specifike prej 96% me një saktësi diagnostike prej 95%. (226) Përveç kufizimeve të vonesave në kohë për shkak të mungesës së personelit në dispozicion për të kryer një imazh të tillë, ekzistojnë disa kufizime të pacientëve që mund të kufizojnë saktësinë dhe fizibilitetin e studimit; dhjamosja, edema dhe veshja shpesh pengojnë cilësi të mirë të imazhit. Konsiderimi tjetër në kryerjen e ultratingullit të ekstremiteteve të poshtme për diagnostikimin e EP është se nuk është modalitet i besueshëm për të kontrolluar trombozën venoze të bacinit dhe ka edhe shumë raste në të cilat pacientët kanë EP, por nuk ka dëshmi të trombozës së ekstremiteteve. Në një studim, përdorimi i ultrasonografisë vetëm për EP të dyshuar kishte një ndjeshmëri prej vetëm 29%. (228) Ultratingulli i këmbëve mund të konfirmojë praninë e EP por nuk mund ta përjashtojë atë.

Studime të ndryshme japin të dhëna kontradiktore në të dhëna në lidhje me rëndësinë klinike të TVTH shoqëruese në rezultatin e pacientëve me EP. The International Cooperative Pulmonary Embolism Registry (ICOPER) ka raportuar se nuk ka asnjë lidhje midis TVTH shoqëruese të pacientëve me EP dhe vdekshmërisë gjithëpërfshirëse. (18) Në të kundërt, Wicki et al. (107) kanë demonstruar që pacientët me TVTH shoqëruese kanë rrezik më të lartë të vdekjes në krahasim me pacientët pa TVTH. Për më tepër, një meta-analizë e kohëve të fundit ka treguar që prania e TVTH në pacientët me EP akute është e lidhur në mënyrë të konsiderueshme me një rrezik të

rritur të vdekshmërisë 30-ditore.(229)Lee e bshp (218) treguan se 17.7% e të gjithë pacientëve me EP kishin rezultat të pafavorshëm në lidhje me EP, ndërsa 21.9% e pacientëve me TVTH shoqërues kishin një rezultat të pafavorshëm. Nuk kishte asnjë marrëdhënie statistikisht domethënëse midis TVTH shoqëruese dhe rezultatit të pafavorshëm në pacientët me EP ($P = 0.240$). Për më tepër, vdekshmëria gjithëpërfshirëse 30-ditore ka ndodhur në 19.9% të të gjithë pacientëve me EP dhe 21.9% të të gjithë pacientëve TVTH shoqëruese. Sidoqoftë, prania e TVTH shoqëruese nuk rezultoi në ndryshim statistikisht domethënës në vdekshmërinë 30-ditore të gjithë-shkaktarëve për pacientët me EP ($P = 0.584$). Si përmbledhje, ky studim tregoi se prania e TVTH shoqëruese nuk ndikoi në rezultatin e pafavorshëm të lidhur me EP ose vdekshmërinë e hershme të pacientëve me EP.(218)

Në 16 pacientë meshkuj ku janë konstatuar TVTH në zonën e vena femorale në 3 (18.8%) raste , në poplitë a 8(50%) raste , në safena 4(25%) raste dhe në vena cava inferior 1(6.2%) rast, ndërsa në 13 pacientët femra lokalizimi i trombëve ka qenë në 1(7.7%) rast në v. femorale dhe 12(92.3%) raste në venën poplitë a. Sic shihet lokalizimi predominues i TVTH ka qene ne v.poplitë a, gje qe perputhet me të dhënat e literaturës. (230)

4.7 Gazometria

Hipoksemia nga emboli pulmonare duhet të jetë për shkak të heterogjenitetit të V/Q , shuntit ose difuzionit. Ulja e përmbajtjes venoze të O_2 për shkak të zvogëlimit të debitit kardiak mund të kontribuojë gjithashtu në hipoksemi. (231) Eshtë zbuluar se pothuajse në të gjithë rastet e hipoksemisë në pacientët me zemër dhe mushkëri më parë normale mund të llogariten në bazë të efektit shunt. Madhësia e shuntit nuk ka lidhje me përqindjen e shtratit vaskular pulmonar të bllokuar dhe as me presionin mesatar të arteries pulmonare. Shunti ishte i prirur të zvogëlohet gradualisht rreth një muaj pas embolisë. Pacientët pa infarkt pulmonar ishin në gjendje të inspironin 80-111% të aftësive të tyre të parashikuara inspiruese, dhe kjo manovër zvogëloi përkohësisht shuntin. Pacientët me infarkt pulmonar ishin në gjendje të inspironin vetëm 60-69% të aftësisë inspiruese të teorit, dhe kjo manovër nuk ndikoi në përmirësimin e shuntit. Këto të dhëna sugjerojnë që shkak i shuntit nga e djathta në të majtë te pacientët me emboli pulmonare është kryesisht atelektazia. (232)

Hipoksemia në studimin tonë ka rezultuar në 84(69%) pacientë, prej të cilëve në 12(9.9%) hipoksemi të rëndë. Në lidhje me moshën rezulton se hipoksemia ka qenë më e rëndë dhe më e shpeshtë me rritjen e moshës. Nga 12 raste me hipoksemi të rëndë 10(83%) kanë rezultuar në pacientë të moshës mbi 64 vjeç. Nga 84 raste me hipoksemi 54(64%) kanë qenë në moshën mbi 64 vjeç dhe nga 67 pacientët e moshës mbi 64 vjeç – 54(80.6%) kanë patur hipoksemi.

Vlera normale të gazit karbonik kanë patur 35(28.9%), ulje të nivelit kanë patur 81(66.9%) pacientë dhe rritje mbi normën 5(4.1%) pacientë. Hipokarbia në lidhje me moshën ka frekuencë më të madhe në moshë mbi 64 vjeç – në 44(54.3%) nga 81 raste me hipokarbi, po ashtu dhe hiperkarbia – në 4 (80%) nga 5 raste. Alkalozë ka rezultuar në 53(43.8%) pacientë, acidozë në 13(10.7%) pacientë. Gjithashtu çrregullimet e pH janë më të shprehura me rritjen e moshës. Normal -55(45.5 %), <7.38-13(10.7%), >7.42-53(43.8 %).

AaDO₂ ka rezultuar gjër 20 në 10(8.3 %) pacientë, 20.1-30 në 23(19.0%), 30.1-40 në 13(10.7%), 40.1-50 në 35(28.9%), 50.1-60 në 20(16.5 %), 60.1-70 në 6(5.0%) dhe mbi 70 në 1(0.8%) pacient. Në lidhje me moshën shpeshtësia më e madhe e vlerave 30-60 të AaDO₂ vihet re në moshën mbi 64 vjeç (P=0.01).

Nga këto rezultate vërehet se kuadri gazometrik ka kryesisht modelin e hipoksemisë, hipokarbisë dhe rritje të AaDO₂.

Dhe nga të dhënat e literatures hipoksemia e lehtë në të moderuar, me PaCO₂ të ulur, është konstatimi më i zakonshëm në trombombolinë akute pulmonare. Hipoksemia e lehtë mund të mos vihet në dukje nga tendenca që të kryhet vetëm oksimetri, sepse më shumë se gjysma e pacientëve do të kenë SaO₂ mbi 90%. Historikisht, A-a DO₂ është menduar të jetë një tregues më i ndjeshëm i embolisë pulmonare sepse kompenson praninë e hipokapisë dhe sasinë e FiO₂. Megjithatë, studimi PIOPED II e ka vënë në dyshim këtë gjë. A-a DO₂ më pak se 20, që është normale ose afër normales në pacientët në varësi nga mosha, është konstatuar në një të tretën e pacientëve me një EP akute të identifikuar nga CT. (101)

Nuk ka një mekanizëm që të shpjegojë plotësisht për hipokseminë. Dy shkaqe janë përmendur më parë. Rritja e zonave me raport të ulët kufizon furnizimin me oksigjen. Në pacientët ku sëmundjet shoqëruese nuk bëjnë të mundur rritjen e ventilimit në minutë, një rritje e zonave me raport të lartë, mundet gjithashtu të shkaktojë hipoksemi. Në disa pacientë me funksion preekzistues kardiak të dëmtuar apo me emboli akute të mëdha që shkaktojnë sforcim të ventrikulit të djathtë, debiti kardiak mund të bjerë, me rënie të përqendrimit të oksigjenit venoz. Ky është një shkak i rëndësishëm i hipoksemisë në pacientët e sëmurë rëndë. Së fundi mund të ketë shunt të vërtetë nga e djathta në të majtë. Shunte të tillë janë të përshkruara në përqindje të vogël të pacientëve me hipoksemi të rëndë në tromboemboli akute pulmonare. Është supozuar se këto paraqesin shunte nga arteria pulmonare në venat pulmonare, ose hapja e foramen ovale, por lokalizimi i saktë është i panjohur. (102)

Obstruksioni i degëve të vogla arteriale pulmonare, që janë si arterie fundore, shkakton infarkt pulmonar në rreth 10% të rasteve. Kjo lidhet përgjithësisht me disa çrregullime shoqëruese të qarkullimit bronkial, siç është konstatuar në pacientët me insuficiencë të ventrikulit të majtë dhe në rritje kronike të presionit atrial të majtë. (102)

Si madhësia e embolizimit dhe mungesa ose prania e sëmundjeve preekzistuese kardiopulmonare janë përgjegjës për pasojat hemodinamike në EP akute, përsa i përket presionit në arterien pulmonare dhe sistemike, presionit atrial të djathtë, debitin kardiak, rezistencën vaskulare pulmonare dhe fluksin koronar të gjakut. (102)

Në EP masive, rritja e postngarkesës së ventrikulit të djathtë çon në rritjen e punës të miokardit të ventrikulit të djathtë dhe konsumin e O₂. Indeksi kardiak bie pavarësisht nga tensioni adekuat i gjakut, prengarkesa e VD e njejtë apo në rritje dhe kontraktilitetit konstant. Me që së fundi

presioni sistemik bie dhe presioni i VD rritet, gradienti i presionit ndërmjet aortës dhe VD ngushtohet. Megjithatë, ishemia kardiake nuk shpjegon plotësisht përkeqësimin e debitit ventrikular të majtë, i cili ka gjithashtu gjasa të jetë rezultat i kufizimit perikardial përkundrejt dilatacionit të zemrës djathtë, si dhe nga zhvendosje majtas e septumit interventrikular. Nga studimet në pacientët me hipertension pulmonar është vënë re se postngarkesa e ventrikulit të djathtë si pasojë e obstrukcionit vaskular pulmonar shkakton kombinim të insuficiencës së ventrikulit të djathtë dhe ulje të prengarkesës së ventrikulit të majtë. Së bashku me gjeometrinë jo normale të septumit interventrikular çon në rënie të përgjithshme të indeksit kardiak. Kjo sekuencë e ngjarjeve është më e shprehur në EP akute, sepse ventrikuli i djathtë nuk është hipertrofizuar dhe kështu është më pak i aftë për të kapërcyer rritjen fillestare në postngarkesë. Insuficenca kardiake progresive e djathtë është shkaku i zakonshëm i vdekjeve nga EP. Në të dhëna ICOPER, prezenca e çrregullimit funksional të ventrikulit të djathtë në EKG e pacientëve me EP, ishte e lidhur me dyfishimin e riskut të vdekjeve gjatë muajve. Mqs rritet rezistenca vaskulare pulmonare, rritet tensioni i paretit ventrikular të djathtë dhe përjetësohet dilatacion i mëtejshëm i ventrikulit të djathtë dhe disfunksioni. Si pasojë, septumi interventrikular bombohet dhe komprimon ventrikulin e majtë, që në vetvete është normal. Rritja e tensionit të paretit ventrikular të djathtë gjithashtu komprimon arterien koronare të djathtë dhe mund të precipitojë ishemi miokardi dhe infarkt ventrikular të djathtë. Nënmbushja e ventrikulit të majtë mund të çojë në rënie të hedhjes së ventrikulit të majtë dhe të TA sistemik, duke provokuar ishemi miokardi për shkak të komprometimit të perfuzionit të a. koronare. Eventualisht mund të ndodhë kolaps cirkulator dhe vdekje. (102)

Sa më masive të jetë obstrukcioni, aq më e rëndë mund të jetë hipoksemia, me një SpO₂ <95% në ajër në dhomë duke qenë parashikues për rritje të morbiditetit dhe vdekshmërisë. Sidoqoftë, shumë gjendje të tjera shkaktojnë hipoksemi, dhe emboli shpesh nuk shkakton hipoksemi apo madje edhe zgjerim të diferencës alveolare-arteriale PO₂. Hipokapnia zakonisht është e pranishme me emboli; hiperkapnia, nga ana tjetër, është e rrallë. Një EP masive mund të shkaktojë acidoze të kombinuar respiratore (hiperkapnike) dhe metabolike për shkak të kolapsit hemodinamik. 18% e pacientëve do të kenë PaO₂ 85-105 mmHg dhe 6% do të kenë një gradient normal A-a.

Një koncept i gabuar është se gradienti alveolar-arterial (A-a) DO₂ normal përjashton EP. (232) Cvitanike dhe Marino u përpoqen të përmirësonin ndjeshmërinë e gradientit (A-a) DO₂ në përjashtimin e EP duke e kombinuar atë me presionin normal të dioksidit të karbonit arterial (PaCO₂) (d.m.th., normale [A – a] DO₂ dhe PaCO₂ > 36 mm Hg përjashton EP). (233) McFarlane dhe Imperiale u përpoqën të përmirësojnë ndjeshmërinë e gradientit (A-a) DO₂ për të përjashtuar EP duke e kombinuar atë me mungesën e anamnezës paraprake të sëmundjes tromboembolike (d.m.th., [A – a] DO₂ normale dhe asnjë sëmundje paraprake tromboembolike përjashton EP). (234) As rregullat e McFarlane dhe Imperiale, as rregullat Cvitanic dhe Marino nuk ishin 100% të ndjeshëm. Stein dhe kolegët raportuan se një gradient normal (A-a) DO₂ në mungesën e sëmundjes tromboembolike paraprake kishte ndjeshmëri vetëm 89% (236) dhe se gradient normal (A – a) DO₂ dhe PaCO₂ > 35 mm Hg kishte ndjeshmëri prej vetëm 92% në përjashtim EP. (234) Egermayer dhe kolegët shqyrtuan sigurinë dhe dobine klinike të testit të thjeshtësuar D-dimer, tensionin e oksigjenit arterial dhe matjen e ritmit të frymëmarrjes (RR) për përjashtimin e EP. Ata përcaktuan që kombinimi më i mirë i të dhënave për përjashtimin e EP ishte testi negativ i thjeshtuar D dimer (Agen Biomedical Ltd., Acadici Ridge, Australi) dhe presioni arterial i oksigjenit (PaO₂ > 80 mm Hg), i cili dha ndjeshmëri dhe vlera negative parashikuese prej 100% në studimin e tyre. (236) Egermayer dhe kolegët përfunduan se ishte e sigurt për të përjashtuar EP me rezultat të testit D-dimer negativ dhe PaO₂ > 80 mm Hg.

Analiza ABG, qoftë vetëm ose në kombinim me variablat e tjera klinike janë shumë pak të dobishëm në diagnostikimi e EP të dyshuar. (237)

Kur përballemi me pacient të dyshuar për EP, klinikisti kërkon të dhëna klinike që do t'u mundësojnë atyre të rrisin ose ulin mundësinë e pre-testit të EP. Për shembull, gjetja e një gradienti normal (A-a) DO₂ është sugjeruar si përjashtues i EP. Sidoqoftë, si dhe në literaturë gradient (A – a) DO₂ normal ka të ngjarë të gjendet në pacientë me dhe pa EP, që fillimisht dyshohej se kishin EP. Prandaj, sipas Rodger e bshp. në pacientët e studiuar, të dhënat normale të gradientit (A–a) DO₂ nuk i ofrojnë klinikës ndonjë informacion shtesë diagnostikues. (237)

Gradienti jo normal (A-a) DO₂, takipnea, PaO₂ < 80 mm Hg, dhe një PaCO₂ < 36 mm Hg në pacientët të dyshuar për EP duket se nuk kanë asnjë vlerë diagnostikuese ose diskriminuese. (237)

Në 1998, Egermayer dhe kolegët zbuluan se ndërthurja e rezultatit negativ të testit D-dimer dhe PaO₂ > 80 mm Hg kishte vlerë parashikuese negative prej 100% në pacientët e dyshuar për EP. Sipas Rodger e bshp. në popullatën e studiuar, ishin në gjendje për të demonstruar vlerë parashikuese negative prej vetëm 91.9% për këtë rregull të parashikimit klinik. Egermayer më tej tregoi se D-dimer negativ, PaO₂ prej > 80 mm Hg dhe frekuenca respiratore 20/min gjithashtu kishin një vlerë parashikuese negative te 100% në pacientët e dyshuar me EP. Megjithatë, sipas studimit (237) është demonstruar vlerë parashikuese negative vetëm 95% me këtë rregull. Edhe pse rregullat e Egermayer kishin vlerat parashikuese negative mbi 90%, aftësia e tyre për të përjashtuar me saktësi EP në përmasa të mëdha të pacientëve të dyshuar me EP ishte e kufizuar (d.m.th., specificiteti me këto rregulla ishte i ulët). (237)

4.8 Rezultate të ekzaminimeve laboratorike

Hematokriti ka rezultuar i rritur në 15(12.4%) pacientë, në 8(6.6 %) meshkuj dhe 7(5.8 %).

Hematokriti i rritur ka qenë më shpesh në moshën mbi 55 vjeç.

Në lidhje me shoqërimin e trombozës venoze me hematokritin në popullatën e përgjithshme, të dhënat janë të pakta dhe jo gjithëpërfshirëse. Vaya et al. kreu një studim të kontrollit të rastit në 109 pacientë me trombozë të parë të venave të thella, pa trombofili, dhe 121 kontrole të shëndetshme. Ata raportuan që përqindja e rasteve me hematokrit mbi 45% ishte më e lartë në rastet me trombozë sesa në kontrole, d.m.th. 43% përkundrejt 27%. Korelacioni u dobësua kur disa faktorë të tjerë u përfshinë në një model multivariate. (238) Në një studim tjetër të bazuar në popullatë (studimi LITE, studim në subjektët mbi moshën 45 vjeç), nuk ka asnjë lidhje midis niveleve të larta të hematokritit dhe rrezikut të trombozës venoze, por autorët përdorën nivel cutoff relativisht të ulët për hematokritin (43.5%). (239)

Studimi i Braekkan dhe bshp. (240) tregon raport rreziku prej 1,25 për 5% rritje të hematokritit. Përparësitë e studimit të Braekkan dhe bshp. janë se ai është studim i madh, prospektiv dhe i realizuar në popullatë të përgjithshme me ndjekje të gjatë dhe ngjarje trombotike venoze të vleresuara mirë. Pra supozohet se lidhja e gjetur midis hematokritit të lartë dhe rrezikut të trombozës venoze është e vërtetë, por përsëri, çështja e rëndësishme është të percaktohet nëse lidhja është shkakore apo shpjegohet nga sëmundje të tjera, që shkaktojnë hematokrit të lartë dhe trombozë venoze.

Në literaturë shpesh thuhet se udhëtimi i gjatë në ajër shkakton trombozë venoze përmes dehidrimit në aeroplan, duke çuar në hiperviskozitet të gjakut, i cili nga ana e tij favorizon trombozën. Këshillat e zakonshme që jepen për të parandaluar trombozën pas udhëtimit ajror është pra, "të pini sasi lëngjesh". Ky koncept i gjakut viskoz, që rrjedh ngadalë është dukshëm si shkak i trombozës. Viskoziteti i lartë mund të konsiderohet të jetë crregullues i përbërjes së gjakut dhe shkak i stazës. Sidoqoftë, gjaku viskoz, i dëshmuar nga vlera të larta të hematokritit, është studiuar dobët si një faktor rreziku për trombozën venoze në popullatën e përgjithshme. (241)

Rritja e niveleve të hematokritit shkaktohet ose nga një rritje në numrin e eritociteve (eritrocitozë) ose nga dehidrimi. Eritrocitoza mund të shkaktohet nga sëmundje që prekin palcën e kockave (eritrocitoza primare, siç është polycythemia vera) ose nga mjedisi që ndikon në saturimin e oksigjenit (eritrocitoza sekondare). Në situatën e fundit, palca e kockave prodhon më shumë eritrocite për të balancuar uljen e saturimit të oksigjenit. (241)

Një shpjegim alternativ për lidhjen midis niveleve të rritura të hematokritit dhe rrezikut të trombozës venoze do të ishte prania e gjendjeve ose faktorëve që rrisin paralelisht, por në mënyrë të pavarur, si nivelet e hematokritit dhe rrezikun e trombozës venoze, siç është pirja e duhanit, sëmundja e mushkërive, etj. ose sëmundje të zemrës. Duke marrë parasysh që 37% e rasteve me trombozë venoze në studimin e bërë nga Braekkan dhe kolegët ishin duhanpirës në kohën e trombozës, dhe se disa gjendje mjekësore ishin të pranishme në 22%, këta faktorë mund të pritet të ndikojnë në rezultate. Për të përcaktuar efektin e niveleve të hematokritit në mënyrë të pavarur nga këta faktorë, të dhënat duhet të rregullohen për konfrontuesit e tillë. Në lidhje me pirjen e duhanit, autorët ndoshta nuk ishin në gjendje të hiqnin plotësisht efektin konfuzionit, pasi pirja e duhanit ishte klasifikuar përafërsisht. Pra, për fat të keq, ky studim nuk përjashton mundësinë që marrëdhënia që u gjet midis niveleve të larta të hematokritit dhe trombozës venoze mund të shpjegohet me praninë e gjendjeve të tjera. Prandaj, kjo çështje duhet të jetë në qendër të studimeve në të ardhmen. (241)

Azotemia ka rezultuar e rritur në 25(20.7%) pacientë, në 8(6.6%) meshkuj dhe 17(14 %). Vlerat e rritura jo normale të azotemisë kanë qenë më shpesh në moshën mbi 55 vjeç.

Në pacientët me emboli pulmonare (EP), mosfunksionimi i veshkave nuk është i rrallë, me një incidencë prej 5.1% në 13%. (18, 242) Goldhaber et al (18) përdorën regjistrin e ICOPER përfshirë 2454 pacientë dhe raportuan se incidenca e mosfunksionimit të veshkave, e përcaktuar si $Cr > 2.0$ mg / dL, ishte 5.1% në pacientët me EP dhe vetë crregullimi i funksionit të veshkave ishte një parashikues i pavarur i vdekshmërisë (HR, 2.0; 95% CI, 1.4-3.0.0). Kostrubiec et al (242) kryen një studim që përfshinte 100 pacientë me EP dhe raportuan insuficiencë të veshkave, të përcaktuar si $Cr > 1.5$ mg / dL, në 13 pacientë (13%). HR i vdekshmërisë së lidhur me dështimin renal ishte 6.4 (95% CI, 2.22-18.61).

Në studimin (243) incidenca e dëmtimeve akute renale ishte 4.9% dhe OR i vdekshmërisë së lidhur me dëmtimin akut renal ishte 2.62 (95% CI, 2.02-3.4.4), të cilat ishin të ngjashme me studimet e mëparshme.

Pas përshtatjes të karakteristikave demografike, sëmundjeve shoqëruese dhe trajtimit, dëmtimi akut renal mbeti faktor predispozues me një rritje prej 1.44-fish (95% CI, 1.04–2.01) dhe 1.49-fish (95% CI, 1.12–1.97) në pacientët që ishin në rrezik për zhvillimin e TVTH brenda 3 dhe 5 vjet. Dëmtimi akut renal gjithashtu mbeti faktor predispozues domethënës me rritje prej 2.66-fish (95% CI, 1.49-3.20) në pacientët që ishin në rrezik për zhvillimin e EP brenda 3 viteve. Nuk ka rezultate domethënëse për EP brenda 5 viteve. Analizimi i mbijetesës paraqiti rezultate të ngjashme. Sipas këtyre autorëve, rreziku i TVTH dhe EP është më i lartë te pacientët me dëmtim akut renal sesa në popullatën e përgjithshme. (244)

Megjithëse patofiziologjia nuk është krejtësisht e qartë , ekzistojnë 4 shpjegime të mundshme. Së pari, në pacientët me EP masive, do të ndodhë hipertension pulmonar dhe insuficiencë kardiake e djathtë. Një status i paqëndrueshëm hemodinamik, hipoperfuzion dhe hipoksi mund të çojnë në disfunksionim të veshkave. Së dyti, sëmundjet themelore, të tilla si Diabetes Mellitus, hipertensioni dhe sëmundje kronike të veshkave, janë faktorë rreziku për dëmtim renal akut që i bëjnë veshkat të prekshme gjatë stresit akut. Së treti, EP pas dëmtimit traumatik mund të shkaktojë dehidrim i cili mund të shkaktojë azotemi prerenale. Së katërti, sëmundje shoqëruese, të tilla si sepsis, insuficienca respiratore dhe anemia, do të kontribuojnë në disfunksionim të veshkave. (243)

Shumica e studimeve kanë treguar që personat me sëmundje kronike renale kanë një rrezik të shtuar të tromboembolizmit venoz (TEV), por vlerësimet për madhësinë e efektit ndryshojnë shumë. Për më

tepër, hetimet paraprake të rrezikut të TEV dhe/ose EP midis personave me sëmundje renale end-stage tregojnë rezultate kontradiktore. Kështu, nevojiten më shumë hulumtime për të kuptuar rrezikun e TEV, dhe veçanërisht EP, midis personave me sëmundje të veshkave. Kjo është gjithashtu e rëndësishme sepse prania e sëmundjes renale rrit rreziqet që lidhen me administrimin e kontrastit intravenoz (një agjent potencialisht nefrotoksik) dhe kufizon përdorimin e heparinave me peshë molekulare të ulët. Kjo mund të çojë në një diagnozë të vonuar, qëndrime të zgjatura në spital dhe rritje të kostove kur persona të tillë kanë TEV. (245)

Anomalitë në funksionin e trombociteve dhe kaskada e koagulimit mund të çojnë në rritjen e rrezikut të koagulimit ose hemoragjise, në varësi të defektit. Mekanizmat që kontribuojnë në një gjendje prokoagulantë te personat me sëmundje renale kronike përfshijnë rritjen e nivelit të faktorit indor, vWf, XIIa, VIIa, dhe fibrinogjenit, së bashku me reduktimin e aktivizuesit të plazminogjenit indor. Me përparimin në sëmundje renale end stage, pacientët zhvillojnë mosfunksionim të trombociteve që mund të çojnë në rritje të rrezikut të gjakderdhjes. Në të kundërt, nivelet e rritura të faktorëve prokokagulantë si homocisteinina, kompleksi trombin-antitrombinë, D-dimer, fibrinogjen, vWf, dhe mungesa e proteinës C në pacientët me sëmundje renale end stage mund të rrisin gjendjen protrombotike. Pacientët me sëmundje renale kronike ose sëmundje renale end stage mund të kenë më shumë të ngjarë të kenë faktorë rreziku për EP siç janë insuficienca kongjestive e zemrës dhe imobiliteti, përveç mekanizmave molekularë të lartpërmendur. Përdorimi i eritropoietinës në pacientët me sëmundje renale end stage gjithashtu është shoqëruar me rrezik të rritur të trombozës. (245)

Fibrinogjeni ka rezultuar i rritur në 81(66.9 %) pacientë, 40(33.1 %) meshkuj dhe 41(33.9 %) femra. Fibrinogjeni i rritur (duke patur në konsideratë shpërndarjen moshore të sëmurëve me TEP në studim) rezulton të jetë më frekuent në moshat më të reja.

Sipas studimit (246) rritja e fibrinogjenit plazmatik u shoqërua me rritjen e rrezikut të EP në kombinim me TVTH (P- <0.0001): Odds Ratio të rregulluara për multivariable ishte 2.1 (intervali i besimit të rregulluar 95%) në individë me nivele fibrinogjeni më të mëdha se ose e barabartë me 4,6 g/L kundrejt më pak se ose i barabartë me 3.0 g/L. Odds Ratio korresponduese ishte 1.7 (95% CI, 1.3-2.3) për çdo EP (P <0.0001) dhe 1.9 (95% CI, 1.0-3.6) për EP në ato me

TVTH ($P = 0.003$). Sidoqoftë, nuk kishte korrelacion pas përshtatjes multivariable midis fibrinogjenit plazmatik dhe rrezikut vetëm të TVTH ($P = 0.4$). Alelet e rritjes së fibrinogjenit u shoqëruan me një rritje të niveleve të fibrinogjenit plazmatik; megjithatë, këto variante gjenetike nuk shoqëroheshin me rrezikun e EP ose TVTH.

Sipas (246) nivelet e rritura të fibrinogjenit në plazmë shoqërohen me rritjen e rrezikut të EP në kombinim me TVTH por jo vetëm me TVTH. Nivelet e ngritura të fibrinogjenit mund të mos jenë të lidhura shkakësisht me EP ose TVTH. Fibrinogjeni plazmatik i rritur është shoqëruar me rritje rreziku i tromboembolizmit venoz, domethënë tromboza venoze e thellë dhe/ose emboli pulmonare. Sidoqoftë, jo të gjitha TVTH çojnë në EP, dhe jo të gjitha EP shkaktohen nga TVTH. Gjithashtu është e rëndësishme, fibrinogjeni plazmatik i rritur mund të ketë ndikim të ndryshëm në inicimin e trombit sesa në vetitë strukturore të trombit në rritje, siç është rezistenca e trombit ndaj stresit mekanik, shpërbërja fibrinolitike dhe madhësia e trombit, faktorë që përcaktojnë nëse trombi ka të ngjarë të thërmohet dhe të embolizojë për të shkaktuar apo jo EP. Kështu, fibrinogjeni i ngritur plazmatik mund të shoqërohet ndryshe me vetëm TVTH kundrejt EP në kombinim me TVTH. Nivelet e rritura të fibrinogjenit plazmatik mund të favorizojnë drejtpërdrejt koagulimin dhe grumbullimin e trombociteve dhe mund të ndikojnë në vetitë strukturore të trombit që çojnë në TVTh dhe/ose EP. Nga ana tjetër, pasi fibrinogjeni është një reagues i fazës akute, nivelet e rritura të fibrinogjenit mund të jenë vetëm shënues i gjendjes inflamatorë të pranishme në shumicën e rasteve të pacientëve që përjetojnë TVTH dhe/ose EP. Prandaj, është gjithashtu e paqartë nëse fibrinogjeni i rritur plazmatik është një shkak ose markues i TVTH dhe/ose EP.(246) Në studim në individë nga popullsia e përgjithshme rezulton se nivele të rritura të fibrinogjenit plazmatik shoqërohen me rrezik të shtuar të EP por jo të TVTH. Në të kundërt, EP trombotike ose rupturimi i TVTH të formuar tashmë me embolizimin pasues në mushkëri varet nga faktorë të tjerë, siç është rezistenca e trombit ndaj stresit mekanik, shpërbërja e fibrinolitike dhe madhësia dhe vendndodhja e trombit. Është interesante, si niveli i rritur i fibrinogjenit plazmatik pas korigjimi për BMI si dhe alelet e rritjes së fibrinogjenit në plazmë, që nuk shoqërohen me rrezikun e TVTH, duke sugjeruar se fibrinogjeni i rritur nuk është i mjaftueshëm për të inicuar TVTH. Në të kundërt, fibrinogjeni i rritur duket se luan rol në EP. Sipas studimit në lidhje me vlerësimin e rrezikut të TVTH, nivelet e fibrinogjenit nuk kanë asnjë

rëndësi, ndërsa rritja e niveleve të fibrinogjenit tek individët me TVTH tashmë të formuar mund të rrisë rrezikun e EP. (246)

D-dimer ka rezultuar i rritur në 119(98.3%) pacientë, më shpesh në nivele 501-2500 µg/L – në 44(36.4%) pacientë, në vlerën 501-10000 µg/L në 108(89.2%) pacientë. Rritje e vlerave të D-dimer është më evidente me rritjen e moshës.

Rritje e D-dimerit tregon për fibrinolizë aktive, që ndodh në mënyrë tipike në TVTh ose embolinë pulmonare, por mund të ndodhë edhe në sëmundje të tjera (tumoret, infeksionet, gjendje postoperatore). Një vlerë normale-e ulët e D-dimer përjashton me mjaft probabilitet një emboli pulmonare. Troponin I/T është e zakonshme të rritet në embolinë pulmonare të rëndë. Venat normale nuk e përjashtojnë embolinë pulmonare, por sugjerojnë një ecuri të lehtë, pa mbingarkesë të rëndësishme të ventrikulit të djathtë.(99)

Matja e dimerit përdoret gjerësisht në metodiken diagnostikuese të pacientëve të dyshuar me tromboembolizëm venoz. D- dimer formohet nga degradimi i fibrinës të ndërlidhur dhe është shënuesi më i mirë aktual në dispozicion të aktivizimit të koagulimit. Disa studime të mëdha të menaxhimit kanë përdorur një algoritëm duke kombinuar testet normale D- dimer me probabilitet të ulët klinik për të përjashtuar emboli pulmonare. Duke përdorur testet sasiore të vlerësuar mirë të D- dimerit, nivelet nën 500 ng/mL vlerësohen si një nivel i ndjeshëm i cutoff në përjashtimin e EPV. Ndjeshmëria varion nga 91 në 97% në studime të ndryshme dhe specifikimi ndryshon midis 40% dhe 70%. Është e mundur të rritet specifikiteti i testeve D-dimer duke rritur nivelet e cutoff së dimerit. Specifikimi i niveleve të D- dimerit që tejkalon 4000 ng/mL (Asserachrom Ddi ELISA) ishte 93% në një studim duke vlerësuar pacientët të dyshuar me embolizëm pulmonare. Një studim tjetër tregoi rrezik shtatëfish në rritje të embolisë pulmonare kur nivelet D- dimer tejkalan 2000 ng/mL (STA - Liatest D - Di®; Diagnostica Stago, Asnières, Francë) krahasuar me nivelet D- dimer midis 500 dhe 1000 ng/mL. Sidoqoftë, duhet të theksohet se këto dy studime ishin të kufizuara në popullata me një rrezik të ulët për TEV. Është sygjëruar që te pacientët me rrezik të lartë për EVP, pra pacientët e shtruar në spital, pacientët më të vjetër se 80 vjeç dhe pacientët me malinjitet ose kirurgji të mëparshme përdorimi i D- dimerit është jo efikas për shkak të shkallës të lartë të testeve falsë-pozitive, gjë që çon në përjashtimi të

embolisë pulmonare në më pak se 5% të pacientëve. Kombinimi i një niveli sasior të D- dimerit me një rezultat të lartë të probabilitetit klinik mund të përmirësojë vlerën pozitive parashikuese të embolisë pulmonare dhe është sygjëruar që kombinimi i këtyre testeve mund të jetë i mjaftueshëm për të vendosur diagnozën e EPV. (248)

Sipas studimit të Perrier e bshp, pacientët me një përqëndrim normal D-dimer u lanë pa trajtim me antikoagulant dhe u ndoqën për 3 muaj. Prevalenca e EP ishte 29% dhe D-dimer (duke përdorur cutoff prej 500 mikrogramë/L) kishte ndjeshmëri diagnostike për EP prej 99.5%. Specificiteti i përgjithshëm diagnostik i D-dimerit ishte 41%, por ishte më e ulët në grupin e pacientëve më të vjetër. Nga 198 pacientë me një përqëndrim të D-dimerit nën vlerën e cutoff, 196 ishin pa EP, një kishte EP dhe një kishte informacion jo të plotë për shkak të humbjes në ndjekje. Kështu, vlera parashikuese negative e përqëndrimit të D-dimerit ra në mes të 197 nga 198 dhe 196 nga 198 raste të PE (99% [95% CI: 96.4 në 99.9]). Duke përdorur një vlerë cutoff prej 4,000 mikrogramë/L, specifikimi i përgjithshëm i përqëndrimit të D-dimerit për EP ishte 93.1%. Si përfundim, përqëndrimi plazmatik D-dimer nën 500 mikrogramë/L lejon përjashtimin e EP në 29% të pacientëve ambulantë që dyshohen se kanë EP. Mos aplikimi i antikoagulimit në pacientë të tillë shoqërohet me një rrezik prej 1% të ngjarjeve tromboembolike gjatë ndjekjes. (249)

Përqëndrimi i D-dimer $<500 \mu\text{g/L}$ i matur duke përdorur një sistem të vlerësimit të ndjeshmërisë së lartë është mjet i fuqishëm për të përjashtuar emboli pulmonare (EP) në pacientët me një probabilitet të ulët pretesti të EP, siç përcaktohet nga një rregull i vlefshëm parashikimi klinik, duke shmangur nevoja për imazhe (p.sh. angioCT-pulmonare) në pacientë të tillë. Megjithatë, vlera pozitive parashikuese e vlerave të D-dimerit mbi këtë prag është më pak e fuqishme. Përqëndrimet e D-dimerit $\geq 500 \mu\text{g/L}$ janë identifikuar në 32 deri në 60 përqind të pacientëve që dyshohen për EP, por përfundimisht të vendosur që të mos kenë EP. Meqe nivelet e D-dimerit rriten me moshën, duke përdorur cutoff fiks prej $500 \mu\text{g/L}$ mund të mbivlerësojë probabilitetin e EP në pacientët e moshuar dhe kështu të shpjegojë, të paktën pjesërisht, përqindjen e lartë të vërejtur të rezultateve false- pozitive. (250)

Dr. Marc Righini, nga Spitali Universitar i Gjenevës, Zvicër, dhe kolegët hodhen hipotezën se përdorimi i cutoff të rregulluar sipas moshës D-dimer mund të përmirësojë specifikën e testimit

D-dimer në pacientët më të vjetër pa rrezikuar ndjeshmërinë. Ata përcaktuan cutoff e D-dimerit për vlerësim të mëtejshëm si mosha e shumëzuar me 10 tek pacientët 50 vjeç e më të vjetër (p.sh, në një pacient 78-vjeçar, cutoff i rregulluar nga mosha do të ishte 780 µg/L). Një cutoff prej 500 µg/L u mbajt për pacientët më të rinj se 50 vjet. (250)

Edhe pse të gjithë udhëzuesit ndërkombëtarë dhe lokalë për diagnozën EPV pajtohen që në pacientët me probabilitet mjaft të ulët pretestimi, testimi i D-dimerit mund të përdoret për të përjashtuar EPV dhe që pacientët me një probabilitet të lartë pretestimi duhet të kryejnë menjëher një imazh konfirmues, dhe nëse kjo nuk është e mundur, ato duhet të trajtohen menjëherë. (251)

Është demonstruar vazhdimisht se, për shkak të specificitetit të tij të ulët, nivelet D- dimer mbi 500 ng/mL kanë një aftësi të ulët për të vendosur diagnozën e embolisë pulmonare. Në studimin Tick e bshp. frekuenca e embolisë pulmonare u rrit ndjeshëm me rritjen e niveleve të D- dimerit. Prevalenca e embolisë pulmonare ishte 15% në grupin 500-1000 ng/mL dhe 61% në grup me nivele D- dimer mbi 4000 ng/ml. Për më tepër rezultoi lidhje midis nivelit të D- dimerit dhe gravitetit të embolisë pulmonare, e cila reflektohet nga shtrirja e obstrukcioneve embolike në arteriet pulmonare. (248)

Sipas studimit të Tick e bshp. (248):

- Së pari, integrimi i niveleve të larta deri në shumë të larta të D-dimerit mund të përmirësojë procesin diagnostikues në embolin pulmonare dhe të përmirësojë menaxhimin mjekësor. Klinikistët mund të konsiderojnë fillimin e trajtimit me antikoagulant në pacientët me kombinim të niveleve D- dimer më të lartë se 2000 ng/mL dhe me gjasë të probabilitetit klinik, ose në nivele D- dimer më të larta se 4000 ng/ml i pavarur nga rezultati probabilitetit klinik, duke pasur parasysh prevalencën 50% të embolisë pulmonare në këtë grup studimi. Kjo konsideratë mund të jetë veçanërisht e rëndësishme kur objektet e diagnostikimit të imazhit nuk janë në dispozicion brenda 24 orëve. Për më tepër, vlera pozitive e D- dimer mund të merret në konsideratë për të vendosur urgjencën e testimit të mëtejshëm të imazhit. Sidoqoftë, në mungesë të provave, siguria dhe efikasiteti i kësaj mënyre të mundshme të menaxhimit duhet të vlerësohet në perspektivë.

- Së dyti, pasi specificiteti i D- dimerit zvogëlohet me avancimin e moshës dhe nivelet e ngritura të D- dimerit janë të pranishme në pacientët e shtruar në spital me malinjitet ose kirurgji recente, disa autorë kanë deklaruar se vlerësimi i përdorimit të D- dimerit në menaxhimin diagnostik të embolis pulmonare duhet të jetë vetëm i kryer në popullata të paracaktuara me rrezik të ulët. Është vërejtur rrezik nëntëfish i rritur i embolisë pulmonare me nivele D- dimer më të lartë se 4000 ng/mL në krahasim me nivelet D- dimerit midis 500 dhe 1000 ng/mL, të pavarur nga rezultati i probabilitetit klinik. Kështu testimi i D- dimerit është i dobishëm në popullatë të pazgjedhur me faktorë rreziku për TEV siç janë moshë më e vjetër, pacientët me neoplazi ose kirurgji recente .

- Së treti, vlerësimi i pretestit është një hap i rëndësishëm në administrimin diagnostik të embolisë pulmonare. Një pretest klinik probabël tregoi rrezik të katërfish në rritje të embolisë pulmonare të pavarur nga rezultate të D-dimerit. Ndikimi i probabilitetit klinik në prevalencën e embolisë pulmonare ishte akoma i pranishëm edhe kur nivelet e D- dimerit tejkaluan 4000 ng/ml.

Kështu nivelet e rritura fuqishëm të D- dimerit rrisin mundësinë e embolisë pulmonare. Nëse integrimi i niveleve të larta deri në shumë të larta të D- dimerit në administrimin diagnostik të embolisë pulmonare duhet të përkthehet në masa më intensive diagnostikuese dhe terapeutike të pacientët me nivele të larta D- dimer, pavarësisht nga probabiliteti klinik, mbetet për t'u studiuar. (248)

D-Dimer dhe fibrinogjeni janë të rritur në shumë sëmundje që paraqesin shenja dhe simptoma të ngjashme me ato që shihen te pacientët me emboli pulmonare. Studimi (247) testoi hipotezën se pacientët me EP kanë fibrinogjen më të ulët dhe vlera më të larta D-dimer se pacientët në të cilët diagnoza dyshohet, por përjashtohet në mënyrë të sigurt. Njëqind e nëntëdhjetë e një pacientë të njëpasnjëshëm të dyshuar me EP akute (85 pozitiv, 106 negativ) u hetuan me një strategji diagnostikuese duke përfshirë d-dimer, probabilitetin e pretestit dhe CT helikale si teste të linjës së parë. Në 38 nga 40 pacientë të dyshuar me EP dhe d-dimer <500 mikrog/L (-1), EP u përjashtua pa testime të mëtejshme. Gjatë ndjekjes 3-mujore, nuk ka pasur EP klinik në mesin e këtyre 38 dhe 68 pacientëve me CT spirale negative. Në 151 pacientë me d-dimer > 500 mikrogram/L, d-dimeri, fibrinogjeni dhe raport d-dimer/fibrinogjen (raporti D/F) ishin të

ndryshëm në e EP pozitive në krahasim me pacientët EP-negativ. Pacientët me EP akute kanë vlera më të ulëta të fibrinogjenit sesa pacientët me EP të dyshuar por të përjashtuar. Raporti D/F> 103 është shumë specifik për praninë e EP akute, dhe shkakton dyfishim të normës diagnostike në krahasim me vetëm testimin d-dimer. (247)

4.9 Rezultate të ekzaminimeve instrumentale

Sipas ekzaminimit EKG kanë rezultuar pa ndryshime 71(58.7%) pacientë. Bllok degës së djathtë është konstatuar në 12(9.9 %) pacientë; bllok degës djathtë+FA; ngritje e ST në III me T negative në 1(0.8 %); T negative prekordiale djathtë (V1-V4) në 9(7.4 %) pacientë; takikardi sinusale në 10(8.3%) pacientë; FA në 17(14.0 %) pacientë. Në lidhje me grupmoshën FA ka qenë më i shpeshtë në moshën mbi 65 vjeç.

Rëndësia diagnostikuese e EKG është e moderuar dhe shpesh vetëm në krahasim me EKG e mëparshme. Si pasojë e dilatacionit të ventrikulit të djathtë mund të ndodhë rrotullim i aksit të zemrës (tipi i pozicionimit djathtas ose sindroma McGinn-White = tipi S₁Q_{III}) dhe bllok të degës së djathtë. Gjithashtu mund të konstatohen ndryshime jo-specifike si takikardi sinusale, aritmi dhe ndryshimet në segmentin ST dhe valën T. (99, 252, 253) 10% –25% e pacientëve me EP kanë një EKG plotësisht normale. (252)

Shenja e S1Q3T3 (vala proeminente S në lidhjen I, vala e Q dhe vala T negative në lidhjen III) është shenjë e Cor pulmonar akut (rritje akute e presionit dhe mbingarkes e vëllimit të ventrikulit të djathtë për shkak të hipertensionit pulmonar) dhe pasqyron tendosjen e ventrikulit të djathtë. Ky konstatim elektrokardiografik është i pranishëm në 15% deri në 25% të pacientëve të diagnostikuar përfundimisht me emboli pulmonare. Cdo shkak i Cor pulmonar akut mund të rezultojë në gjetjet e S1Q3T3 në EKG, duke përfshirë EP, bronkospazmat akute, pneumotoraksin dhe çrregullime të tjera akute të mushkërive. Gjetje të tjera të EKG-së gjatë fazës akute të EP përfshijnë bllok të ri të degës së djathtë (të plotë ose jo të plotë), zhvendosje djathtas të boshtit QRS, ngritje të segmentit ST në V1 dhe aVR, amplitude e ulët e komplekseve QRS të gjeneralizuar, kontraktime premature atriale, takikardia sinusale, fibrilacion/ flutter atrial dhe inversion të valës T në lidhjen V1-V4. EKG është shpesh anormale në EP, por të dhënat nuk janë as të ndjeshme dhe as specifike për diagnozën e EP. Shërbimi më i madh i EKG-së në një pacient

të dyshuar me EP është përjashtimi i diagnozave të tjera të rrezikshme për jetën (p.sh, infarkti akut i miokardit). (253)

Sipas Boey e bshp. (252) prezantimi më i zakonshëm është ai i takikardisë sinusale. Kjo ndodh në përgjigje të kërkesës fiziologjike për debitin e ulur kardial të majtë. Disa tipare të EKG sugjerojnë sëmundje më të gjerë dhe të komplikuar. Për shembull, voltazhet e ulëta të QRS, blloku i degës së djathtë dhe ngritja e segmentit ST në lidhjen V1 janë tregues të shoqërimit me shok kardiogjen. Aritmitë atriale, blloku i plotë i degës së djathtë, voltazhet e ulëta periferike, modelet pseudoinfarkt (valët Q) në lidhjen III dhe aVF dhe ndryshimet në segmentin ST në lidhjen e majtë prekordiale janë më të shpeshta te pacientët me rezultat fatal. Në një studim që shqyrtonte rëndësinë prognostike të të dhënave të EKG në lidhje me rezultatet e vdekshmërisë 30-ditore, 29% e pacientëve që ekspozuan të paktën një nga këto anomali në pranim nuk mbijetuan në spital. Kjo në krahasim me 11% të pacientëve pa tipare të tilla në EKG që nuk mbijetuan në spital. (254) Një seri e rasteve të EKG-së gjithashtu raporton se EP është një nga shkaqet e anomalive të valës T. Një studim tjetër tregoi se gjetja më e zakonshme në EP masive të konfirmuar ishte negativizimi i valës T në lidhjet prekordiale me një shfaqje të hershme në rastet më të rënda. (255)

Për më tepër, tiparet e EKG-së të lidhura me ngarkesën e ventrikulit të djathtë janë zbuluar që lidhen me shkallën e obstruksionit të arteries pulmonare për shkak të embolisë pulmonare, rritje të presionit dhe tensionimit të paretit të zemrës së djathtë. Prania e modelit të ngarkesës së ventrikulit të djathtë në EKG shoqërohet me një rrezik të shtuar të vdekjes nga të gjitha shkaqet dhe përkeqësimit klinik, madje edhe te pacientët me presion normal sistemik të gjakut. Në pacientët me disfunkcion të ventrikulit të djathtë, inversionet e valës T në lidhjet V1-V3 kishin ndjeshmëri dhe saktësi diagnostike më të madhe në krahasim me modelin S1Q3T3 dhe të bllokut të degës së djathtë, të cilat kishin specificitet të mirë, por saktësi të moderuar. (253)

Përdorimi parësor i EKG është për të përjashtuar shkaqet e tjera të dhimbjes së gjoksit. (256) Elektrokardiograma bëhet në mënyrë rutin tek njerëzit me dhimbje në gjoks, për të diagnostikuar shpejt infarktët e miokardit, diagnozë e rëndësishme diferenciale tek një individ me dhimbje gjoksi. Ndërsa disa ndryshime të EKG mund të ndodhin në EP, asnjëra prej tyre nuk është aq specifike sa të konfirmoj apo të përjashtoj diagnozën. EKG mund të tregojë shenja të ngarkesës së zemrës së djathtë ose të cor pulmonar akut në rastet e EP të mëdha. Shenjat klasike janë valë e

madhe S në lidhjen I, valë e madhe Q në lidhjen III dhe valë T inverse në lidhjen III (S1Q3T3), e cila ndodh në 12-50% të individëve me diagnozë, por gjithashtu ndodh në 12% pa diagnozë. (257, 259)

Shenjat më të zakonshme që shihen në EKG janë takikardia e sinusale, devijimi i boshtit djathtas dhe blloku i degës së djathtë. (258) Sidoqoftë, takikardia e sinusale gjendet vetëm në 8-69% të individëve me EP. (259)

Të dhënat e EKG-së në embolinë pulmonare mund të sygjerojnë prognozë më të keqe pasi gjashtë të dhënat e identifikuara me ngarkesë të ventrikulit të djathtë në EKG (frekuenca kardiake > 100 rrahje në minutë, S1Q3T3, valët T inverse në lidhjet V1-V4, ngritja ST në aVR, blloku i plotë i degës së djathtë dhe fibrilacioni atrial) shoqërohen me rritjen e rrezikut të shokut cirkulator dhe vdekjes. (260)

Rastet me T negative në lidhjet V1-3 dyshohen për EP ose për infarkt inferior të miokardit. Rastet e EP shfaqin valë T negative në lidhjen II dhe aVF, por rastet e infarkt të miokardit nuk paraqesin valë T negative në II dhe aVF. (261)

Në ekzaminimin ekografik të zemrës kanë rezultuar pa ndryshime 41(46.6 %) pacientë. PSAP i rritur ka rezultuar në 13(14.8 %) pacientë; PSAP i rritur+dilatacion ventrikulit të djathtë ka rezultuar në 12(13.6 %) pacientë; PSAP+insuff. trikuspidale në 1(1.1 %) pacient; dilatacion i ventrikulit të djathtë në 20(22.7%) pacientë; lëvizje paradoksale e septumit 1(1.1 %) pacient. Ndryshimet ekografike janë më të shpeshta me rritjen e moshës.

Ekokardiograma është përdorur për të përjashtuar shkaqet e tjera të mundshme (p.sh. infarkt miokardi, perikardit, dilatacion të aortës), por gjithashtu mund të evidentohen shenja indirekte të embolisë pulmonare: ku përfshihet dilatacion i ventrikulit dhe atriumit të djathtë, më rrallë zgjerimi i a. pulmonare. Diferencimi i sëmundjes Cor pulmonar akut nga insuficienca kronike e zemrës së djathtë mund të bëhet duke matur trashësinë e murit. (99)

Echokardiografia është e dobishme në triazhimin e pacientëve akut të rëndë të dyshuar për EP. Mund të diferencojë sëmundje me trajtime të ndryshme si: infarktin akut të miokardit, tamponadën e perikardit, disekimin e aortës, EP të ndërlikuar me insuficincë të zemrës së djathtë. Zbulimi i çrregullimit funksional të zemrës së djathtë për shkak të EP ndihmon për të përcaktuar riskun, prognozën dhe planin optimal të trajtimit. Të dhënat ekokardiografike vërehen në 47%–74% (18). Ndhmon në DD të dispneve akute, dhimbjes torakale, kolapsit dhe mjaft situatave të

tjera klinike, ku EP është diagnosë potenciale (infarkti, endokarditi infektiv, disekimi i aortës, tamponada e zemres etj.).

Në EP masive dhe submasive, disfunkcionimi i zemrës së djathtë mund të shihet në ekokardiografi, tregues që arteria pulmonare është bllokuar rëndë dhe ventrikuli i djathtë, pompë me presion të ulët, nuk është në gjendje të përputhet me presionin. Disa studime sygjerojnë që ky konstatim mund të jetë indikacion për trombolizë. Jo çdo person me emboli pulmonare (të dyshuar) kërkon ekokardiogramë, por rritjet në troponinat kardiake ose peptidin natriuretik të trurit mund të tregojnë ngarkesë të zemrës dhe të kërkojnë ekokardiogram, (262) i cili do të jetë i rëndësishëm në prognozë (263).

Pamja specifike në EP e ventrikulit të djathtë në ekokardiografi është përmendur si shenja e McConnell. Ky është konstatimi i akinezisë së paretit të mesëm, por një lëvizje normale e apeksit. Ky fenomen ka ndjeshmëri 77% dhe specifitet 94% për diagnostikimin e embolisë pulmonare akute në rastin e disfunkcionimit të ventrikulit të djathtë. (264)

Shumica e pacientëve me emboli pulmonare nuk kanë nevojë për ekokardiografi transtorakale; ajo duhet të kryhet në pacientët hemodinamikisht të paqëndrueshëm, si dhe në pacientët hemodinamikisht të qëndrueshëm me biomarkues të veçantë kardiak të rritur dhe karakteristika imazherike. (265)

Vendimi për të kryer ekografinë duhet të bazohet në paraqitjen klinike, gravitetin e EP dhe të dhënat imazherike (p.sh, angioCT). Ekokardiografia ndihmon në stratifikimin e rrezikut, menaxhimin e udhëzuesve, monitorimin e përgjigjes ndaj terapisë dhe dhënien e informacionit prognostik për një grup të pacientëve në rrezik të rritur për ngjarje të pafavorshme të lidhura me EP. (265) Trombi ventrikular i djathtë-lundruës, shoqërohet me një shkallë vdekshmërie deri në 45% dhe mund të zbulohen në 7% deri 18% të pacientëve. (266) Ekografikisht mund të konstatohet ekskursion sistolik i unazes trikuspidale, parametër ekokardiografik i funksionit të ventrikulit të djathtë; vlera më e vogël se 17 mm sugjeron funksion sistolik të ventrikulit të djathtë të dëmtuar. Gjithashtu mund të vihet re shenja e McConnell, veçori e EP masive akute. Këto gjetje ekografike shpesh çojnë në trajtim me trombolizë, transferim në njësinë e kujdesit intensiv dhe aktivizimin e ekipit ndërhyrës për terapi të bazuara në kateter. Trombi i zemrës së djathtë lundruës ose trombe që kërkojnë të kalojnë septumin interatrial ("trombi në tranzit") përmes një forame ovale persistente mund të kërkojnë embolektominë kirurgjikale. (265)

Ekografia kardiake indikohet në të gjithë pacientët me EP me rrezikshmëri të lartë, të cilët janë hemodinamikisht të paqëndrueshëm dhe që paraqiten me shok, sinkop, arrest kardiak, takikardi (frekuence kardiake > 100 rrahje në minutë), ose bradikardi sinusale persistente (frekuenca kardiake <40 rrahje në minutë). Gjithashtu rekomandohet për pacientët hemodinamikisht të qëndrueshëm me dëshmi të disfunktionimit të ventrikulit të djathtë ose lezione në angioCT, rritje të troponinës ose NT-proBNP, ose bllok të ri të plotë ose jo të plotë të degës së djathtë ose në EKG ST anteroseptal ose vale T. (265)

Në embolinë pulmonare domethënëse (indeksi angiografik Miller > 30%), ekokardiografia është në gjendje të zbulojë dilatim të ventrikulit të djathtë, hipokinezi/disfunksion të ventrikulit të djathtë ose hipertension pulmonar. (265) Përkundër kufizimeve të tij (veçanërisht vizualizimi i arteries pulmonare të majtë), ekokardiografia transezofageale mund të përdoret në mënyrë rutinore në diagnostikimin e embolisë pulmonare proksimale dhe është një mjet i fuqishëm diagnostikues që duhet të rekomandohet më së shumti në pacientët e njësisë së kujdesit intensiv. (265)

Sipas Bikdeli e bshp. (267) ekokardiografia ndihmon në stratifikimin e hershëm të rrezikut të pacientëve me EP akute. Rezultatet kanë qenë jo konsistente dhe përdorimi i ekografisë në jetën reale dhe vlera e saj prognostike nuk është studiuar vazhdimisht. Studimi ka përfshirë 35 935 pacientëve me EP simptomatike akute, ku ekografia e hershme u krye në mbi një të tretën e pacientëve, dhe proporcioni u rrit me kalimin e kohës. Historia e sëmundjes kardiovaskulare të mëparshme (sëmundja koronare, insuficienca kardiake dhe fibrilacioni atrial) dhe përcaktuesit klinikë të gravitetit të EP ishin ndër indikacionet kryesore. Zgjerimi i atriumit të djathtë, disfunksionimi i ventrikulit të djathtë dhe trombi i zemrës së djathtë ishin parashikuese të vdekshmërisë 30-ditore të lidhura me EP.

Sipas Ehrman e bshp. (268) në shumë raste, marrja e vendimit për të ndjekur vlerësimin për emboli pulmonare mund të jetë më sfiduese sesa vetë diagnostikimi. Kur rreziku është i ulët deri në i moderuar, shpesh përdoret testimi i D-dimerit, por është jospecifik; shpesh ka rritje të rrezatimit jonizues nga skanimet CT, si dhe mbidiagnozë. Metodot alternative të diagnostikimit janë potencialisht më të dobishme në pacientët e paqëndrueshëm që transferohen, kur nuk duhet të shkaktohen vonesa nga testimi sekuencial. Megjithëse ekokardiografia është jo invazive dhe mjekët e urgjencës kanë demonstruar aftësi në përdorimin e saj, ajo ka një aftësi të kufizuar në

diagnostikimin e embolisë pulmonare. Sidoqoftë, mund të përdoret si postdiagnostik për qëllime të stratifikimit të rrezikut. (268)

Asnjë nga variablat ekokardiografike të raportuara nuk ka raporte të mundësisë negative të mjaftueshme për të përjashtuar me siguri diagnozën e embolisë pulmonare. Prania e shenjës së McConnell sugjeroi fuqimisht diagnozën e embolisë pulmonare, me një raport pozitiv të gjasave 8.5. Edhe pse asnjë nga variablat e raportuara nuk ka patur mjaftueshëm aftësi për të diagnostikuar përfundimisht embolinë pulmonare në pacientë të qëndrueshëm, në situata në të cilat testimi përfundimtar mund të mos jetë i realizueshëm (p.sh. paqëndrueshmëria hemodinamike) dhe probabiliteti është shumë i lartë, mund të jetë e arsyeshme që të fillohet trajtimi bazuar në prania e shenjës së McConnell. (268)

Sipas Pate I e bshp. (269) ekokardiografia siguron vlerësimin e madhësisë dhe funksionit të ventrikulit të djathtë dhe të majtë, lëvizjen rajonale të murit, disfunkcionimin valvular, shuntin intrakardiak, vizualizimin e trombit dhe vlerësimin jo invaziv hemodinamik të presioneve të djathta ose të majta. Roli i ekokardiografisë si modalitet diagnostikues për EP akute vuajti nga dështimi i hershëm si pasojë në pamundësinë e tij për të mbajtur ndjeshmëri të mjaftueshme. Praktika klinike ka evoluar në përdorimin e modaliteteve alternative si angioCT ose skanimin e ventilimit/perfuzionit për të diagnostikuar EP akute. Në pacientët me EP jo-masive, prania e ngarkesës të ventrikulit të djathtë është prognostike dhe shoqërohet me vdekshmëri më të lartë në spital. Kucher e bshp. (270) vlerësuan 1035 pacientë me EP hemodinamikisht të qëndrueshëm nga Regjistri Ndërkombëtar i Embolizmit Pulmonar Kooperativ Ndërkombëtar, i cili kishte ekokardiogramë të kryer brenda 24 orëve të para të diagnostikimit, dhe zbuloi se prania e hipokinezisë së ventrikulit të djathtë ishte e zakonshme (39.1% e të gjitha rasteve) dhe parashikues i vdekshmërisë 30-ditore në analizën multivariante. Në studimin e Pate I (269) janë përjashtuar pacientët me shok, atak kardiak ose me infarkt akut të miokardit, duke përfaqësuar pacientë me EP hemodinamikisht të qëndrueshëm. Ekokardiografia është përdorur kryesisht si mjet për të udhëhequr terapinë të pacientët me EP të njohur dhe për rivlerësimin e ndryshimeve në funksionin e ventrikulit të djathtë dhe/ose presioneve të arteries pulmonare pas trombolizës dhe trombektomisë. Të dy indikacionet janë konsideruar të përshtatshme për EP hemodinamikisht të qëndrueshme. Disponueshmëria e lehtë e ekokardiografisë, ekspertiza akumuluese, kostoja dhe rreziku i ulët procedural, mbështetja nga disa udhëzime dhe potenciali

për udhëheqjen e menaxhimit të hershëm të duhur në EP, veçanërisht në submasivet, mund të shpjegojë prirjen e përdorimit të ekokardiografisë në paraqitjen e pacientëve me EP.

Udhëzimet aktuale janë të paqarta, në të cilat pacientët me EP hemodinamikisht të qëndrueshëm duhet t'i nënshtrohen ekokardiografisë. Ekziston konsensus që ekokardiografia duhet të kryhet kur trombolizohet. Development of Pulmonary Embolism Response gjithashtu ka lehtësuar indikacionin për përdorimin e hershëm të ekokardiografisë në EP për stratifikimin e shpejtë të pacientëve të rrezikuar, me qëllimin për të përmirësuar rezultatet. Të dhënat e rezultateve janë në përputhje me faktin se pacientët me rrezik më të lartë iu nënshtroan ekokardiografisë, siç dëshmohet nga rritja e barrës së komorbiditetit të parë brenda asaj populatë, përveç incidencës më të lartë të ngjarjeve akute siç janë: iktusi, insuficiencia respiratore akute /përdorimi i ventilatorit, sinkopit dhe aritmive atriale ose ventrikulare ndër të tjera. Ndër faktorët që parashikuan në mënyrë të pavarur performancën e ekokardiografisë në pacientët e shtruar me EP, ishin prania e iktus, sinkope, aritmi atriale, hipotension, përdorimi trombolitik dhe pranimi në institutet mësimore apo mësimdhënie urbane, dhe spitalet me madhësi mesatare dhe të mëdha. (269)

Në radiografinë e toraksit nuk u konstatuan ndryshime në 16(13.2 %) pacientë. Oligemi fokale rezultoi në 3(2.5%) pacientë; dilatacion vazal proksimal në 2(1.7 %) pacientë; ndërprerje e mprehtë vazale në 3(2.5 %) pacientë; shenja Palla në 4(3.3 %) pacientë; ndryshime atelektazike në 11(9.1 %) pacientë; atelektazë e shoqëruar me versament pleural në 3(2.5 %); atelektazë e shoqëruar me ngritje lart të diafragmës në 4(3.3 %) pacientë; versament pleural në 25(20.7%) pacientë; versament pleural me ngritje lart të diafragmës në 2(1.7 %) pacientë; ngritje lart e diafragmës në 42(34.7 %) pacientë; imazhi i gunga Hampton në 6(5%) pacientë. Ndryshimet radiologjike janë më të shpeshta me rritjen e moshës.

Radiografia konvencionale e toraksit zakonisht është jo-specifike dhe me sensibilitet të paktë, si dhe vlen kryesisht për përjashtimin e shkaqeve të tjera të dispnesë, që ndodh papritmas (psh. pneumotoraks, atelektazë, edemë pulmonare). Mund të konstatohen radiologjikisht në embolinë pulmonare: qëndrimi lart i diafragmës, ndërprerje e imazhit të a. pulmonare, ndryshim bruski i kalibrit, hije bazale ose versament pleural unilateral. Shenja e Westermark (rrallimi vazal periferik në zonën embolike dhe hiperperfuzion në zonat jo embolike) ndodh në vetëm 20% të rasteve. Në situatën akute, shpesh tabllat radiologjike është pa të dhëna.

Radiografia e kraharorit është akoma hetimi i parë që kryhet te pacientët që paraqesin simptoma kardiorespiratore ose simptoma sygjeruese të EP. Radiografia e toraksit është gjithashtu e dobishme në identifikimin ose përjashtimin e gjendjeve ose diagnozave të tjera. Kështu është e dobishme, njohja dhe kuptimi i disa prej shenjave më specifike radiologjike. Duhet që mjekët të jenë të vetëdijshëm dhe të përdorin tabllotë radiologjike të tilla si shenja e Palla, shenja Westermark dhe gunga e Hampton për të ndihmuar me diagnozën e EP dhe për të përjashtuar gjendje të tjera që mund të imitojnë tromboembolin venoze. Edhe nëse këto shenja nuk janë të zakonshme, prania e tyre, edhe në një pacient të dyshuar pa probabilitet të lartë pretesti të EP, duhet të nxisë hetime të mëtejshme, siç është një test D-dimer, shintigrafia e mushkërive ose angioCT. Me përparimin e teknologjisë, standardi aktual i artë klinik i diagnozës së EP është angioCT. (271)

AngioCT është në dispozicion të shpejtë dhe përdoret si një modalitet diagnostik për kushte të caktuara siç janë edema pulmonare akute, pneumonia dhe pneumotoraksi. Radiografia shërben si një mjet fillestar i stratifikimit të rrezikut, gjithashtu duhet të interpretohet mirë. Në rrethanat e zakonshme, radiografia bëhet si pamje postero-anteriore, por në ICU dhe radiografia portative bëhen me pamje nën-optimale, te cilat e bëjnë edhe më sfiduese marrjen e shenjave delikate radiologjike. (271)

Ka pasur shumë diskutime mbi besueshmërinë e veçorive të radiografise torakale në EP. Në një përmbledhje të 1063 pacientëve të dyshuar me EP, vetëm 12% e atyre që u vërtetuan se kishin EP u gjetën se kishin tablo normale të radiografisë torakale. (272) Studimi bashkëpunues ndërkombëtar i regjistrit të EP raportoi se vetëm 24% e 2 452 pacientëve me EP akute kishin gjetje normale të radiografisë torakale. (273) Në një studim tjetër të bërë me 50 pacientë, vetëm 18% kishin tablo normale të radiografisë torakale. (274) Bazuar në rezultate të tilla, vlerësohet se rreth 80% e pacientëve me EP akute kanë tablo radiologjike torakale jo normale. Anomalia më e zakonshme e vërejtur nga 4 studimet ishte kardiomegalia. (273, 274) Shenjat e tjera që vërehen shpesh ishin infiltratet pulmonare, atelektaza, versamenti pleural, kongjestioni pulmonar, hemidiafragma e ngritur, shenja e Palla, shenja Westermark dhe gunga e Hamptonit. Megjithëse kardiomegalia është gjetja më e shpeshtë deri në 38%, ajo nuk mund të përdoret për të vendosur diagnozën për shkak të listës së gjatë të diagnozave të mundshme diferenciale, duke përfshirë insuficiencën e zemrës, efuzionin perikardial, sëmundjen hipertrofike të zemrës dhe leziona të

rënda valvulare. Gjendje të tilla janë gjithashtu të përhapura në të gjithë botën dhe madje edhe më shumë në të ardhmen, me avancimet e trajtimit mjekësor dhe rritjen rezultuese të jetëgjatësisë së pacientëve me këto patologji. (271)

Të dhëna të tjera të radiografise torakale në EP janë gjithashtu jo specifike pasi patologji të caktuara të mushkërive gjithashtu mund të kenë karakteristika të ngjashme. Sidoqoftë, ka shenja të caktuara që kanë një specifitet më të lartë dhe ato janë shenja e Pallës, shenja Westermark dhe gunga e Hampton. (271)

Shenja e Westermark referohet në një zonë fokale të tejdukshmërisë së zgjeruar ose të rritur për shkak të oligemisë, e cila ndodh për shkak të dëmtimit të vaskularizimit të mushkërive për shkak të bllokimeve primare mekanike ose vazokonstriksionit reflektor. Shenja është formuar nga dilatimi i arterieve pulmonare proximale në vendin e embolit e ndjekur nga një kolaps i mprehtë dhe i demarkuar i vaskulaturës distale. (271) Shenja e Westermark është e rrallë dhe u gjet vetëm në 8% -14% të rasteve të konfirmuara të embolisë pulmonare në studimin PIOPED. (271) Sidoqoftë, është shumë specifike dhe duhet të ngrejë dyshimin për embolinë pulmonare nëse është e pranishme. Studimi i Risti e bshp zbuloi se në pacientët me eritrocitozë kronike hipoksemike dhe sekondare, prania e shenjës së Westermark në imazhin radiologjik, i dha një probabilitet 2.286 herë më të lartë për të pasur embolinë pulmonare sesa pacientët e tjerë të ngjashëm pa shenjën. (275) Saktësia në interpretimin e shenjës mund të rritet duke krahasuar radiografinë aktuale torakale me filmat e mëparshëm radiologjike të gjoksit të pacientit. Është gjithashtu e vështirë të vizualizohet shenja e Westermark kur radiografia torakale kryhet në një pozicion supin. (271)

Shenja Palla i referohet një zmadhimi të arteries pulmonare zbritëse të djathtë proximalisht ndërprerjes të arteries pulmonare për shkak të embolisë pulmonare akute . Kjo shenjë u përshkrua për herë të parë në 1983 nga Palla, me ç'rast paraqitja tipike e “sallamit” të arteries pulmonare zbritëse u pa në 25% të pacientëve me emboli pulmonare të konfirmuar dhe jo të pranishme në pacientët pa emboli pulmonare. (271) Shenja Palla konstatohet duke matur diametrin e arteries pulmonare zbritëse të drejtë në këndin venoz superior, pastaj distalisht në 10 mm, 20 mm dhe 30 mm nga këndi venoz superior. Shenja Palla vendoset kur diametri i arteries pulmonare zbritëse të djathtë është më shumë se 16 mm në këndin venoz superior. (271) Shenja Palla ka një ndjeshmëri të ulët dhe një specifitet të panjohur. Megjithëse shenja është e rrallë,

është akoma e vlefshme për të ndihmuar në diagnostikimin e embolisë pulmonare kur shihet me shenja të tjera si shenja e Westermark, gunga e Hampton dhe shenja Fleischner (arteria pulmonare e holluar). (271) Kombinimi i shenjës së Palla dhe Westermark mund të sugjerojë bllokim të arteries pulmonare lobare ose segmentare nga një emboli ose okluzion i përhapur në arterie të shumta të vogla. (271)

Gunga e Hamptonit shihet në radiografinë e gjoksit si një errësirë në formë pyke me pjesën e rrumbullakët konveks drejtuar drejt hilusit. Gunga e Hamptonit ndodh brenda dy ditëve nga një infarkt pulmonar, ku nekroza alveolare e mëvonshme dhe hemoragjia në infarkt jo të plotë shkaktojnë opacitetin. Pas disa muajsh, infarkti pulmonar zgjidhet dhe mbetet cikatrice reziduale. Edhe pse gunga e Hamptonit ka një specificitet të lartë prej 82%, ka ndjeshmëri të ulët prej 22% që kufizon dobinë e tij në diagnozën e embolisë pulmonare. Ndjeshmëria e ulët e shenjës mund të shpjegohet me furnizimin e dyfishtë të gjakut të mushkërive, i cili është i pranishëm në shumicën e njerëzve. Me furnizim vaskular kolateral nga të dy arteriet pulmonare dhe bronkiale, arteriet bronkiale mbrojnë kundër infarktut pulmonar në rast të embolisë pulmonare. (271)

Gunga e Hamptonit shihet më shpesh në pacientët me bashkë-morbiditete që prekin sistemin kardiopulmonar si sëmundja pulmonare obstruktive kronike, insuficienca e zemrës së majtë dhe hipertensioni pulmonar venoz. Gunga e Hamptonit shihet gjithashtu më shpesh në lobet e poshtme dhe shpesh shoqërohet me efuzion pleural. Sidoqoftë, gunga e Hamptonit nganjëherë mund të keqdiagnostikohet si pneumoni me konsolidim alveolar. Prandaj, rëndësi duhet t'i kushtohet aftësisë për të njohur me saktësi shenjën në radiografitë e toraksit. (271)

Ndjeshmëria dhe specificiteti i shenjave radiologjike të kraharorit ka rezultuar (276) : Shenja e Westermark me ndjeshmëri ~14%, specificiteti ~ 92%, vlera parashikuese pozitive ~ 38% dhe vlera parashikuese negative ~ 76%; rishpërndarja vaskulare me ndjeshmëri ~ 10%, specificitet ~ 87%, vlera parashikuese pozitive ~ 21%, vlera parashikuese negative ~ 74%; gunga e Hampton me ndjeshmëri ~ 22%, specificitet ~82%, vlera pozitive parashikuese ~ 29%, vlera parashikuese negative ~ 76%; efuzioni pleural me ndjeshmëri ~36%, specificitet ~ 70%, vlera pozitive parashikuese ~ 28%, vlera parashikuese negative ~ 76%; qëndrimi lart i diafragmës me ndjeshmëri ~ 20%, specificitet ~ 85%, vlera pozitive parashikuese ~ 30%, vlera negative parashikuese ~ 76%.

Radiografia e krahavorit është akoma ekzaminimi i parë që kërkohet te pacientët që paraqesin simptoma kardiorespiratore ose simptoma sygjeruese për EP. Radiografia e krahavorit është gjithashtu e dobishme në identifikimin ose përjashtimin e gjendjeve ose diagnozave të tjera. Kështu, njohja dhe kuptimi i shenjave më specifike radiologjike është i dobishëm. Duhet që mjekët të jenë të vetëdijshëm dhe të përdorin tabllotë radiologjike të tilla si shenja Palla, shenja Westermarck dhe gunga e Hampton për të ndihmuar me diagnozën e EP dhe për të përjashtuar gjendje të tjera që mund të imitojnë tromboembolin venoze. Edhe nëse këto shenja nuk janë të zakonshme, prania e tyre, edhe në një pacient të dyshuar pa një probabilitet të lartë pretesti të EP, duhet të nxisë hetime të mëtejshme, siç është testi D-dimer, shintigrafia e mushkërive ose angioCT.

Në një studim retrospektiv të kryer nga Perelas et al, 18% e 641 pacientëve që iu nënshtuan angioCT për mundësinë e EP u zbulua se kishin patologji të tjera që kërkonin trajtim. Këto përfshijnë pneumonin, edemën pulmonare, malinjitetet, efuzionin e madh pleural ose perikarditin, insuficiencën e zemrës dhe patologjitë akute të barkut. (277) Edhe pse disa nga këto diagnoza alternative mund të jenë të dukshme në një radiografi torakale, ekzaminim me rrezatim dhe kosto shumë më të vogël sesa angioCT, në studimin nga Ferriera et al, u zbulua deri në 33% të pacientëve që i nënshtroheshin angioCT kishin patologji të rëndësishme si shkak i simptomave të tyre, që nuk u identifikuan në radiografi të toraksit të marrë në të njëjtën kohë. (278) Përveç konstatimeve që lidhen drejtpërdrejt me simptomat e paraqitjes së pacientit, gjithashtu mund të identifikohen të dhëna të rëndësishme incidentale.

Nuk është për t'u habitur, diagnoza alternative dhe të dhëna të rëndësishme rastësore janë gjetur edhe në pacientët që i nënshtrohen MRI për vlerësimin e EP të mundshëm. Në një studim retrospektiv të kryer nga Schiebler et al, 8% e 580 pacientëve që i nënshtroheshin MRI për EP të mundshme u gjetën të kenë EP dhe afërsisht 17% e atyre pa EP kishin paologji të tjera. (279) Në një numër studimesh, shkaku më i cituar i simptomave të një pacienti kur angioCT ose MRI ishte negativ për EP, ishte pneumonia. Etiologji të tjera të cituara përfshijnë edemën pulmonare, malinjitetin, efuzionin pleural dhe sindromin akut të aortës. Për më tepër, patologjia intra-abdominale u zbulua gjithashtu se ishte shkaku i simptomave në shumë pacientë. (280) Pneumonia ishte diagnoza më e zakonshme alternative për EP në disa studime që shqyrtuan rezultatet shtesë tek pacientët pa EP. Pacientët me pneumoni janë zakonisht të pranishëm me

ethe dhe kollë produktive. Konsolidimi që kap dhe sipërfaqen pleurale, një tipar i zakonshëm i pneumonisë lobare, mund të shkaktojë dhimbje në gjoks. Edhe pse pneumonia zakonisht diagnostikohet nga radiografia, nëse zona e përfshirë e mushkërive është e vogël, mund të mos zbulohet. Për më tepër, pneumonia mund të mos zbulohet nëse pacienti ka kryer radiografi portative, sesa PA dhe anësore, në këtë rast zona e mushkërive të përfshira mund të mos vlerësohet. Hipoinflacioni i mushkërive, në një pacient i cili nuk është në gjendje të marrë frymë thellë për shkak të dhimbjes në gjoks, si dhe mbipesha gjithashtu mund të jenë faktorë kufizues për efikasitetin diagnostik të radiografive. Nëse ekziston zonë fokale e konsolidimit në bazën e mushkërive që prek pleurën, përfshirë mundësinë e infarktut në mushkëri, është e arsyeshme diagnoza diferenciale dhe për pneumoni. (280)

Në CT, pneumonia ka shfaqjen e sëmundjes së hapësirës ajrore që manifestohet si zona të konsolidimit me bronkogramë ajrore, nodule centrilobulare të përcaktuara keq dhe opacitete fqinje ground glass. Zonat më të mëdha të konsolidimit ka më shumë të ngjarë të duken në radiografi. Sidoqoftë, herët në procesin e sëmundjes, nodulet centrilobulare të përcaktuara keq, mund të mos evidentohen në radiografi. Për më tepër, modeli i pemës në syth, i cili mund të shihet të pacientët me infeksion bakterial, mikrobakterial, mikotik ose viral, mund të mos jetë i dukshëm në radiografi. Pacientët me bronkit akut ose kronik mund të zhvillojnë tapa të mukusit ose bllokimin e bronkeve për shkak të sekrecioneve të infeksionit, të cilat mund të shkaktojnë dispne, veçanërisht në pacientët me rezervë të dobët respiratore. Sekrecionet me absorbim të ulët brenda bronkeve mund të keqinterpretohen si emboli pulmonare në angioCT kur shikohet imazhi në dritare mediastinale. (280)

Efuzioni pleural ka një sërë shkaqesh dhe mund të shkaktojë dhimbje në gjoks dhe dispne nëse vëllimi i lëngut është i madh. Efuzioni pleural zbulohet në radiografinë torakale kur shkakton zënie të sinuseve frenikokostale. Pacientët me pneumotoraks mund të paraqiten me dhimbje në gjoks dhe dispne akute. Pneumotoraksi parësor spontan zakonisht ndodh në pacientë relativisht të rinj dhe zbulohet lehtësisht nga radiografia. Sidoqoftë, në pacientin që nuk është i pozicionuar ngritur, koleksionet më të vogla të ajrit pleural mund të mos vlerësohen. (280)

Lokalizimi angioskanerik i trombeve ka qenë në vazë primare në 23(19.5 %) pacientë; vazë primare bilaterale në 15(12.7%); vazë lobare në 15(12.7 %); vazë lobare bilaterale në 4(3.4 %); vaza segmentare në 28(23.7%); vaza segmentare bilaterale në 6(5.1%); seksione vazale të

ndryshme bilaterale në 26(22%); tromb me vendosje në formë shale në 1(0.8%) pacient. Lezionet trombotike në vazat primare janë më shpesh në moshën mbi 65 vjeç, si dhe një tromb në formë shale.

Për zbulimin e embolisë është më e shpejtë dhe më efektive angioCT pulmonare, ku defekte të mbushjes evidentojnë prezencën e emboluseve. Është i mundur evidentimi i embolisë të arteries pulmonare deri në arteriet subsegmentare, të gjitha embolitë më skajore nuk mund të diagnostikohen me siguri. Angiografia pulmonare është me të vërtetë mënyra më e sigurt për zbulimin e embolive më të vogla, por për shkak invazivitetit përdoret vetëm në raste pa siguri diagnostike me pasojë terapeutike.

Në fabulën greke të Pandorës, që gjendet në veprat e traktatit të Hesiodit “Punet dhe Ditët”, Pandora kishte një dëshirë të madhe për të "hapur një kuti" që babai i saj i tha kurrë të mos e haptë. Ky veprim në dukje i pafajshëm çon në pasoja të rënda për botën. Kjo fabul është një metaforë për gjendjen aktuale të imazherisë për Embolinë pulmonare (EP). Ndërsa angioCT ka revolucionarizuar aftësinë tonë për të diagnostikuar me shpejtësi EP, si dhe të sigurojë diagnoza alternative, gjithashtu është bërë si Kutia Pandorës e imazherisë; një test i shpejtë dhe shumë specific, i vështirë për klinikistët që të rezistojnë pa e aplikuar, kur përballen me pacientë që paraqesin dhimbje gjoksi, dispne dhe/ose hipoksemi. Për më tepër, analoge si te Kutia e Pandorës, hapja e perdorimi i gjerë i angioCT për numrin e madh të pacientëve me këto simptoma dhe shenja jospecifike, kanë çuar gjithashtu në pasoja të padëshirueshme si: rritje të kostos, ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe mbidiagnoza e mundshme. Megjithatë, shpesh harrohet që në mitin e Pandorës diçka mbeti në kutinë e hapur, "Shpresë". Po kështu, skemat e stratifikimit klinik të riskut të përmirësuar (të thjeshtuar) tek pacientët, shërbejnë më së miri që imazheria të siguroj shpresë që angioCT do të përdoret në mënyra më të optimizuara. Për më tepër, MRI, me përparime të vazhdueshme, ka potencial në ofrimin e një alternative ndaj angioCT pa ekspozim ndaj rrezatimit. (281)

AngioCT paraqet defektet e mbushjes brenda enëve pulmonare me emboli pulmonare akute. Kur arteria shikohet në planin aksial, ajo është e rrethuar nga një buzë e hollë e kontrastit, e cila është quajtur shenja e Polo Mint. Emboli mund të jetë okluziv ose jo-okluziv, ky i fundit është një rrjedhë e hollë e kontrastit ngjitur me embolin. Në mënyrë tipike emboli bën një kënd akut me vazën, në kontrast me embolin kronik. Vaza e prekur gjithashtu mund të zmadhohet. (282)

Tromboembolia akute pulmonare rallë mund të zbulohet në CT pa kontrast, si hiperdensitet intraluminal. (283)

Sipas Wittram e bshp (282) angioCT është vlerësuar me meta-analizë dhe ka demonstruar ndjeshmëri 53% –100% dhe specificitet 83% –100%, gjë që shpjegohen pjesërisht nga përmirësimet teknologjike me kalimin e kohës. Angiografia pulmonare, standardi diagnostik i referencës për konfirmimin ose hedhjen poshtë të një diagnoze të embolisë pulmonare, mbetet e pak përdorur. Megjithëse angiografia pulmonare ka shkallë më të ulët të vdekshmërisë dhe morbiditet (<1% dhe 5%, përkatësisht) sesa terapia antikoaguluese (1% –2% dhe 5% –25%), ajo nuk ka fituar pranim të gjerë dhe nuk është në dispozicion universal.

AngioCT është modaliteti imazherik i zgjedhur për pacientët me EP akute të dyshuar dhe është përbërës thelbësor në algoritmet diagnostikuese klinike që përdoren zakonisht. AngioCT ka ndjeshmëri dhe specifike të lartë, me gjykimin PIOPED II demonstrojnë ndjeshmëri prej 83% dhe specifike 96%. Kur u kombinua me probabilitetin klinik, vlera pozitive parashikuese u ngrit deri në 96%, kur kishte një probabilitet të lartë klinik. (9)

Disa avantazhe të tjera të dukshme të angioCT gjithashtu parashikojnë miratimin e saj të gjerë. Kryesisht, është i disponueshëm, minimalisht invaziv dhe i shpejtë me kohëzgjatje skanimit në skanuesit modernë më pak se një sekondë. Përfshirja e angioCT gjithashtu është gjetur të jetë zgjidhje me kosto efektive në punën e pacientëve me EP kur kombinohet me kriteret klinike. AngioCT mund të zbulojë etiologji të tjera të dhimbjes në gjoks dhe dypnese, siç janë dëmtimet muskulare, anomalitë e perikardit, pneumonia, etj. Patologjitë vaskulare dhe madje edhe sëmundja e arterieve koronare në disa protokolle. Më e njohur dhe e shpeshtë e përdorimit të CT është rreziku teorik i kancerit; megjithatë, duke minimizuar sasinë e rrezatimit jonizues. (285)

Për më tepër, Woo et al. tregoi një raport domethënës përfitim-ndaj rrezikut të angioCT kur merret parasysh rreziku i jetës mesatare i atribuar nga vdekshmëria nga kanceri. (286)

Në 31 pacientë, në të cilët është kryer ekzaminimi EchoDoppler ka patur të dhëna pozitive të prezencës së trombeve në 27(87.1%) pacientë.

Në rastet e dyshimit, trombozat e venave të thella të këmbës dhe pelvis, që shpesh janë shkaktarët e embolisë pulmonare zbulohen zakonisht me sonografi dhe nga venografia.

Ultratingulli i ekstremitetit të poshtëm është një hap i rëndësishëm në algoritmin diagnostikues për TEV të dyshuar dhe ka zëvendësuar venografinë me kontrast në standardin e praktikës në

vlerësimin e pacientëve që dyshohet se kanë TVTH. Disponueshmëria e përhapur, mungesa e rrezatimit jonizues dhe kostoja e ulët janë përbërës shumë të favorshëm të ultratingullit. Ai gjithashtu mund të identifikojë etiologjitë jo vaskulare të dhimbjes siç janë edema e popliteus, cistat e Bakerit, hematoma dhe infeksioni. Venat pelvike dhe ato proksimale është e pamundur për tu monitoruar në mënyrë adekuate si dhe kur ka faktorë pengues nga ana e pacientit si plagë etj. (285)

Një meta-analizë e vitit 2005 e 100 studimeve në grup tregoi se Echo dupeks dhe tripleks ofron një ndjeshmëri prej 96% secila për TVTH proksimale, 71% dhe 75% respektivisht për TVTH distale dhe specificitet të përgjithshme prej 94% secila. Echo me kompresion ishte më teper specifike, por më pak sensibil dhe paraqet sensibilitet në TVTH proksimale 96%, sensibilitet në TVTH distal prej 75% dhe specificitet të përgjithshëm prej 98%. (287)

Vetëm në 3 pacientë është kryer ekzaminimi shintigrafik perfuzional i mushkërive, ku në 2 paciente janë vënë re ndryshime të probabilitetit të lartë për trombemboli.

Shintigrafia pulmonare kryhet si kombinim i shintigrafise perfuzionale dhe ventilatore.

Shintigrafia perfuzionale nepermjet injektimit të radionukleideve lejon evidentimin imazherik të perfuzionit pulmonar. Defekte e perfuzionit flasin për emboli pulmonare, sidomos nëse shintigrafia ventilatore është normale. Nga ana tjetër janë shumëllojshmëri e sëmundjeve të tjera, ku janë të çrregulluar si ventilimi ashtu dhe perfuzioni për shkak të mekanizmit Euler-Liljestrاند. Modeli tipik i embolisë pulmonare janë rënia e perfuzionit me ventilim të ruajtur. Megjithatë, edhe me këtë procedurë nuk zbulohet direkt emboli, por shintigrafia pulmonare shpesh është e sigurtë në lidhje me diagnozën definitive. Në rast shintigrafie normale përjashtohet embolia pulmonare me probabilitet të lartë.

Në të kaluarën ose në vendet më pak të zhvilluara pa qasje të lehtë në paisjet CT, shintigrafia e mushkërive kryhet për të marrë diagnozën e EP duke vëzhguar për mospërputhje V/Q. Kriteret e rishikuara të PiOPED raportuan ndjeshmëri prej 41% dhe specificitet 97%. Sidoqoftë, ekziston përqindje e madhe e skanimeve tek pacientët e dyshuar, që në të vërtetë bien në kategorinë e probabilitetit të ndërmjetëm të EP dhe kështu do të nevojitet punë e mëtutjeshme. Aktualisht, një imazh i tillë V/Q indikohet vetëm në EP ne pacientë që ka kundërrindikacione në imazhin e CT siç është insuficienca renale dhe alergjia e kontrastit. (271)

Edhe pse angioCT është standardi aktual i artë, ekzistojnë situata të ndryshme klinike në të cilat nuk është i përshtatshëm, vecanërisht në insuficiencën renale, alergji nga kontrasti, vajza të reja dhe paciente që nuk përshtaten në CT. Skanimi V/Q ka 50 herë dozë rrezatim më të ulët në rrezatimin në gjji (0.28–0.9 vs. 50–80 mSv në 64 fetë CT), gjë që e bën atë të dobishëm për femrat e reja, përfshirë ato që janë shtatzënë. (285)

